



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice**

---

# **PROGRAMI PËR TRAJNIME TË VAZHDUESHME 2025**

Prishtinë, nëntor 2024

Programi për trajnime të vazhdueshme për vitin 2025 është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë me datën 18.11.2024

© AD 2024, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret për qëllime edukative dhe jo-komerciale duke ju referuar Akademisë si burim. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi apo çfarëdo forme tjetër e publikimit pa konfirmimin e Akademisë.

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë



Fjala e Kryesuesit të Këshillit Drejtues .....	7
Vlerësimi nevojave trajnuese për vitin 2025 .....	8
Metodologjia për vlerësimin e nevojave trajnuese .....	8
Përmbledhje ekzekutive .....	10
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA PENALE</b> .....	24
<b>1. Tryezë për harmonizimin e praktikës gjyqësore në çështjet penale</b> .....	25
<b>2. Tryezë për harmonizimin e praktikës gjyqësore në çështjet penale në Gjykatën e Apelit</b> .....	26
<b>3. Trajnim në luftimin e piraterisë digjitale dhe falsifikimin</b> .....	27
<b>4. Sekuestrimi dhe konfiskimi</b> .....	28
<b>5. Hetimet financiare, shpëlarja e parave dhe veprat tjera të krimit të organizuar</b> ...	30
<b>6. Veprat penale kundër detyrës zyrtare</b> .....	32
<b>7. Mashtrimi në prokurim publik</b> .....	34
<b>8. Ekstremizmi i dhunshëm, format e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit</b> ....	36
<b>9. Krimi Kibernetik</b> .....	38
<b>10. Dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues</b> .....	40
<b>11. Zbatimi i Udhëzuesve për Politikën Ndëshkimore</b> .....	42
<b>12. Masat e veçanta hetimore</b> .....	44
<b>13. Veprat penale kundër integritetit seksual</b> .....	46
<b>14. Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore</b> .....	48
<b>15. Gjykimi në mungesë</b> .....	50
<b>16. Artikulimi dhe mbështetja e aktakuzave/vendimeve gjyqësore - shkrimi ligjor</b> ...	52
<b>17. Krimet e luftës</b> .....	53
<b>18. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale</b> .....	56
<b>19. Trafikimi me qenie njerëzore</b> .....	58
<b>20. Veprat penale kundër mjedisit</b> .....	60
<b>21. Ankesa e të dëmtuarit në rastin e hedhjes së kallëzimit penal ose pushimi i hetimit</b> .....	62
<b>22. Hetimi dhe ndjekja e krimeve ekonomike</b> .....	63
<b>23. Masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedure penale</b> .....	65
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA CIVILE</b> .....	66
<b>1. Unifikimi i praktikës gjyqësore nga marrëdhëniet e detyrimeve</b> .....	67
<b>2. Unifikimi i praktikës gjyqësore në Gjykatën e Apelit</b> .....	69
<b>3. Anulimi i vendimeve gjyqësore - të gjeturat e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim</b> .....	70
<b>4. Unifikimi i praktikës gjyqësore në çështjet pronësore</b> .....	71
<b>5. Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile</b> .....	72

6. Procedurat gjyqësore të shpronësimit .....	74
7. Mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës.....	76
8. Marrëdhëniet detyrimore dhe sendore me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile .....	78
9. Marrëdhëniet familjare me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile .....	80
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA DREJTËSISË PËR FËMIJË</b> .....	82
Aspekti Civil .....	83
1. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit .....	83
2. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre .....	85
3. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror .....	87
Aspekti Penal .....	89
1. Veprat penale kundër integritetit seksual .....	89
2. Procedura penale që zhvillohet për fëmijë dhe të miturit.....	91
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA KOMERCIALE</b> .....	93
1. Ndryshimet me Hyrjen në Fuqi të Kodit të Ri Doganor dhe të Akcizave të Kosovës .....	94
2. Zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale, markat tregtare dhe patenat .....	95
3. Njohja dhe Përmbarimi i Vendimeve të Arbitrazhit Vendor dhe të Huaj.....	97
4. Implikimet Praktike të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.....	98
5. Kontratat në Ekonomi .....	99
6. Procedura e Falimentimit.....	100
7. Shkëputja e Kontratës dhe Efektet e Shkëputjes.....	101
8. Kontrata e Sigurimit dhe Kompensimi i Dëmit .....	103
9. Marrëdhëniet Komerciale me Element të Huaj dhe Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në Çështje Komerciale.....	104
10. Kontrata e Ndërtimit .....	106
11. Kontrata e Kredisë.....	108
12. Njohuritë Financiare .....	109
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA ADMINISTRATIVE</b> .....	111
1. Ligji i ri për Konfliktet Administrative .....	112
2. Tryezë e rumbullakët për Harmonizimin e Praktikës gjyqësore në Konfliktin Administrativ.....	114
3. Veçoritë e Konfliktit të Jurisdiksionit të Plotë dhe Ekspertiza në Konfliktin Administrativ.....	116
4. Kontestet e punës - Ligji për Nëpunësit Civil.....	118
5. Praktika gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatëve .....	120
6. Praktika gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e shtetësisë dhe rreziku nga pashtetësia.....	122

7. Tryezë mbi sfidat në vendosjen meritorë të aplikuesve për mbrotje ndërkombëtare dhe shtetësi.....	124
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA KUSHTETUESE</b> .....	126
1. Çështje aktuale në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave nga lëmia penale.....	127
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE PËR KEDNJ</b> .....	129
1. Liria e Shprehjes .....	130
2. Procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas Nenit 6 të KEDNJ: Zgjatja e paarsyeshme e procedurave civile dhe penale në jurisprudencën e GJEDNJ .....	132
3. Mjetet Efektive Juridike sipas Nenit 13 të KEDNJ-së: Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në çështjet civile dhe penale .....	134
4. Përdorimi dhe referimi i jurisprudencës së GJEDNJ me rastin e shkrimit të vendimeve gjyqësore .....	136
5. Neni 5 i KEDNJ .....	138
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA E DREJTA EVROPIANE</b> .....	140
1. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale .....	141
2. Bashkëpunimi gjyqësor dhe i zbatuesve të ligjit në çështje penale .....	143
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA E KUNDËRVAJTJES</b> .....	145
1. Tërheqja e parashtruesit të kërkesës pas parashtrimin të kërkesës në lëmin e inspektoriatit .....	146
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE PËR NDËRMJETËSIM</b> .....	147
Ndërmjetësimi-Penale.....	148
1. Ndërmjetësimi për Gjyqtarë dhe Prokurorë (në rastet penale) .....	148
Ndërmjetësimi-Civile.....	150
1. Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimin, zhvillimi i saj në ndërmjetësim të detyrueshëm veçanërisht në raste familjare dhe aprovimi ose anulimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimin - raste praktike .....	150
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE NGA KOMPETENCA INTERDISCIPLINARE</b> .....	152
1. Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore.....	153
2. Etika Profesionale .....	155
3. Menaxhimi i seancave gjyqësore .....	157
4. Trajtimi i informacionit të klasifikuar në proceset gjyqësore .....	158
5. Menaxhimi i rasteve dhe i zyrës .....	160
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE, DHUNËN NË FAMILJE DHE DHUNËN NË BAZË GJINORE</b> .....	161
1. Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore.....	162
2. Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale .....	163
3. Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare .....	165

4. Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën .....	166
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE KUNDËR DISKRIMINIMIT</b> .....	167
1. Mbrojtja gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit.....	168
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE PËR MENAXHMENTIN E GJYKATAVE DHE PROKURORIVE</b> .....	170
1. Menaxhimi i Gjykatës.....	171
2. Menaxhimi i Prokurorisë .....	172
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL DHE ZYRTAR LIGJOR</b> .....	173
<b>MODULET E TRAJNIMIT BAZIK PËR BASHKËPUNËTORT PROFESIONAL..</b>	174
PENALE .....	174
<i>Materiale</i> .....	174
<i>Proceduarale</i> .....	174
DREJTËSI PËR FËMIJË.....	174
CIVILE .....	174
<i>Materiale</i> .....	174
<i>Proceduarale</i> .....	174
<b>AKTIVITETET TRAJNUESE PËR STAFIN ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL</b> .....	175
1. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial .....	176
2. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm.....	177
3. Integriteti dhe sjelljet etike në administratën gjyqësore dhe prokuroriale.....	178
4. Menaxhimi i kohës dhe stresit .....	179
5. Trajnimi për protokollin dhe Etiketa .....	180
6. Mbrojtja e sinjalizuesve .....	181
7. Ndërmjetësim - trajnimi për Nëpunësit e Gjykatave .....	182
8. Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore.....	183
9. Trajnimi hyrës për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës së prokurorive.....	184
<i>Moduli 1:</i> .....	184
<i>Moduli 2:</i> .....	184
<b>PLATFORMA E KURSEVE HELP</b> .....	186
Platforma për edukimin e profesionistëve ligjor për liritë dhe të drejtat e njeriut - HELP kurse online.....	187

## Fjala e Kryesuesit të Këshillit Drejtues

Të nderuar,

Rëndësia e trajnimit gjyqësor njihet dhe potencohet në instrumentet të ndryshme ndërkombëtare. Bazuar në këto instrumente është thelbësore që gjyqtarët dhe prokurorët në shërbim të marrin trajnim të vazhdueshme, me qëllim të zhvillimit profesional dhe personale të tyre dhe sigurimin e garancisë për pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Hartimit dhe zbatimit të Programit Trajnues 2025 i paraprinë zbatimi i mekanizmave për vlerësimin e nevojave trajnuese. Vlerësimi i nevojave trajnues është proces themelor nga i cili derivon zhvillimi, zbatimi dhe mbarëvajtja e trajnimeve të përcaktuar në programin trajnues. Ky proces ka për qëllim identifikimin e nevojave të ofruesve të shërbimeve gjyqësore për trajnime të vazhdueshëm dhe do të shërbej AD-së si bazë për zhvillim të programeve të trajnimit për vitin e ardhshëm, për grupet e synuara për trajnimet e vazhdueshme.

AD-së në vazhdimësi zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese, qëllimi i vlerësimit është të mundësojë një lidhje sa më të qartë midis nevojave reale, artikullimit të tyre në Programin Trajnues dhe zbatimit të trajnimit si kontribut mbështetës në rrugë drejt zhvillimit dhe avancimit profesional të përfituesve të AD-së.

Rezultatet e Vlerësimit të Nevojave për Trajnime, janë pasqyruar në Programin Trajnues. Në këtë proces u evidentuan dhe prioritzuan numër i konsiderueshëm i temave të trajnimit të cilat janë përfshirë në Programin për trajnime të vazhdueshme për vitin 2025. Ky program përmbledhëdhë adreson nevojat e gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor, dukepërfshirë ndryshimet legjislative, masat dhe aktivitetet trajnuese si të dala nga Strategjia për sundimin e ligjit, Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje, Programi Kombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe strategjitë të tjera të kërkuara si rezultat i proceseve integruese dhe rekomandimeve të dala nga mekanizmat tjerë si PKZMSA dhe raporti i BE-së për Kosovën, e të cilat janë mandatorë për institucionet e sistemit të drejtësisë.

Me besimin e plotë që realizimi i këtij programi trajnues kontribuon direkt në zhvillimin profesional të bartësve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në vend, falënderoj stafin e AD-së, Këshillin Programor, KGJK-ë dhe KPK-ë, Kryetarëve të gjykatave dhe Kryeprokurorëve të prokurorive, gjyqtarëve dhe prokurorëve, partneret ndërkombëtar si dhe palëve të ndryshme të interesit që përmes propozimeve dhe rekomandimeve, kontribuan në hartimin e Programit për trajnime të vazhdueshme 2025.

Sinqerisht,

Fejzullah Rexhepi  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

## Vlerësimi nevojave trajnuese për vitin 2025

Në funksion të hartimit të programeve trajnuese përshtatshëmrisht me nevojat trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas Ligjit për AD-në është realizuar vlerësimi i nevojave trajnuese për vitin 2025.

Ky vlerësim është mandat që buron nga Ligji për AD-në, përkatësisht neni 6, pika, 1.2 si dhe nga standardet evropiane që kanë në qendër vlerësimin gjatë fazës së planifikimit, hartimit dhe zbatimit të programit. Akademia e Drejtësisë sipas kërkesës ligjore ka identifikuar dhe zhvilluar mekanizmat relevantë për vlerësim të nevojave trajnuese duke pas në konsideratë mjetet dhe burimet brenda Akademisë së Drejtësisë ashtu edhe ato jashtë saj të cilat janë si në vijim:

- Formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues;
- Pyetësorët për gjyqtarë dhe për prokurorë njëherë brenda vitit;
- Shkresat drejtuar KGJK-së dhe KPK-së, përkatësisht perspektiva e njësive përgjegjëse brenda këtyre këshillave;
- Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive;
- Takimet dhe diskutimet me trajnuesit të AD-së-së dhe veçanërisht rekomandimet për AD-në pas trajnimeve por edhe konkluzionet e përgjithshme;
- Strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit;
- Raporti i KE-së për Kosovën, Raportet e Departamentit të SHBA-ve për Kosovën, OSBE-së, IAP, Raporti mbi Monitorimin e Proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor dhe Raporti i Organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë sundimin e ligjit;
- Agjenda legjislativë, përkatësisht risitë ligjore në fuqi për vitin 2025.
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese për vitin 2025

## Metodologjia për vlerësimin e nevojave trajnuese

Akademia e Drejtësisë edhe këtë vit ka vazhduar përkushtimin e saj në vlerësimin e nevojave trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si target kryesor duke zbatuar mekanizmat dhe burimet e lartpërmendura përmes hapave konkret si në vijim:

Hapi i parë thelbësor në këtë proces ishte mbledhja dhe analiza e masave të përcaktuara në dokumentet strategjike që kanë për qëllim sundimin e ligjit dhe janë ende në fuqi edhe për vitin 2025. Në këtë kuadër janë shqyrtuar Plani i Veprimit të Strategjisë për sundimin e Ligjit 2025-2026, Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave 2022-2026, Programi Kombëtarë për të Drejtat e Njeriut 2021-2025, Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2022-2026, Strategjia shtetërore kundër terrorizmit, Strategjia kundër korrupsionit, Strategjia shtetërore kundër krimit të organizuar dhe dokumentet tjera strategjike. Masat e planifikuara në këto strategji obligojnë Akademinë e Drejtësisë që Programin trajnues për përfituesit e saj sipas ligjit ta orientojë në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit, pastrimit të parave, konfiskimit dhe sekuestrimit, gjykimin e rasteve në fushën komerciale, drejtësinë për të mitur, dhunën në familje, aspektet tjera të drejtave të njeriut si dhe në risitë ligjore për të arritur progres dhe përmirësim të cilësisë qoftë në hetime të rasteve ashtu edhe në gjykimin dhe vendosjen meritore të rasteve përkatëse.



Hapi i dytë dhe tejet me rëndësi veçanërisht për procesin integruar të Kosovës në BE ishte shqyrtimi dhe gjetjet nga raporti i Komisionit Evropian për Kosovën<sup>1</sup>, Raportet e DASH-it<sup>2</sup> me theks te Raporti i trafikimit të personave në Kosovë dhe Raporti për të drejtat e Njeriut në Kosovë, Raporti mbi Monitorimin e Proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor, Raporti i OSBE-së për monitorimin e gjykimeve të rasteve të dhunës në familje<sup>3</sup> duke përfshirë edhe raportet e institucionit të Avokatit të Popullit<sup>4</sup> dhe OJQ-ve që monitorojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Gjetjet nga të gjithë këto mekanizma konfirmojnë nevojën për hetime dhe gjykime efektive për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, pastrimin e parave, konfiskimin, trafikimin e personave, përmirësim të cilësisë së hetimeve dhe gjykimeve dhe veçanërisht dënime efektive ndaj kryesve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në përputhje me ligjet, strategjinë 2022-2026 kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe Protokollin e ri të Shtetit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut etj.

Hapi i tretë dhe po aq me rëndësi përkundër sfidave në funksionimin e platformës së re elektronike (SMAT)<sup>5</sup> të menaxhimit të trajnimeve të AD-së ishte mbledhja e të dhënave nga anketat vlerësuese siç janë formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues të mbajtur gjatë vitit 2024 dhe nga pyetësorët për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët janë proceduar tek të gjitha Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës gjatë muajit qershor të vitit 2024. Gjetjet nga anketat vlerësuese konfirmojnë nevojën e trajnimeve pothuajse në të gjitha kompetencat e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve me përqendrim më të madhe te drejtësia penale në çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin, pastrimin e parave, krimin kibernetik, gjykimin në mungesë, dhunën në familje, mashtrimin në prokurimin publik. Në civile në çështjet ligjore nga procedura kontestimore dhe jokontestimore me theks te pronësia, trashëgimia, kompensimi i dëmit, sigurimi i kërkesë padive etj. Në drejtësinë për fëmijë nga aspekti penal për masat e diversitetit, veprat penale kundër integritetit seksual, ndërkaq për aspektin civil për mbrojtjen gjyqësore të fëmijëve pa kujdes prindëror me theks tek alimentacioni dhe besimi i fëmijëve. Në drejtësinë komerciale çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me arbitrazhin, falimentimi etj. pa përjashtuar edhe aspektin interdisiplinar me theks te hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore, menaxhimi i rasteve, gjykatës/prokurorisë etj., aspektin e të drejtave të njeriut sipas neneve të KEDNJ-së dhe më pak te kundërvajtjet që kryesisht nevojat ishin në fushën e inspektimit.

Hapi i katërt dhe tejet me rëndësi ishte mbledhja e propozimeve nga takimet e përditshme me trajnuesit me rastin e zbatimit të programeve trajnuese. Veçanërisht thelbësore kanë qenë gjetjet nga raportet me rekomandimet e trajnuesve për AD-në të cilat kryesisht ishin që programi trajnues të adresojë çështje ligjore për unifikimin e praktikës gjyqësore në çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit, marrëdhëniet komerciale dhe detyrime me element të huaj, çështje ligjore nga procedura kontestimore dhe jo kontestimore sa i përket mbrojtjes gjyqësore të drejtave të fëmijëve, për procedurën trashëgimore dhe kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë, për risitë e Kodit të Procedurës Penale veçanërisht për dëshmitarët e mbrojtur, marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, për procedurën penale që zhvillohet ndaj të miturit dhe masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit, për veprat penale të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë dhe për shkathësisë në komunikim dhe aspektin e të drejtave të njeriut.

---

<sup>1</sup> [https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report\\_SQ.pdf](https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf)

<sup>2</sup> <https://xk.usembassy.gov/sq/our-relationship-sq/official-reports-sq/>

<sup>3</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/8/8/572080.pdf>

<sup>4</sup> [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2024/03/Avokati-i-Popullit\\_Raporti-vjetor\\_2023.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2024/03/Avokati-i-Popullit_Raporti-vjetor_2023.pdf)

<sup>5</sup> <https://smatad.rks-gov.net/>

Hapi i pestë dhe qenësor për përcaktimin e përmbajtjes së programit vjetor ishte punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese e realizuar me 25 korrik 2024. Në këtë punëtori ishin kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive nga të gjitha instancat e gjykatave dhe prokurorive duke përfshirë edhe nga KGJK dhe KPK si dhe bashkëpunëtorët dhe partnerët ndërkombëtar të AD-së përkatësisht OPDAT, KE, OSBE, USAID, GIZ, EULEX etj. Fokusi i kësaj punëtorie ishte diskutimi i gjetjeve nga të gjitha burimet e lartë theksuara për Programin trajnues 2025 të cilët u vlerësuan si relevante për program duke ofruar perspektivën e tyre përmes punës në grupe ndërkaq nga partnerët zhvillimor edhe bashkëpunimi edhe më tej me Akademinë e Drejtësisë në zbatimin e trajnimeve.

Pas realizimit të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese sikurse të elaboruara më lartë rezultatet e dalura, janë përmbledhur dhe të njëjtat janë shqyrtuar nga Këshilli Programor i AD-së si organ profesional dhe i mandatuar për hartimin dhe zhvillimin e Programit Trajnues. Gjithashtu në mbështetje të Këshillit Programor me rastin e hartimit dhe zhvillimit të programit trajnues kanë marrë pjesë ekspertë nga partnerët ndërkombëtar, si dhe gjyqtarë dhe prokurorë më me përvojë si të caktuar paraprakisht nga Këshilli Drejtues i AD-së.

## Përmbledhje ekzekutive

Këshilli Programor ne mbështetje te eksperteve te partnereve ndërkombëtar dhe grupin e caktuar të gjyqtareve dhe prokuroreve trajnues në AD-së si te caktuar nga Këshilli Drejtues, duke u bazuar në gjetjet përfundimtare te procesit te realizuar për vlerësimi të nevojave trajnuese ka hartuar Programin për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2025, dhe në vijim të këtij dokumenti ne formën e koncepteve janë paraqitur fushat dhe temat e trajnimit, objektivat e trajnimit, duke përfshirë pjesëmarrësit e synuar dhe kohëzgjatjen e trajnimit. Drafti i përmbledhur dhe i hartuar nga Këshilli Programore i njëjti në pajtim me Ligjin për AD-në është dërguar për miratim në Këshillin Drejtues.

Programi Trajnues përmban 83 aktivitete trajnuese gjithsejtë të ndara sipas fushave. Në penale janë gjithsejtë 23 aktivitete trajnuese, civile 9, drejtësia për fëmijë 5, komerciale 12, administrative 7, kushtetuese 1, KEDNJ 5, BE 2, kundërvajtje 1, ndërmjetësim 6, dhunë në familje 4, kundërdiskriminimi 1, interdisiplinare 5 dhe për menaxhimin e gjykatave 1 dhe për menaxhimin prokurorive 1.

Këto trajnime do të adresojnë praktikën gjyqësore e cila është identifikuar si sfiduese dhe praktikë jo unike në zbatim të legjislacionit në fuqi për të pasur drejtësi më të mirë në të ardhmen në punën e gjykatave dhe prokurorive. Programi është i larmishëm dhe përfitues do të jenë gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional dhe profesionistët e tjerë ligjor. Një mori e aktiviteteve trajnuese janë të dizajnuara për përfitues të përbashkët gjyqtarë dhe prokurorë si dhe profesionistë ligjor ndërkaq një pjesë e tyre edhe për kategori të veçanta. Prioritet i këtij programi mbesin edhe më tej risitë ligjore tryezat për unifikim të praktikës gjyqësore, luftimi i korrupsionit, pastrimit të parave, dhuna në familje, mbrojtja gjyqësore sa i përket të drejtave të njeriut, çështjet ligjore nga fusha administrative veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Konfliktin Administrativ, aspekte tjera ligjore në çështje komerciale etj. Rritja e kapaciteteve të bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve ligjor si dhe stafi tjetër administrativ do të vazhdojë edhe më tej. Programi ofron mundësinë e ofrimit të trajnimeve nga modulet bazike dhe modulet trajnuese përshtatshëmrisht me kompetencat dhe funksionet e tyre të punës si dhe për përfitues tjerë nga profesionet e lira. Përveç trajnimeve me pjesëmarrje fizike, për disa module të veçanta që kanë të bëjnë me mos diskriminimin edhe e mundësimi i trajnimeve online përmes platformës së mësimin në distancë.

LISTA E AKTIVITETEVE TRAJNUESE SIPAS FUSHAVE 2025

Nr.	Penale	Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
1.	Tryezë për harmonizimin e praktikës gjyqësore në çështjet penale	një (1) ditë	Gjyqtarët e të gjitha niveleve	Tryezë	OPDAT
2.	Tryezë për harmonizimin e praktikës gjyqësore në çështjet penale në Gjykatën e Apelit	një (1) ditë	Gjyqtarët e Apelit	Tryezë	OPDAT
3.	Trajnim në luftimin e piraterisë digjitale dhe falsifikimin	një (1) ditë	Gjyqtaret, prokurorët, hetuesit policor	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
4.	Sekuestrimi dhe konfiskimi	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional dhe Hetuesit policor	Tryezë	OPDAT
5.	Hetimet financiare, shpëlarja e parave dhe veprat tjera të krimit të organizuar	dy trajnime nga dy (2) ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtare nga DKR, bashkëpunëtor profesional, Hetuesit Policor	Trajnim	(OPDAT trajnimin e parë)
6.	Veprat penale kundër detyrës zyrtare	dy (2) ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtar nga DKR dhe bashkëpunëtor profesional, Hetuesit Policor	Trajnim	OPDAT
7.	Mashtrimi në prokurim publik	dy (2) ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtare nga DKR, bashkëpunëtor profesional, Hetuesit Policor	Trajnim	OPDAT
8.	Ekstremizmi i dhunshëm, format e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit	tri (3) ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtare nga DKR, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor	Trajnim	BIRN
9.	Krimi Kibernetik	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor	Trajnim	KE/CYBERKOP
10.	Dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor	Trajnim	IRZ
11.	Zbatimi i Udhëzuesve për Politikën Ndëshkimore	një (1) ditë	Gjyqtaret dhe Prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional të të gjitha niveleve	Trajnim	OPDAT
12.	Masat e veçanta hetimore	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor, Hetuesit Policor	Trajnim	Akademia e Drejtësisë & OPDAT
13.	Veprat penale kundër integritetit seksual	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët policor	Trajnim	OPDAT
14.	Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore	një (1) ditë	Gjyqtaret, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Mbrojtësit e viktimave	Trajnim	OSBE
15.	Gjykimi në mungesë	një (1) ditë	Gjyqtarë dhe Prokurorë	Trajnim	OPDAT

16.	Artikulimi dhe mbështetja e aktakuzave/ vendimeve gjyqësore - shkrimi ligjor	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokuroret, bashkëpunëtor profesional	Trajnim	OSBE
17.	Krimet e luftës	Dy trajnime nga dy ditë	Gjyqtarët, Prokurorët e Shtetit, Avokatët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët Ligjor, Policët hetues	Trajnim	UNDP
18.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale	një (1) ditë	Gjyqtarë dhe Prokurorë	Trajnim	OPDAT
19.	Trafikimi me qenie njerëzore	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokuror, bashkëpunëtor profesional, zyrtar policor, mbrojtësit e viktimave, Hetuesit Policor	Trajnim	OPDAT
20.	Veprat Penale kunder mjedisit	një (1) ditë	Gjyqtarët, prokurorët, hetues policor dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
21.	Ankesa e të dëmtuarit në rastet e hedhjes së kallëzimit penal ose pushimit të hetimit	një (1) ditë	Prokurorët, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor, mbrojtësit e viktimave	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
22.	Hetimi dhe ndjekja e krimeve ekonomike	një (1) ditë	Gjyqtarët, prokurorët, hetues policor dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	OPDAT
23.	Masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedure penale	një (1) ditë	Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore, të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale	Trajnim	Akademia e Drejtësisë

**Totali: 23 tema trajnimi** **40 ditë**

Civile		Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
24.	Unifikimi i praktikës gjyqësore nga marrëdhëniet e detyrimeve	dy (2) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Apelit dhe Gjykatave Themelore	Tryezë	Akademia e Drejtësisë
25.	Unifikimi i praktikës gjyqësore në Gjykatën e Apelit	dy (2) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit	Tryezë	Akademia e Drejtësisë
26.	Anulimi i vendime gjyqësore - të gjeturat e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim	dy (2) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës Suprme, Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore	Tryezë	Akademia e Drejtësisë
27.	Unifikimi i praktikës gjyqësore në çështjet pronësore	dy (2) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Apelit dhe Gjykatave Themelore	Tryezë	Akademia e Drejtësisë
28.	Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile	një (1) ditë	Gjyqtarët e gjykatave themelore	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
29.	Procedurat gjyqësore të shpronësimit	një (1) ditë	Gjyqtarët e gjykatave themelore	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
30.	Mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
31.	Marrëdhëniet detyimore dhe sendore me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile	dy (2) ditë	Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore, në divizionin civil, gjyqtarët e gjykatës së Apelit në divizionin civil	Trajnim	Projekti për Fuqizimin e Përmbarrimit në Ballkan (BESP)
32.	Marrëdhëniet familjare me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile	dy (2) ditë	Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore, në divizionin civil, gjyqtarët e gjykatës së Apelit në divizionin civil	Trajnim	Projekti për Fuqizimin e Përmbarrimit në Ballkan (BESP)

<b>Totali: 9 tema trajnimi</b>		<b>15 ditë</b>			
<b>Drejtësia për fëmijë</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
<b>Civile</b>					
33.	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas	Trajnim	KOMF
34.	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas	Trajnim	IRZ
35.	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas	Trajnim	KOMF
<b>Totali: 3 tema trajnimi</b>		<b>3 ditë</b>			
<b>Penale</b>					
36.	Veprat penale kundër integritetit seksual	dy (2) ditë	Gjyqtar dhe prokuror, zyrtar nga zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, bashkëpunëtor profesional, zyrtar policor dhe Qendra për Punë Sociale dhe psikolog	Trajnim	KOMF
37.	Procedura penale që zhvillohet për fëmijë dhe të miturit	një (1) ditë	Gjyqtar dhe prokuror për të mitur, bashkëpunëtor profesional, shërbimi sprovues, zyrtar policor dhe Qendra për Punë Sociale dhe psikolog	Trajnim	KOMF
<b>Totali: 2 tema trajnimi</b>		<b>3 ditë</b>			
<b>Komerciale</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
38.	Ndryshimet me Hyrjen në Fuqi të Kodit të Ri Doganor dhe të Akcizave të Kosovës	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
39.	Zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale, markat tregtare dhe patenat	dy (2) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
40.	Njohja dhe Përmbartimi i Vendimeve të Arbitrazhit Vendor dhe të Huaj	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
41.	Implikimet Praktike të Ligjit për Shoqëritë Tregtare	dy (2) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale

42.	Kontratat në Ekonomi	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
43.	Procedura e Falimentimit	tri (3) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
44.	Shkëputja e Kontratës dhe Efektet e Shkëputjes	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
45.	Kontrata e Sigurimit dhe Kompensimi i Dëmit	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
46.	Marrëdhëniet Komerciale me Element të Huaj dhe Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në Çështje Komerciale	dy (2) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
47.	Kontrata e Ndërtimit	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
48.	Kontrata e Kredisë	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
49.	Njohuritë Financiare	një (1) ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	USAID Drejtësia Komerciale
<b>Totali: 12 tema trajnimi</b>		<b>17 ditë</b>			
<b>Administrative</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
50.	Ligji i ri për Konfliktet Administrative	dy (2) ditë	Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
51.	Tryezë e rrumbullakët për Harmonizimin e Praktikës gjyqësore në Konfliktin Administrativ	një (1) ditë	Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional	Tryezë	Akademia e Drejtësisë
52.	Veçoritë e Konfliktit të Jurisdiksionit të Plotë dhe Ekspertiza në Konfliktin Administrativ	një (1) ditë	Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
53.	Kontestet e punës - Ligji për Nëpunësit Civil	një (1) ditë	Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët e KPMK-së	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
54.	Praktikat gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e Mbrojtjes Ndërkombëtare të Refugjatëve	një (1) ditë	Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit dhe zyrtarë të	Trajnim	UNHCR/CRPK

			Komisionit Kombëtar për Refugjatë dhe Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim – MPB		
55.	Praktikat gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e shtetësisë dhe rreziku nga pa-shtetësia	një (1) ditë	Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkpunëtorët profesiona/zyrtarët ligjor në këto gjykata, zyrtarë të Komisionit Kombëtar për Refugjatë dhe Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim - MPB dhe institucioneve tjera	Trajnim	UNHCR/CRPK
56.	Tryezë mbi sfidat në vendosjen meritorë të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe shtetësi	një (1) ditë	Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit, bashkpunëtorë profesional/zyrtarë ligjor, zyrtarë të Komisionit Kombëtar për Refugjatë, zyrtarë të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim-MPB, zyrtarë të Agjencionit për Ndihmë Juridike Falas, zyrtarë të Odës së Avokatëve	Tryezë	UNHCR/CRPK
<b>Totali: 7 tema trajnimi</b>		<b>8 ditë</b>			
<b>Kushtetuese</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
57.	Çështjet aktuale në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin penale	një (1) ditë	Gjyqtarët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës	Trajnim	KE/ Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>Totali: 1 temë trajnimi</b>		<b>1 ditë</b>			
<b>KEDNJ</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
58.	Liria e Shprehjes	një (1) ditë	Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	KE/PROFEX
59.	Procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas Nenit 6 të KEDNJ: Zgjatja e paarsyeshme e procedurave civile dhe penale në jurisprudencën e GJEDNJ	dy (2) ditë	Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	KE/ Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës

					Evropiane për të Drejtat e Njeriut
60.	Mjetet Efektive Juridike sipas Nenit 13 të KEDNJ-së: Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në çështjet civile dhe penale	një (1) ditë	Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	KE/ Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
61.	Përdorimi dhe referimi i jurisprudencës së GJEDNJ me rastin e shkrimit të vendimeve gjyqësore	dy (2) ditë	Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	KE/ Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
62.	Neni 5 i KEDNJ	një (1) ditë	Gjyqtarët, Prokurorët e Shtetit, Avokatët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët Ligjor, Policët hetues	Trajnim	KE/ Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>Totali: 5 tema trajnimi</b>		<b>7 ditë</b>			
<b>E Drejta Evropiane</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
63.	Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
64.	Bashkëpunimi gjyqësor dhe i zbatuesve të ligjit në çështje penale	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 2 tema trajnimi</b>		<b>2 ditë</b>			
<b>Kundërvajtje</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
65.	Tërheqja e parashtruesit të kërkesës pas parashtrimit të kërkesës në lëmin e inspektoriatit	një (1) ditë	Gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni kundërvajtës, inspektorët në kuadër të drejtorive të inspektoriatit	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 1 temë trajnimi</b>		<b>1 ditë</b>			
<b>Ndërmjetësimi</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
66.	Ndërmjetësimi për gjyqtarë dhe prokurorë (në rastet penale) - Prishtinë	një (1) ditë	Prokurorët e Prokurorive Themelore dhe Gjyqtarët e Gjykatave Themelore (Departamentet Penale)	Trajnim	Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe



					Pajtimet/FMCS dhe INL
67.	Ndërmjetësimi për gjyqtarë dhe prokurorë (në rastet penale) - Gjilan dhe Ferizaj	një (1) ditë	Prokurorët e Prokurorive Themelore dhe Gjyqtarët e Gjykatave Themelore (Departamentet Penale)	Trajnim	Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe Pajtimet/FMCS dhe INL
68.	Ndërmjetësimi për gjyqtarë dhe prokurorë (në rastet penale) - Gjakovë dhe Prizren	një (1) ditë	Prokurorët e Prokurorive Themelore dhe Gjyqtarët e Gjykatave Themelore (Departamentet Penale)	Trajnim	Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe Pajtimet/FMCS dhe INL
69.	Ndërmjetësimi për gjyqtarë dhe prokurorë (në rastet penale)- Pejë dhe Mitrovicë	një (1) ditë	Prokurorët e Prokurorive Themelore dhe Gjyqtarët e Gjykatave Themelore (Departamentet Penale)	Trajnim	Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe Pajtimet/FMCS dhe INL
70.	Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, zhvillimi i saj në ndërmjetësim të detyrueshëm veçanërisht në raste familjare dhe aprovimi ose anulimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit (në rastet civile) Prishtinë, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë	një (1) ditë	Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe degëve, ndërmjetësuesit e regjioneve të atyre gjykatave	Trajnim	USAID Drejtësia Komerçiale
71.	Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, zhvillimi i saj në ndërmjetësim të detyrueshëm veçanërisht në raste familjare dhe aprovimi ose anulimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit (në rastet civile) Prizren, Pejë dhe Gjakovë	një (1) ditë	Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe degëve, ndërmjetësuesit e regjioneve të atyre gjykatave	Trajnim	USAID Drejtësia Komerçiale
<b>Totali: 6 tema trajnimi</b>		<b>6 ditë</b>			
<b>Trajnimet Interdisiplinare</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
72.	Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor	Trajnim	OSBE
73.	Etika Profesionale	një (1) ditë	Gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve	Trajnim	OSBE
74.	Menaxhimi i seancave gjyqësore	një (1) ditë	Gjyqtarë, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor	Trajnim	KE/CEPEJ
75.	Trajtimi i informacionit të klasifikuar në proceset gjyqësore	dy (2) ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor, zyrtarët e Agjencionit për mbrojtjen e informacionit të kalsifikuar	Trajnim	AD
76.	Menaxhimi i rasteve dhe i zyrës	një (1) ditë	Prokurorët e të gjitha niveleve	Trajnim	OPDAT

<b>Totali: 5 temë trajnimi</b>		<b>6 ditë</b>			
<b>Dhuna në Familje</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
77.	Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore	një (1) ditë	Gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistëve të tjerë	Trajnim	KE-Projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
78.	Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale	dy (2) ditë	Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorët profesional, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë	Trajnim	KE-Projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit & OPDAT & AIRE Centre
79.	Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare	dy (2) ditë	Gjyqtarë të gjykatave civile	Trajnim	KE-Projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
80.	Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën	dy (2) ditë	Prokurorët, gjyqtarët, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë tjerë (p.sh. ekzaminierët mjekoligjorë)	Trajnim	KE-Projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit & OPDAT
<b>Totali: 4 tema trajnimi</b>		<b>7 ditë</b>			
<b>Kundër Diskriminimit</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
81.	Mbrojtja gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit	një (1) ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, prokurorët	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 1 temë trajnimi</b>		<b>1 ditë</b>			
<b>Trajnimet për menaxhment</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>
82.	Menaxhimi i Gjykatës	një (1) ditë	Kryetarët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
83.	Menaxhimi i Prokurorisë	një (1) ditë	Kryeprokurorët, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve, Udhëheqësit rajonal të zyrës për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave	Trajnim	OPDAT
<b>Totali: 2 tema trajnimi</b>		<b>2 ditë</b>			
<b>Trajnimet për Bashkëpunëtorë Profesional dhe Zyrtar Ligjor</b>					
<b>Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional</b>		<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>

<b>PENALE - Materiale</b>				
Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përbashkimit të Kundërligjshmërisë, pjesa e Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat Penale kundër integritetit Seksual	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit, Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli: XXVI, XXIII, XXIX dhe XXX të KPK-së.	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 2 tema trajnimi</b>	<b>2 ditë</b>			
<b>PENALE - Procedurale</b>				
Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 2 tema trajnimi</b>	<b>2 ditë</b>			
<b>DREJTËSIA PËR TË MITUR</b>				
Parimet e procedurës ndaj të miturve, si dhe Masat dhe dënimet ndaj të miturve	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 1 temë trajnimi</b>	<b>1 ditë</b>			
<b>CIVILE - Materiale</b>				
E Drejta e trashëgimisë dhe e Drejta pronësore	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
E Drejta e punës dhe E drejta e Detyrimeve	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 2 tema trajnimi</b>	<b>2 ditë</b>			
<b>CIVILE - Procedurale</b>				
Proceduara kontestimore	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Proceduar përmbarimore dhe Ndërmjetësimi	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
E Drejta Familjare dhe Dhuna në familje	1 ditë trajnimi për një grup 30-35 veta	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 3 tema trajnimi</b>	<b>3 ditë</b>			
<b>Trajnimet për stafin administrativ prokurorial</b>				
<b>Tema</b>	<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>Në Bashkëpunim</b>

Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin prokurorial	një (1) ditë	Administratorët, shefi i ZML-së, referentët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët ligjor, sekretarët juridike, zyrtarët e informimit, njësi për vlerësimin e performances së prokurorëve	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm	një (1) ditë	Administratorët e prokurorive dhe zëvendësit e tyre, zyrtarët për marrëdhënie me publikun, stafi i zyrës së pranimit dhe të gjitha kategoritë e tjera të stafit administrativ që ka ndërveprim me qytetarë, palë dhe institucione të ndryshme	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Integriteti dhe sjelljet etike	një (1) ditë	Stafi administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Menaxhimi i kohës dhe stresit	një (1) ditë	Stafi administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Trajnimi për protokollin dhe Etiketa	një (1) ditë	Përfituesit e trajnimit janë stafi administrativ	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Mbrojtja e sinjalizuesve	një (1) ditë	Zyrtarët administrativ të prokurorive dhe zyrtarët për sinjalizimin në prokurori	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Ndërmjetësim - trajnimi për Nëpunësit e Gjykatave	dy (2) ditë	Nëpunësit për ndërmjetësim në Gjykatat Themelore dhe Prokuroritë Themelore (Departamentet Penale)	Trajnim	Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe Pajtimit/FMCS dhe INL
Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore	një (1) ditë	Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretarët juridike	Trajnim	OPDAT
<b>Trajnimi hyrese për stafin e sapo emeruar administrativ prokurorial</b>				
<b>MODULI I</b>				
Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale dhe Qasja në informacion, konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit të klasifikuar, si dhe mbrojtja e të dhënave (aktet përkatëse ligjore, aspektet praktike)	një (1) ditë trajnim për grupin e njëjtë	Stafi i sapo emeruar administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Hyrje në planifikim, menaxhim, menaxhimin e kohës dhe stresit, Komunikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm, puna në ekip, Koncepti i "Shërbimeve të Orientuara në Cilësi " dhe në shërbim të qytetarëve.	një (1) ditë trajnim për grupin e njëjtë	Stafi i sapo emeruar administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Hyrje në sistemin prokurorial të Kosovës, parimet dhe rregulloret Kushtetuese (Kapitulli 7), legjislacioni dhe institucionet relevante dhe Hyrje në administratën prokuroriale, legjislacioni përkatës, funksionet dhe përgjegjësitë	një (1) ditë trajnim për grupin e njëjtë	Stafi i sapo emeruar administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>MODULI II</b>				

Hyrje në punën e prokurorive; struktura, organogramet; kategoritë e stafit administrativ dhe të drejtat e detyrimit e tyre, Specifikat e punës në çështjet civile, çështjet penale dhe çështjet administrative; llojet e rasteve, aktet gjyqësore dhe seancat gjyqësore.	një (1) ditë trajnim për grupin e njëjtë	Stafi i sapo emeruar administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Rregullat dhe rregulloret kryesore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve (lëndëve)	një (1) ditë trajnim për grupin e njëjtë	Stafi i sapo emeruar administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Procedurat gjyqësore dhe detyrat përkatëse të personelit administrativ, dërgimi i thirrjeve, afatet dhe Prezantimi i llojeve të regjistrave dhe dokumenteve të mirëmbajtura nga stafi administrativ; rregullat dhe mostrat.	një (1) ditë trajnim për grupin e njëjtë	Stafi i sapo emeruar administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
<b>Totali: 14 trajnime</b>	<b>15 ditë</b>			

**Trajnimet për punësuarit e administratës të sistemit gjyqësor**

<b>Tema</b>	<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Nr i trajnimeve</b>	<b>Përfituesit</b>	<b>Grupet 30-35 pjesëmarrës</b>
Moduli 1 Hyrje në sistemin gjyqësor: integriteti dhe sjelljet etike e të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor dhe të drejtat e detyrimit e të punësuarit	1 ditë	12 trajnime	159	40 veta në grup 4 grupe (4 trajnime per modulin 1)
Moduli 2 Administrimi i punëve në zyrë: Njohuri për detyrat specifike të punës dhe njohuri të përgjithshme në SMIL, SQEP, sistemet audio-video në gjykata, E-pasuria dhe sisteme/platforma tjera që administrohen nga gjyqësori	1 ditë			40 veta në grup 4 grupe (4 trajnime per modulin 2)
Moduli 3 Siguria kibernetike, komunikimi zyrtar elektronik dhe cilësia e të dhënave	1 ditë			40 veta në grup 4 grupe (4 trajnime per modulin 3)
Moduli 4 Trajnim fillestar specifik I në fushën e komunikimit me media dhe publikun	1 ditë	1 trajnim	1	1 vetë në grup
Moduli 5 Trajnim fillestar specifik II në fushën e komunikimit me media dhe publikun në platforma elektronike	1 ditë	1 trajnim	1	1 vetë në grup
Moduli 4: Trajnim fillestar specifik I në çështjet ligjore	1 ditë	3 trajnime	102	30 vetë në grup
Moduli 5: Trajnim fillestar specifik II në çështjet ligjore	1 ditë	3 trajnime	102	30 vetë në grup
Moduli 4: Trajnim fillestar specifik I në fushën e buxhetit dhe financave	1 ditë	1 trajnim	9	9 vetë në grup
Moduli 5: Trajnim fillestar specifik II në fushën e buxhetit dhe financave	1 ditë	1 trajnim	9	9 vetë në grup
Moduli 4:	1 ditë	1 trajnim	4	4 vetë në grup

Trajnim fillestar specifik I në fushën e teknologjisë informative				
Moduli 5: Trajnim fillestar specifik II në fushën e teknologjisë informative	1 ditë	1 trajnim	4	4 vetë në grup
Moduli 4: Trajnim fillestar specifik I në fushën e përkthimeve	1 ditë	1 trajnim	2	2 vetë në grup
Moduli 5: Trajnim fillestar specifik II në fushën e përkthimeve	1 ditë	1 trajnim	2	2 vetë në grup
Moduli 4: Trajnim fillestar specifik I në fushën e logjistikës dhe infrastrukturës	1 ditë	1 trajnim	3	3 vetë në grup
Moduli 4: Trajnim fillestar specifik I në fushën e arkivës	1 ditë	1 trajnim	34	34 vetë në grup
Moduli 4: Trajnim fillestar specifik I në fushën e inspektimit gjyqësor	1 ditë	1 trajnim	4	4 vetë në grup
Moduli 5: Trajnim fillestar specifik II në fushën e inspektimit gjyqësor	1 ditë	1 trajnim	4	4 vetë në grup
Përdorimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL)	1 ditë	43 trajnime	1077	25 veta në grup
Përdorimi i Sistemit Qendror të Evidencës Penale (SQEP)	1 ditë	22 trajnime	554	25 veta në grup
Përdorimi i sistemit audio dhe video në gjykatë	1 ditë	27 trajnime	684	25 veta në grup
Përdorimi i Sistemit Elektronik të Dosjes së Gjyqtarit	1 ditë	1 trajnim	17	17 veta në grup
Përdorimi i Sistemit Elektronik të Dosjes së Administratës Gjyqësore	1 ditë	1 trajnim	11	11 veta në grup
Përdorimi i Sistemit për të hyra gjyqësore dhe depozita	1 ditë	1 trajnim	26	26 veta në grup
Përdorimi i sistemit për buxhet dhe financa	1 ditë	1 trajnim	29	29 veta në grup
Përdorimi i sistemit të E-pasurisë	1 ditë	1 trajnim	23	23 veta në grup
Përdorimi i sistemit të centralizuar të përkthimit	2 ore	18 trajnime	455	25 veta në grup
Përdorimi i sistemit të menaxhimit të ankesave në PZAP (SMA)	1 ditë	1 trajnim	8	8 veta në grup
Trajnim mbi kualitetin dhe barazimin e të dhënave	1 ditë	1 trajnim	9	9 veta në grup
Administrimi i dosjes së lëndës në sistemin gjyqësor	1 ditë	20 trajnime	675	35 veta në grup 20 grupe
Administrimi i dosjes në procedurën e ekzekutimit	1 ditë	8 trajnime	265	35 veta në grup 8 grupe

Dorëzimi i shkresave gjyqësore	1 ditë	3 trajnime	90	30 veta në grup 3 grupe
Aspekte operacionale të inspektimit gjyqësor	2 ditë	1 trajnime	15	15 veta në grup 1 grupe
Risitë ligjore në fushën e konfliktit administrativ dhe të procedurës së përgjithshme administrative	2 ditë	1 trajnime	37	37 veta në grup 1 grupe
Ndërmjetësimi gjatë procedurës gjyqësore	1 ditë	1 trajnime	10	1 grup
Drejtesia Tranzicionale sipas akteve juridike dhe dokumenteve strategjike vendore dhe instrumenteve juridike ndërkombëtare	1 ditë	1 trajnime	33	1 grup 33 grup
Teknikat e hartimit të raporteve	1 ditë	1 trajnim	30	30 veta në grup 1 grup
Shkathësitë ligjore dhe gjyqësorë	1 ditë	20 trajnime	693	35 veta në grup 20 grupe
Komunikimi i jashtëm dhe brendshëm	1 ditë	1 trajnime	38	38 veta në grup 1 grup
Protokolli në sistemin gjyqësor	1 ditë	7 trajnime	209	30 veta në grup 7 grup
Kodi i veshjes për nëpunësit në sistem gjyqësor	1 ditë	7 trajnime	181	25 veta në grup 7 grup
Evidenca qendrore penale	1 ditë	17 trajnime	569	35 veta në grup 35 grupe
Zbatimi i procedurave dhe rregullave konform akteve në fuqi të nxjerra nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1 ditë	1 trajnim	17	17 veta në grup 1 grup
Zbatimi i procedurave dhe rregullave konform akteve në fuqi të nxjerra nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1 ditë	2 trajnime	55	Rreth 27 veta në grup 2 grupe
Funksionimi dhe menaxhimi i pasurisë	1 ditë	1 trajnim	29	29 veta në grup 1 grup
Doracaku i punës së përkthyesve dhe interpretëve në sistemin gjyqësor (norma, raportimi etj)	3 orë /1 ditë	2 trajnime	57	29 veta në grup 2 grupe
Përdorimin e pajisjeve të përkthimit simultan	3 orë /1 ditë	2 trajnime	57	29 veta në grup 2 grupe
Përdorimi i programit të përkthimit me shkrim SDL Trados	1 ditë	2 trajnime	57	29 veta në grup 2 grupe
Trajnime Fillestare= 30				
Trajnime të vazhdueshme=215				
<b>Totali i trajnimeve 245</b>		<b>Ditë trajnimi 247</b>		

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA PENALE***



Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024



## 1. Tryezë për harmonizimin e praktikës gjyqësore në çështjet penale

Duke pasur parasysh se nga praktika gjyqësore vërehet se dalin vendime me interpretime të ndryshme të dispozitave ligjore qoftë materiale apo procedurale, dhe kjo cenon sigurinë juridike respektivisht barazinë e palëve para ligjit, qëllimi i kësaj tryeze është harmonizimi i praktikës gjyqësore në të gjitha nivelet e gjykatave.


### Objektivat

-  Unifikimi i praktikës gjyqësore në aspektin material dhe procedural në çështje penale.


### Përmbajtja

-  Interpretimi i dispozitave të kodit penal dhe procedural dhe ligjeve tjera relevante në fushën penale;
-  Temat specifike për tryezë do të përcaktohen paraprakisht duke u bazuar në problematikat që dalin nga praktika gjyqësore e në veçanti rrishtë që kanë kodet e reja.


### Metodologjia

-  Adresimi i dilemave do të bëhet përmes bashkëbisedimit dhe shkëmbimit të përvojave gjatë zbatimit të dispozitave ligjore gjatë punës së gjyqtarëve, kurse në përfundim të këtyre tryezave do të nxjerrën konkluzione me qëllim të zbatimit unik të dispozitave ligjore.

### Përfituesit

-  Gjyqtarët e të gjitha niveleve.

### Kohëzgjatja

-  Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.


Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnues, 25 korrik 2024



## 2. Tryezë për harmonizimin e praktikës gjyqësore në çështjet penale në Gjykatën e Apelit

Duke pasur parasysh se nga praktika gjyqësore dalin vendime me interpretime të ndryshme apo jo të njëjta të dispozitave ligjore qoftë materiale qoftë procedurale, dhe kjo cenon sigurinë juridike respektivisht barazinë e palëve para ligjit, qëllimi i kësaj tryeze është harmonizimi i praktikës gjyqësore në nivel të Gjykatës së Apelit nga perspektiva e gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.


### Objektivat

-  Objektiv kryesor i kësaj tryeze është roli i Gjykatës së Apelit në unifikimi i praktikës gjyqësore në aspektin e ligjit material dhe procedural në çështje penale brenda Gjykatës së Apelit, kjo duke pasur parasysh faktin se gjykata e apelit si instancë e shkallës së dytë e ka rolin edhe të harmonizimit dhe unifikimit e praktikës gjyqësore.

### Përmbajtja

-  Interpretimi i dispozitave të kodit penal dhe procedural dhe ligjeve tjera relevante në fushën penale;
-  Temat specifike për tryezë përcaktohen paraprakisht duke u bazuar në problematikat që dalin nga praktika gjyqësore e veçanti rrisitë që i kanë kodet e reja, politika ndëshkimore dhe temat tjera me interes në aspekt të trajtimit të barabartë.


### Metodologjia

-  Adresimi i dilemave do të bëhet përmes analizës së rasteve nga praktika gjyqësore në tema të veçanta dhe nxjerrjes së qëndrimeve për harmonizim të praktikave gjyqësore.

### Përfituesit

-  Gjyqtarët e Apelit.

### Kohëzgjatja

-  Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.




Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlersimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Agjencia për Pronësi Industriale – MINT








### 3. Trajnim në luftimin e piraterisë digjitale dhe falsifikimin

Hetimi i piraterisë digjitale është një proces kompleks që përfshinë teknika të avancuara të teknologjisë informative dhe bashëpunim ndërinstitucional për të identifikuar dhe ndaluar kryerësit e veprës penale. Trajnimi synon ndërtimin e kapaciteteve të prokurorëve dhe gjyqtarëve në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të piraterisë digjitale. Hetimet dhe ndjekja penale e krimeve të piraterisë digjitale i referohet kopjimit, shpërndarjes ose përdorimit të materialeve të mbrojtura me të drejtën autori (si filmat, muzikën, lojërat, softuerët) pa autorizimin e pronarit të ligjshëm. Kjo përfshin shkarkimin e paligjshëm të përmbajtjeve nga interneti, ndarjen e tyre përmes platformave Peer to Peer si dhe përdorimin e softveve të qarë (cracked). Pasojat e piraterisë digjitale përfshin dëmtimin ekonomik të industrive krijuese të shkeljës së të drejtave të autorit gjithashtu pirateria mund të rrezikojë përdouesin duke i ekspozuarve ndaj maluerve virueseve ose formave të tjera kibernetike.


#### Objektivat

-  Kuptojnë më tepër lidhur me piratërinë digjitale;
-  Arrijnë të sigurojnë informacione;
-  Identifikimi i metodave të grumbullimit të informacioneve.

#### Përmbajtja

-  Mbledhja e provave digjitale;
-  Përdorimi i mjeteve të avancuar teknologjike;
-  Monitorimi i platformave online dhe tregut të zi;
-  Ndjekja e pagesave financiare virtuale
-  Bashkëpunimi ndërkombëtar;
-  Identifikimi dhe zbulimi i piratëve;
-  Ndjekja penale dhe Sekuestrimi.


#### Metodologjia

-  Interpretimi i dispozitave ligjore, diskutimi interaktiv, trajtimi i rasteve nga praktika gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare.

#### Përfituesit

-  Gjyqtarët, prokurorët, hetuesit policor.

#### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Agjencia për Pronësi Industriale – MINT
- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Raporti i BE-së për Kosovën
- PKZMSA 2022-2026
- Pyetësori për gjyqtarë/prokuratorë për nevojat trajnuese
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Raporti mbi monitorimin e proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor

#### 4. Sekuestrimi dhe konfiskimi

Trajnimi synon ndërtimin e kapaciteteve të prokuratorëve dhe gjyqtarëve në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së paligjshme. Kodi i procedurës penale i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2023 ka paraparë procedura të reja sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit me qëllim të evitimit të sfidave dhe problemeve që janë hasur në praktikë. Po ashtu edhe Kodi Penal i aplikueshëm në nenin 92 ka paraparë ndryshime sa i përket konfiskimit të pasurisë përkatësisht të dobisë pasurore. Po ashtu edhe aplikimi i LKZK-ës ka pasur vështirësi në zbatimin e saj në praktikë dhe është identifikuar nevoja e zbatimit më të theksuar në të gjitha rastet ku plotësohen kushtet ligjore.





Sendet që i nënshtrohen Konfiskimit automatik a duhet ti nënshtrohet urdhrave ndalues përfundimtar nga ana e gjykatave. Kur konfiskimi nuk është i mundur gjykata urdhëron kryesin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose të konfiskoj çdo pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlershme. Dallimi midis sekuestrimit, konfiskimit dhe urdhrave ndalues, Në cilat raste mund të zbatohet LKZK-ja, Kërkesat për shitje të asetëve të sekuestruara gjatë procedurës penale, Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar, Trajtimi i sendeve që mund të shërbejnë si provë në procedurë penale dhe si pasuri e specifikuar.

#### Objektivat


- 🎯 Identifikimi i risive ligjore të Kodit të Ri të Procedurës penale për sekuestrimin dhe konfiskimin;
- 🎯 Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat në të gjitha nivelet;
- 🎯 Identifikimi i rasteve të vazhdimin të procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit edhe pas ngritjes së aktit akuzues;
- 🎯 Identifikimin i problemeve lidhur me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë;
- 🎯 Adresimi i problemeve përmes praktikës së njësuar gjyqësore si përfundim;
- 🎯 Adresimi i sfidatve rreth zbatimit të LKZ, për konfiskim dhe sekuestrim.

#### Përmbajtja

- 📄 Bazat e konfiskimit me theks të veçante neni 92 i KPRK-së;
- 📄 Kontrolli, sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi;
- 📄 Urdhri ndalues i përkohshëm dhe përfundimtar;

-  Zëvendësimi i vlerës së pasurisë;
-  Konfiskimi i pasurive shtese;
-  Hetimi për konfiskim;
-  Kërkesat dhe urdhrat për kufizim dhe kërkesat për verifikim të pasurisë sipas LKZK-së.


### **Metodologjia**

-  Tryezë e diskutimit.

### **Përfituesit**

-  Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional dhe Hetuesit policor.

### **Kohëzgjatja**

-  Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i Veprimit të Agjendës për Reformën Evropiane (PV ERA II)
- PKZMSA 2022-2026
- Plani Kombëtar për integrim Evropian 2023-2027
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokuratorë)
- Raporti i monitorimit të proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024








## **5. Hetimet financiare, shpëlarja e parave dhe veprat tjera të krimit të organizuar**

Pastrimi i parave dhe hetimi financiar janë vepra penale komplekse. Për hetimin e këtyre rasteve kërkohet koordinim institucional i shumë akterëve të sundimit të ligjit. Ndërlikueshmëria e hetimit dhe gjyqimit të veprës penale të pastrimit të parave po ashtu është e shfaqur edhe në praktikën gjyqësore. Pastrimi i parave si proces që përdoret për të fshehur burimin e parave ose pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale dhe përgjithësisht përfshin shndërrimin e të ardhurave të krimit në një formë "të ligjshme", e që në mënyrë të drejtpërsëdrejti po ndikojnë në dëmet e konsiderueshme financiare dhe në zhvillimin ekonomik të vendit paraqet sfidë të përgjithshme shoqërore por edhe sfidë për sistemin juridik në Kosovë. Pastrimi i parave edhe si fenomen por edhe si vepër penale është trajtuar nga prokuratorët dhe gjyqtarët, por në praktikën gjyqësore akoma ka sfida dhe dilema në drejtim të identifikimit të elementeve të veprave penale që ndërlidhen me pastrimin e parave dhe kualifikimin e saktë juridik të kësaj vepre penale. Fillimisht është kërkuar që për hetimin e pastrimit të parave të ekzistoj vepra penale bazë, që realisht ka komplikuar procedurën e hetimit.







Po ashtu sfida tjetër është në bashkëpunimin e brendshëm dhe ndërkombëtar duke përfshirë edhe institucionet tjera të cilat duhet të japin kontributin proaktiv në zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e kryesve, në mesin e të cilave përfshihen NJIF, Dogana dhe Administratën Tatimore dhe institucionet e tjera ligj zbatuese, si dhe institucionet financiare sikurse bankat, subjektet financiare jo banka dhe zyrat e këmbimit valutor, nëpërmjet kanaleve të transferimit të parave, pagesave apo kredisë. Vëmendje duhet drejtuar po ashtu praktikave të bashkëpunimit ndërkombëtar në mes organeve të ndjekjes së Republikës së Kosovës dhe organeve të ndjekjes së vendeve të Bashkimit Evropian dhe po ashtu vendeve që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Domosdoshmëria për zbatimin e dispozitave të Kodit Penal dhe ndryshmeve në Kodin e Procedurës Penale duke i ndërlidhur ato me dispozitat e ligjit të veçantë që trajton pastrimin e parave si vepër penale, si dhe ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, por edhe në standardet ndërkombëtare dhe në veçanti ato të Bashkimit Evropian, kërkon që t'i dallojnë krimet tatimore dhe doganore dhe ato që ndërlidhen me pastrimin e parave, të identifikojnë informacionin që mund ta marrin përmes kanaleve të FIU, Egmont, procedurat e vërtetimit të hyrave financiare nga veprat penale dhe të hyrave të ligjshme. Trajnimi ka fokus në veçanti elementet e veprës penale të pastrimit të parave, si dhe dallimi i pastrimit të parave i ndërlidhur dhe i pastrimit të parave i vetëm duke përfshirë hetimin dhe gjykimin si dhe praktikën gjyqësore e posaçërisht në praktikën e vendeve evropiane. Është me rëndësi që të këto vepra penale të hetohet veprimi kriminal, respektivisht aktiviteti kriminal dhe në këtë drejtim të zhvillohen hetimet.


## Objektivat

-  Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me kualifikimin juridik të shpëlarja e parave dhe veprat tjera të krimit të organizuar;
-  Dallojnë pastrimin e parasë të ndërlidhur me vepër penale tjetër dhe i pastrimin e parave si vepër penale e veçantë;
-  Kryejnë hetime pro aktive penale dhe financiare sigurojnë prova të pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura;
-  Identifikojnë kanalet e komunikimit në nivel vendor dhe ndërkombëtar për të drejtuar hetimin në drejtimin e duhur;
-  Zhvillojnë bashkëpunimin ndërkombëtar jo formal dhe formal me agjencitë dhe institucionet relevante në hetimin financiar, shpëlarja e parave dhe veprat tjera të krimit të organizuar;
-  Identifikojnë sfidat që mund të hasen në sigurimin e informacionit në nivel ndërkombëtar dhe të jene në gjendje që të gjejnë zgjidhjen e mundshme;
-  Shqiptojnë sanksione adekuate penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale.


## Përmbajtja

-  Baza ligjore, vendore dhe ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave, Hetimet financiare dhe veprat tjera të krimit të organizuar;
-  Elementet e veprës penale pastrimi i parave;
-  Fazat e pastrimit të parave;
-  Hetimi dhe siguri i provave në rastet e Hetimeve financiare, shpëlarja e parave dhe veprat tjera të krimit të organizuar;
-  Rast studimi nga praktika gjyqësore e Kosovës (Rasti NIKUMA);
-  Rast studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ (Rasti Zuchen vs Nederland).

## Metodologjia

-  Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokuroret nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtare nga DKR, bashkëpunëtor profesionalë (përfituesit e ndryshëm në dy tryezat e planifikuara), Hetuesit Policor.

## Kohëzgjatja

-  Dy trajnime nga dy (2) ditë (një janar-korrik dhe një shtator-dhjetor 2025)

Temë e identifikuar nga:

- Raporti i BE-së për Kosovën
- Plani Kombëtar për integrim Evropian 2023-2027
- PKZMSA 2022-2026
- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Plani Strategjik për përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## 6. Veprat penale kundër detyrës zyrtare

Korrupsioni në përgjithësi paraqet një sfidë të veçantë për zbatuesit e ligjit nga perspektiva e secilit organ i cili zhvillon procedurën penale për këto vepra penale. Qëllimi i këtij trajnimi është zhvillimi i njohurive të pjesëmarrësve përkitazi me veprat penale të korrupsionit, me fokus te disa vepra penale specifike të cilit më së shpeshti paraqiten në praktikën gjyqësore, të zhvillohen njohuritë e posaçme për të trajtuar elementet e këtyre veprave penale, do të trajtohen dashja dhe qëllimi për realizimin e përfitimit për vete apo personin tjetër, shkaktimin e dëmit apo shkelja e të drejtave të personave tjerë. Gjithashtu do të analizohen elementet objektive dhe subjektive të këtyre veprave penale.

Si çështje e rëndësishme në këtë temë dalin të jenë përcaktimi i elementeve objektive dhe subjektive të këtij kapitulli të veprave penale e veçanërisht përcaktimi i dashjes dhe qëllimit të përfitimit apo shkaktimin e dëmit, si aspekte të rëndësishme te kjo kategori e veprave penale.

### Objektivat

- 🎯 Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të kapitullit XXXIII të veprave penale të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare;
- 🎯 Identifikojnë elementet objektive dhe subjektive të veprave penale në kuadër të këtij Kapitulli;
- 🎯 Zgjerojnë njohuritë rreth pasojave dhe rrezikshmërisë së këtyre veprave penale.

### Përmbajtja


- 📄 Elementet objektive dhe subjektive të këtyre veprave penale;
- 📄 Dashja si element subjektiv i veprës penale, qëllimi i përfitimit apo shkaktimi i dëmit;
- 📄 Çështja e realizimit apo mos realizimit të dëmit apo përfitimit;
- 📄 Vlerësimi i provave bindëse (të drejtpërdrejta) dhe rrethanore;
- 📄 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar;
- 📄 Konflikti i interesit, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit;

### Metodologjia


- 📖 Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara prezantimi nga ana e trajnuesit dhe metoda interaktive me qëllim të nxitjes së diskutimeve përmes rasteve praktike.



## **Përfituesit**

 Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtarë nga DKR dhe bashkëpunëtor profesional, hetuesit policor.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti i BE-së për Kosovën
- Plani Kombëtar për integrim Evropian 2023-2027
- PKZMSA 2022-2026
- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Plani Strategjik për përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Trajnuesi i përhershëm

## 7. Mashtrimi në prokurim publik







Natyra e mashtrimit të prokurimit dallon ndërmjet tri fazave kryesore të ciklit të prokurimit; para-tenderimi, tenderimi dhe pas dhënies së kontratës. Mashtrimi në fazat e para-tenderimit dhe tenderimit është kompleks, shpesh i mundësuar nga mungesa e pajtueshmërisë me politikën, por gjithashtu përfshin aktivitete të tilla si marrëveshjet e paligjshme dhe korrupsionin, të cilat mund të jenë të vështira për t'u zbuluar. Mashtrimi në fazën pas dhënies së kontratës është dukshëm më ndryshe. Pasi që kontratat janë tashmë të nënshkruara, shumica e rasteve të mashtrimit priren të përfshijnë pagesa të tepërta për kontraktorët, përmes faturimit të rremë ose të dyfishtë, si dhe pagesa për punë nën standard ose punë të pakryera sipas kushteve të kontratës.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, vepra penale Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik, Neni 415 parasheh: “Kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe me qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik” Në kontekstin e zbulimit të korrupsionit dhe mashtrimit, do të ishte e dobishme që Prokurorët e Shtetit dhe gjyqtarët të njoftohen me fazat specifike të mashtrimit dhe korrupsionit në ciklin e prokurimit publik, siç rregullohet me LPP, pasi që secili cikël mund të ekspozohet ndaj rreziqeve specifike gjatë procesit të prokurimit publik, që mund të jetë lloj ndryshe i skemave mashtruese dhe korruptive. Një kombinim i indikatorëve të caktuar duhet të jetë alarm për prokurorët e shtetit se një skemë mashtrimi ose korrupsioni mund të ketë ndikuar në kontratën e prokurimit. Kështu, për të kuptuar korrupsionin në prokurimin publik, është e rëndësishme të kuptohet procesi i prokurimit. Siç është përmendur më lart, në përgjithësi ekzistojnë tri faza të procesit të prokurimit publik: faza para tenderimit, faza e tenderit dhe faza pas tenderit. Rreziqet e mashtrimit dhe korrupsionit ekzistojnë në gjithë ciklin e prokurimit.


### Objektivat

- 🎯 Kuptojnë përkufizimin e veprës penale keqpërdorimi dhe mashtrimit në prokurim;
- 🎯 Identifikojnë skemat mashtruese dhe të korrupsionit në fazat e prokurimit;
- 🎯 Identifikojnë flamujt e kuq në prokurim publik;
- 🎯 Dallimin midis shkeljeve administrative dhe pergjegjesisë penale;
- 🎯 Metodën e mashtrimit dhe keqpërdorimit në prokurim publik;
- 🎯 Kuptojnë përkufizimin e menaxhimit të kontratës;
- 🎯 Procesin e menaxhimit të kontratës.


## **Përmbajtja**

-  Vepra penale e mashtrimit në prokurim;
-  Vështirësitë e hetimit të veprës penale keqpërdorimi dhe mashtrimit në prokurim publik;
-  Fazat e prokurimit publik;
-  Metodatat dhe teknikat e hetimit;
-  Indikatorët e mashtrimit në fazat e prokurimit publik;
-  Integriteti në prokurim publik.


## **Metodologjia**

-  Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## **Përfituesit**

-  Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorë nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtor profesionalë, hetuesit policor.

## **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- PKZMSA 2022-2026
- Plani Kombëtar për integrim Evropian 2023-2027
- BIRN
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Raporti i BE-së për Kosovën
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Trajnuesi i përhershëm
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## **8. Ekstremizmi i dhunshëm, format e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit**





Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë, si në nivel nacional njashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën e individit, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e funksionimit të shoqërisë. Shteti ka detyrimin dhe mbart përgjegjësinë kryesore për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, si edhe për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të Republikës së Kosovës. Strategjia kundër terrorizmit si dhe masat tjera legjislative dhe politike në kuadër të kësaj fushe, janë të ndërlidhura me prioritet strategjike për “Qeverisja të Mirë dhe Sundimit të Ligjit.” Për shkak të pranisë së elementëve të ekstremizmit dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm, janë hartuar një mori instrumentesh të rëndësishëm ligjor, ku fokus ka qenë lufta efikase ndaj këtyre dukurive të kundërligjshme, gjithnjë nga perspektiva e instrumenteve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht ndjekjes dhe gjyqimit. Marrë në konsideratë nevojën e ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe të zyrtarëve tjerë të agjencive ligj-zbatuese shihet e domosdoshme që ky komunitet i ligj-zbatuesve të përfitojnë nga këto cikle trajnimesh me synim të ngritjes së njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në funksion të parandalimit, hetimit dhe gjyqimit efektiv, të pavarur dhe profesional.

### **Objektivat**


- 🎯 Avancojnë njohuritë rreth kornizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit;
- 🎯 Kuptojë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin;
- 🎯 Demonstrojnë teknikën e hetimit dhe të provuarit të ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit, me theks të veçantë për liritë dhe të drejtat e njeriut, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mbrojtjen e viktimave;
- 🎯 Krahasojë lidhjet ndërmjet ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit;
- 🎯 Zbatojë drejtë ligjin lidhur me sanksionet penale ndaj kryerësit të veprave penale të ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit.

### **Përmbajtja**


- 📄 Korniza ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit;
- 📄 Përballja me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin;

-  Strategjia kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit në Kosovë;
-  Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit, si fokus strategjik i përpjekjeve antiterroriste;
-  Raporti midis ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit dhe veprave tjera penale.
-  Format dhe financimi i terrorizmit.


## **Metodologjia**

-  Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## **Përfituesit**

-  Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtor profesionale, zyrtar ligjor.

## **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë tri (3) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Trajnuesi i përhershëm
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## 9. Krimi Kibernetik

Me rritjen e përdorimit të internetit dhe teknikave të sofistikuara, lirisht mund të thuhet se gjendemi në një revolucion teknologjik, prandaj edhe krimi Kibernetikë është sfidë për shoqërinë e sotme. Përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe veçanërisht i internetit ka marrë një rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Ky fenomen prek jo vetëm aktivitetet e një organizimi qoftë ai shtetëror apo privat, implikuar në sferën e biznesit apo të një aktiviteti jo fitimprurës, por mund të prekë dhe njeriun e thjeshtë në aktivitetin e tij të përditshëm, në sferën e tij private apo profesionale. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime por në të njëjtën kohë edhe një sërë problemesh.







Lufta kundër krimit kibernetike është tepër sfiduese, sidomos pas pandemisë, kemi rritje të dukshme të këtyre krimeve. Për shkak të natyrës dinamike të teknologjisë, modus operandi i individëve të përfshirë në këto aktivitete ndryshon shpesh, duke i bërë më të vështirë për tu ndaluar. Hapësira kibernetike sot është një nga sfidat më të mëdha ligjore e cila ka nxitur një formë tjetër të krimit, duke krijuar një mjedis për metodat e reja të krimit, tani pothuajse të gjitha krimet mund të kryhen me përdorimin e kompjuterëve. Krimi kibernetikë është një fenomen që prek një sërë kompetencash, si ato në fushën e informatikës, energjetikës, kriminologjisë, ekonomisë, mjekësisë, drejtësisë si dhe shumë fusha tjera.

Duke qenë një teknologji “e liberalizuar” prej disa kohësh, s’ka diskutim se përfitimet që sjell përdorimi i kësaj teknologjie janë të mëdha. Sipas strategjisë të sigurisë kibernetike të Bashkimit Evropian kriminaliteti kibernetikë i referohet përgjithësisht një spektri të gjerë veprimtarish kriminale të ndryshme, ku kompjuterët dhe sistemet informative angazhohen ose si vegël primare ose si shënjestër primare. Krimi kibernetikë përfshin veprat penale tradicionale (p.sh. mashtrimi, falsifikimi dhe thyerja e identitetit), veprat në lidhje me përmbajtjen (p.sh. shpërndarja në internet e pornografisë së fëmijëve apo nxitja e urrejtjes racore), si dhe veprat që janë unike për kompjuter dhe sisteme informative (p.sh. sulmet ndaj sistemeve informative, mohimi i shërbimit dhe mallrave). Bazuar në zhvillimin e madh që ka teknologjia informative, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jenë të përgatitur për të gjykuar krimin kibernetikë dhe shqyrtuar provat elektronike. Megjithëse në shumë vende, autoritetet e zbatimit të ligjit i kanë forcuar kapacitetet e tyre për hetimin e krimit kibernetikë dhe sigurimin e provave elektronike, kjo gjë nuk ndodh me gjyqtarët dhe prokurorët.









Përvoja të sugjeron se në shumicën e rasteve, gjyqtarët dhe prokurorët hasin vështirësi në përballjen me realitetet e reja të botës kibernetike. Për këtë arsye, kërkohen përpjekje të posaçme për të aftësuar gjyqtarët dhe prokurorët që të mund të ndjekin ligjërisht dhe gjykojnë krimin kibernetikë dhe të shfrytëzojnë provat elektronike nëpërmjet trajnimit, lidhjes në rrjet dhe specializimit. Kriptoalutat janë bërë një temë shumë e spikatur dhe e diskutueshme edhe në mesin e profesionistëve të sektorit privat dhe publik që janë të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave. Kriptoaluta më e mirënjohur, Bitcoin ka ngjallur shumë interesim posaçërisht për faktin se mediat vazhdojnë të merren me një numër të hetimeve dhe të ndjekjeve me profil të lartë në tërë botën.

Ky trajnim ka për qëllim që t'i adresohet audiencës së agjencive për zbatimin e ligjit, prokurorëve dhe përfaqësuesve të Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF) që janë të angazhuar në hetime financiare, ndjekje penale që përfshijnë krim ekonomik dhe rikuperimin e pasurive të paligjshme. Trajnimi do të eksplorojë dhe do të thellojë eksperiencën dhe ekspertizën e praktikuesve nga, zyratë prokurorisë dhe NjIF në përcjelljen e rrjedhave të paligjshme financiare të kanalizuarra përmes kriptovalutave.


## Objektivat

-  Zgjerojnë njohuritë për Krimin Kibernetikë si vepër penale në legjislacionin e brendshëm;
-  Identifikojnë fushën e krimit kibernetikë – tendencat dhe instrumentet;
-  Avancojnë njohuritë rreth teknologjisë e përfshirë në krimin kibernetik;
-  Zbatojnë drejtë legjislacionin, procedurat dhe praktika në lidhje me provat elektronike;
-  Ligji procedural/masat hetimore në legjislacionin e brendshëm;
-  Njohin Legjislacionin ndërkombëtar dhe Bashkëpunimin ndërkombëtar.

## Përmbajtja

-  Njohurit lidhur me krimin kibernetikë;
-  Mbrojtja e informatave të klasifikuara për mbrojtjen e sigurisë shtetërore;
-  Veprat penale lidhur me krimin kibernetikë;
-  Provat elektronike në procedurë penale;
-  Sigurimi dhe ruajtja e provave elektronike;
-  Bashkëpunimi ndërkombëtar;
-  Sigurimi i provave nga rrjetet sociale;
-  Sekuestrimi.

## Metodologjia

-  Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## Përfituesit

Gjyqtarët, Prokuroret, bashkëpunëtor profesionale, zyrtar ligjor.

## Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## 10. Dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, njeh si kategori të posaçme dëshmitarët dhe të dëmtuarit, që për shkak të rrezikut serioz që u kanoset atyre apo anëtarëve të familjes së tyre, mund të kenë nevojë për mbrojtje. Në praktikë ka shumë raste që të dëmtuarit dhe dëshmitarët nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën dhe pasurinë e tyre dhe anëtarëve të familjes së tyre. Andaj, në procedurën penale, mbrojtjes së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur dhe i veçantë, në mënyrë që të njëjtit mos të kenë frikë për të dëshmuar dhe bashkëpunuar më zbatuesit e ligjit, në njërën anë dhe në anën tjetër aq sa është e mundur të sigurohet shëndeti, jeta dhe pasuria e tyre.








Meqenëse në praktikën gjyqësore ende ka dilema se si duhet trajtuar rastet e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve të mbrojtur, gjatë këtij trajnimi do të shtrohen pyetje si në vijim: Çka kuptojmë me rrezik serioz? Çka është anonimiteti? Cili është dallimi në mes të dëshmitarëve të mbrojtur nga publiku dhe dëshmitarëve anonim? Cili është dallimi në mes të dispozitave të KPPK, për masat e nevojshme për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, në raport me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve? Cilat procedura duhet ndjekur për të mbrojtur të dëmtuarin dhe dëshmitarin etj. Dhënia e përgjigjeve të sakta dhe të qarta për pyetjet e tilla do të dërgojë deri të zbatimi më i mirë dhe më i drejtë i dispozitave ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve.

Pjesëmarrësve do tu mundësohet qasja në raste praktike të përgatitura enkas për këtë trajnim, ku mund të shihen sukseset dhe dështimet në rastin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të dëmtuarve. Shumicën e rasteve shqyrtimi kryesor është rezultati i pritshëm i çfarëdo hetimi apo aktakuze. Mirëpo, ekzistojnë alternativa që gjykata i mbështet siç është marrëveshja për pranimin e fajësisë. Arsyeja e pare perse prokurori i shtetit kërkon alternativa është avancimi i hetimeve, pasi që marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të rezultojnë në atë që i pandehuri të behet dëshmitar bashkëpunues. Në këtë mënyrë, i pandehuri mund të sigurojë prova shtese kundër personave tjerë të cilët kanë kryer vepra penale dhe në këtë mënyrë të avancojnë hetimet. Ky është mjet i rëndësishëm për hetimet e ndërlikuara, veçanërisht për krimin e organizuar dhe korrupsionin.











Si merret iniciativa për negociimin e marrëveshjes? Cilat janë kushtet ligjore për arritjen e marrëveshjes? Në cilat faza mund të arrihet marrëveshja për pranimin e fajësisë? Cilat janë benificionet e shtetit dhe cilat ato të pandehurit? Cilat dënime mund të rekomandohen në marrëveshje? Cili është roli i gjykatës në arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë? Ky program është hartuar për të shpjeguar rreth mundësisë se arritjes se marrëveshjes për pranimin e fajësisë, hapat që duhet të ndërmerren nga palët në procedure lidhur me fillimin e negociatave për arritjen e marrëveshjes, përshkrimi i veprimeve të të gjitha palëve në kuadër të negociatave për arritjen e marrëveshjes, përmbushja e kushteve ligjore që marrëveshja të pranohet nga gjykata, si dhe rolin e secilit organ shtetëror në arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.




## Objektivat

-  Kuptojnë rolin dhe statusin e dëshmitarëve të mbrojtur;
-  Dallojnë kushtet ligjore për caktimin e masave mbrojtëse dhe anonimitetit;
-  Analizojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë;
-  Vlerësojnë kushtet ligjore dhe fazat e procedurës kur mund të arrihet marrëveshja;
-  Vendosin lidhur me dënimet që mund të rekomandohen në marrëveshje;
-  Vlerësojnë programin për mbrojtjen e dëshmitarëve;
-  Kuptojnë rolin dhe statusin e dëshmitarit bashkëpunues në procedurë penale.

## Përmbajtja

-  Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve në procedurë penale;
-  Kërkesat për masat mbrojtëse apo anonimitetit;
-  Urdhrat për masa mbrojtëse dhe anonimitet;
-  Kushtet e negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë;
-  Të drejtat e viktimës dhe të dëmtuarit në rastet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë;
-  Shqyrtimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.
-  Kushtet e marrëveshjes me dëshmitarët bashkëpunues;
-  Statusi dhe roli i dëshmitarit bashkëpunues në procedurë penale;
-  Deklarimi i dëshmitarit bashkëpunues në procedurë penale;
-  Zvogëlimi i dënimit të dëshmitarëve bashkëpunues pas aktgjykimit.


## Metodologjia

-  Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesionalë, zyrtar ligjor.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Trajnuesi i përhershëm
- Raporti i EULEX
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 - KPK

## 11. Zbatimi i Udhëzuesve për Politikën Ndëshkimore

Qëllimi i këtij trajnimi është zhvillimi i njohurive të pjesëmarrësve përkitazi me zbatimin e Udhëzuesve për Politikën Ndëshkimore, me fokus të Udhëzuesit të përgjithshëm, si dhe udhëzuesve specifik të cilat janë të rëndësishme për unifikimin e dënimeve të shqiptuara. Gjithashtu, qëllimi i trajnimit është zbatimi i mirëfilltë i metodave të matjes së dënimit nga të gjithë gjyqtarët, por njëkohësisht që prokurorët dhe mbrojtësit e viktimave të mund të kontribuojnë në ndriçimin e rrethanave para gjykatës që do të ndikojnë për matjen e drejtë të dënimit, në përputhje me udhëzuesit e politikës ndëshkimore.










Politika ndëshkimore ka paraqitur sfidë të vazhdueshme për gjyqtarët me rastin e caktimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Përgjithësisht janë identifikuar probleme të theksuara dhe trajtim i pabarabartë i krzërësve të veprave penale dhe mos konsistencë në shqiptimin e dënimeve dhe kjo ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e transparencës dhe besimin e publikut. Për të adresuar këto të meta, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr udhëzuesin për politikën ndëshkimore dhe tabelën për caktimin e dënimit për kryerësin e veprës penale dhe veprën penale të kryer. Njëkohësisht është formuar Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore i cili në vazhdimësi përcjellë dukuritë dhe sfidat që gjyqtarët përballen me rastin e zbatimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore dhe gjatë punës së tij në vazhdimësi nxjerr udhëzime specifike përkitazi me harmonizimin e politikës ndëshkimore dhe të cilat do të prezantohen dhe diskutohen gjatë këtyre tryezave që planifikohen të organizohen. Aspekti i politikës ndëshkimore del të mos jetë problem vetëm i gjyqësorit, por edhe i Prokurorisë e që për këtë arsye është nxjerrë Udhëzues për rolin e prokurorit të shtetit me synim të qartësisë dhe shpjegimit të rolit të prokurorit gjatë të gjitha fazave të procedurës penale në përgatitjen, mbledhjen e informacioneve dhe prezantimin me sukses para gjykatës gjatë seancës për matjen e dënimit.

Si çështje e rëndësishme në këtë temë dalin të jenë zbatimi i Udhëzuesit të përgjithshëm dhe udhëzuesve specifik, përcaktimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe veçmas aplikimi i gabuar i këtyre rrethanave me fokus të çmuarjes së elementeve të veprave penale si rrethana rënduese.


### Objektivat

- 🎯 Analizojnë zbatimin e udhëzuesit të përgjithshëm dhe Udhëzuesve specifik dhe aktivitetin e Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore;
- 🎯 Kuptojnë udhëzuesin për rolin e prokurorit në politikën ndëshkimore;
- 🎯 Zbatojnë rrethanat relevante me rastin e caktimit të dënimit;
- 🎯 Analizojnë rëndësinë e përcaktimit të drejtë dhe të saktë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese.


## Përmbajtja

-  Aktiviteti i Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore;
-  Zbatimi i udhëzuesve për politikën ndëshkimore me fokus Udhëzuesin e Përgjithshëm;
-  Metodologjia e zbatimit të udhëzuesit për matjen e dënimit;
-  Rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të dënimit;
-  Metodologjia e vlerësimit të rrethanave të kategorisë së përgjegjësisë dhe të demit;
-  Ndarja e kategorive për matjen e dënimit për veprat penale të korrupsionit;
-  Unifikimi i praktikës për matjen e ndikimit të trajnimit;
-  Seanca për matje të dënimit;
-  Përgatitja, argumentimi bindës për caktimin e dënimit të duhur para gjykatës.


## Metodologjia

-  Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke filluar nga prezantimi nga ana e trajnuesve dhe gjithashtu do të përdoret metoda interaktive me qëllim të nxitjes së diskutimeve përmes analizës së rasteve praktike.

## Përfituesit

-  Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional të të gjitha niveleve.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:







- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnues, 25 korrik 2024
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)

## 12. Masat e veçanta hetimore








Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësve në rend të parë, t'iu ofrohen njohuri teorike dhe praktike me rastin e aplikimit të dispozitave përkatëse për marrjen e informatave në fazën e hetimeve përkatësisht zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Pra, objektivi i trajtimit në këto ligjërata janë dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë çështjen e hetimit, pezullimit, pushimit dhe rifillimit të hetimit, si dhe institutin e masave të veçanta hetimore gjatë procedurës penale në fazën e hetimeve. Hetimi penal është një nga fazat kryesore të procedurës penale. Gjatë hetimit penal, prokurori është në gjendje të sigurojë që mbledhja e provave kryhet në përputhje me ligjin dhe se ato ruhen dhe analizohen ashtu si duhet, në mënyrë që të mund të përdoren në gjyq. Për ta përmbledhur, roli i prokurorit në hetim është mjaftë i rëndësishëm dhe përfshin elementët e mëposhtëm: të sigurojë që puna hetimore përqendrohet tek elementet e krimit; të sigurojë që puna gjatë hetimit është e strukturuar dhe e koordinuar; të sigurojë që provat mblidhen në përputhje me ligjin; të sigurojë që provat ruhen në mënyrën e duhur; të sigurojë që provat analizohen në mënyrën e duhur; dhe të sigurojë që provat janë të përdorshme në gjykim. Një nga fushat apo temat më të rëndësishme, gjithsesi janë masat e veçanta hetimore dhe zbatimi i tyre, të cilat ndodh që të janë marrë nga rastet e cenimit ose ndërhyrjes serioze dhe kufizimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut ndaj të akuzuarit dhe personave të tjerë. Për këtë arsye, duhet të pamundësohet arbitrariteti në zbatimin e këtyre masave nga ana e organeve të autorizuara për shkak të rrezikut të shkeljes ose kufizimit të të drejtave me të cilat ruhet integriteti dhe fshehtësia e komunikimeve personale të personit që është i përfshirë në këto masa.

Qëllimi i zbatimit të këtyre masave ka qenë dhe është parandalimi i kryerjes së veprave penale, zbulimi më efikas i veprave penale, si dhe ndjekja e kryesve të veprave penale për rastet kur nuk mund që të zbulohen me veprime tjera hetimore. Sipas Kodit të Procedurës Penale janë paraparë 12 masa të veçanta hetimore, ashtu që disa prej tyre të cilat janë më pak ndërhyrëse në të drejtat e qytetarit autorizohen nga prokurori i shtetit, ndërsa disa të tjera nga gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit. Këto masa pa dyshim që prekin në privatësinë e jetës së njeriut dhe në liri të drejtat e tij, dhe për ata është edhe i kushtëzuar me ligj lejimi i lëshimit të këtyre masave, mirëpo për hir të parandalimit të kryesve të veprave penale këto masa do të aplikohen kur me masat tjera nuk mund të arrihet një informacion apo zbulimi i kryesit të veprës penale dhe do të tentohet që sa më pak të preket në të drejtat e njeriut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 36, “E Drejta e Privatësisë”, parasheh “Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.” Siç e dimë, mbrojtja (pozitive) e jetës private dhe familjare në kuadrin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashihet në dy nene, nenit 8 dhe 12 të cilët përcaktojnë se “çdo individ ka të drejtë për respektimin e jetës private dhe familjare, të vendbanimit dhe të korrespondencës” (paragrafi i parë).


## Objektivat

-  Identifikojnë rastet se kur lejohet përdorimi i masave të fshehta dhe për cilat vepra penale lejohen masat;
-  Kuptojnë natyrën dhe kufijtë e përdorimit të një mjeti të caktuar të fshehtë, proporcionalitetit dhe domosdoshmëria;
-  Identifikojnë kushtet dhe kriteret e përdorimit, subjektet kundër të cilëve mund të përdoren, kohëzgjatjen e tyre, mënyrën, etj.;
-  Vlerësojnë trajtimin dhe shkatërrimin e materialit dhe të dhënave personale të marra, si rezultat i përdorimit të këtyre masave të fshehta;
-  Identifikojnë përgjegjësinë e zyrtarëve policor në përdorimin e tyre dhe llogaridhënien lidhur me autorizimin dhe përdorimin e masave;
-  Vlerësojnë pranueshmërinë e provave dhe të informacionit të mbledhur si rezultat i përdorimit të tyre.


## Përmbajtja

-  Zhvillimi i planit hetimor;
-  Sigurimi i provave gjatë fazës së hetimit;
-  Fillimi, pezullimi, pushimi dhe rifillimi i hetimeve;
-  Qëllimi dhe llojet e masave të veçanta hetimore;
-  Kushtet ligjore dhe urdhrat për masat e veçanta hetimore;
-  Zbatimi dhe kohëzgjatja e masave të veçanta hetimore;
-  Pranueshmëria e provave të siguruar nga masat e veçanta hetimore.


## Metodologjia

-  Trajnimi, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor, hetuesit policor.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Institucioni i Avokatit të Popullit – IAP
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

### 13. Veprat penale kundër integritetit seksual

Ndjeshmëria e veprave penale kundër integritetit seksual kërkon një trajtim më të detajuar për të hequr dilemat nga fakti se dispozitat ligjore lënë vend për interpretim dhe konfuzion. Po ashtu, në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër integritetit seksual ndër të tjera parasheh edhe disa vepra që prekin integritetin seksual të fëmijëve. Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga ky kapitull shpesh herë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përfshirë kujdesin gjatë marrjes së deklaratës së viktimës në veçanti viktimës fëmijë, aplikim i dispozitave ligjore të KDM-së lidhur me marrjen e deklaratës së viktimës jo më shumë se dy herë gjatë zhvillimit të procedurës penale, sqarimi-interpretimi i dispozitave ligjore të (mos) dhënia e pëlqimit të fëmijës lidhur me veprimet e të pandehurit në drejtim të fëmijës, prezenca e personave që duhet të jenë prezent gjatë marrjes së deklaratës, përmirësimi i bashkëveprimi dhe koordinimit institucional për një siguri maksimale për viktimën gjatë të gjithë procesit ligjor, zhvillimi i njohurive në zbatimin e protokollit shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale nga të gjithë profesionistët pjesëmarrës. Çka nënkupton integriteti seksual, ku qëndron dallimi midis sulmit seksual dhe ngacmimit seksual, cili është dallimi midis viktimës dhe të dëmtuarës.

#### Objektivat

- 🎯 Zgjerimi i njohurive lidhur me procedurën penale kur fëmija është viktimë;
- 🎯 Analizimi dhe format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera lidhur me integritetin seksual;
- 🎯 Zbatimi i kufizimit ligjor rreth marrjes së deklaratës së viktimës fëmijë dhe prezenca e përfaqësuesve të nevojshëm institucional;
- 🎯 Aspektet psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve-viktima të dhunës seksuale.

#### Përmbajtja

- 📄 Veprat penale nga kapitulli XX i Kodit Penal të Republikës së Kosovës,
- 📄 Keqpërdorimi apo shfrytëzimi seksual i personave me çrregullime mendore ose paaftësi mendore ose emocionale;
- 📄 Sigurimi i provave materiale dhe personale;
- 📄 Ekzaminimet mjekësore, mjeko ligjore të viktimës dhe të kryesit.
- 📄 Marrja e deklaratës të dëmtuarës – viktimë fëmijë
- 📄 Kujdesi në qasje për shkak të ndjeshmërisë të viktimë fëmijë;
- 📄 Respektimi i konfidencialitetit të procedurës dhe privatësia e fëmijës;
- 📄 Njohuri mbi protokollin shtetëror dhe zbatimi i tij;
- 📄 Bashkëpunimi ndër institucional në kryerjen e veprimeve të nevojshme në trajtimin e rastit dhe sigurimin.

## **Metodologjia**



Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## **Përfituesit**



Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesionale, zyrtar ligjor, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët policor.

## **Kohëzgjatja**



Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje 2021-2026
- Programi Kombëtar për të Drejtat e njeriut

#### **14. Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore**

Kodi i Procedures Penale personat me çrregullime mendore i percakton si kategori e veçantë e kryerësve të veprave penale, kështu që edhe me KPPK është parashikuar procedurë specifike tek rastet kur përfshihen këta persona si kryerës të veprave penale. Gjendja e posaçme mendore në të cilën gjenden kjo kategori e kryesve të veprave penale e arsyeton përcaktimin e masave të posaçme ligjore, përkatësisht masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, si reagim ndaj tyre për veprat penale që ata kryejnë. Gjithashtu, kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre janë të kushtëzuara nga gjendja mendore e kryerësit të veprës penale. Përcaktimi vendimtar i llojeve të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe kushteve ligjore për shqiptimin e masave të tilla, ka rëndësi të dyanshme si: mbrojtjen e shoqërisë nga sjelljet kriminale të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmërinë esenciale të zvogëluar dhe me mbrojtjen e dinjitetit të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar, kryerëse të veprave penale. Duke analizuar kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe qëllimin që duhet të arrihet me anë të ekzekutimit të tyre shohim që papërgjegjshmëria e kryerësit të veprës penale dhe rreziku për përsëritjen e sjelljeve kriminale janë faktorë kyç për shqiptimin e masave të tilla. Ky trajnim do të fokusohet në analizimin e procedurës e cila zhvillohet ndaj kryerësve me çrregullime mendore, ekspertizën, caktimin e masës së paraburgimit të këtyre personave, përcaktimi ligjor për llojet e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, për kushtet dhe procedurën gjyqësore të shqiptimit, për mënyrën e ekzekutimit të tyre në mënyrë të qartë ku ato i përcaktojnë subjektet e të cilëve u dedikohen dhe qëllimin që synohet të arrihet përmes tyre.

#### **Objektivat**

- 🎯 Avancimi i njohurive rreth procedurës penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore;
- 🎯 Vleresojne kushtet dhe kriteret ligjore lidhur me caktimin e paraburgimit për kryesit me çrregullime mendore;
- 🎯 Analizimi i masave të trajtimit të detyrueshëm.

#### **Përmbajtja**

- 📄 Veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore;
- 📄 Paraburgimi për personat me çrregullime mendore;
- 📄 Ekzaminimi psikiatrik;
- 📄 Përcaktimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik;
- 📄 Sfidat në zbatimin e procedurave me kryes me çrregullime mendore;
- 📄 Analiza e raportit të OSBE.



## **Metodologjia**



Zbatimi i metodologjise interaktive, diskutimi dhe aplikimi i rasteve praktike grupore.

## **Përfituesit**



Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Mbrojtësit e viktimave.

## **Kohëzgjatja**



Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## 15. Gjykimi në mungesë

Sipas dispozitës së KPPK në rastet kur prezenca e të pandehurit nuk mund të sigurohet pas përpjekjeve të arsyeshme, atëherë gjykimi mund të mbahet edhe pa praninë e të pandehurit. Ky ndryshim në procedurë është bërë bazuar në Direktiva (be) 2016/343 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 9 mars 2016. Instituti i gjyqimit në mungesë është inkorporuar për shkak se në shumë raste ka pasur vështirësi për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë, me ç' rast ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale, mirëpo në disa raste të pandehurit i janë shmangur drejtësisë e posaçërisht të veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen, si dhe vepra penale e vrasjes së rëndë. Gjykimi në mungesë do të aplikohet dhe zbatohet për të gjitha veprat penale kur të plotësohen kushtet ligjore. Kushtet që duhet plotësuar në mënyrë që të mbahet gjykimi në mungesë janë prezenca e të pandehurit në shqyrtim të paktën njëherë (ose në shqyrtim fillestar ose në shqyrtim gjyqësor) dhe njoftimi për detyrimin për të qenë i pranishëm në gjykim si dhe informimi se në të kundërtën gjykimi mund të vazhdojë të mbahet nëse i akuzuari mungon vullnetarisht. Megjithatë, kriteri i prezencës së të pandehurit e ka një përjashtim, kur bëhet fjalë për veprat penale të cilat nuk parashkruhen të përcaktuara në nenin 104 të KPRK-së. Për dallim nga rastet sipas kriterit të parë, në rastet e gjyqimit në mungesë për veprat penale të përcaktuara në nenin 104 të Kodit Penal, sipas paragrafit 7, të nenit 303 të KPP-së, personi i gjykuar ka të drejtë në rigjykim të pakushtëzuar, automatik e të plotë sipas kërkesës.


### Objektivat

- 🎯 Të kuptojnë përmbushjen e kushteve ligjore për tu mbajtur gjykimi në mungesë;
- 🎯 Të kuptojnë paraqitjen e të akuzuarit në seancën fillestare për tu mbajtur gjykimi në mungesë dhe në shqyrtimin gjyqësor;
- 🎯 Të vlerësojnë aspektet e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar lidhur me gjykimin në mungesë.


### Përmbajtja

- 📄 Kushtet ligjore për mbajtjen e gjyqimit në mungesë;
- 📄 Prezenca e të akuzuarit në shqyrtim fillestar dhe gjyqësor;
- 📄 Seanca dëgjimore për të përcaktuar mungesën e të akuzuarit dhe mbajtjen e gjyqimit në mungesë.
- 📄 Përpjekjet e arsyeshme për të gjetur të akuzuarin;
- 📄 Njoftimi i të pandehurit lidhur me aktgjykimin;
- 📄 Rigjykimi në rastet e gjyqimit në mungesë.


## **Metodologjia**

 Aplikimi i metodave të kombinuara trajnuese, diskutimet interaktive, studimi i rasteve praktike, puna në grupe, vendime te GJEDNJ, etj.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarë dhe Prokurorë.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.




Temë e identifikuar nga:

- Raporti i monitorimit të proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 - KPK










## 16. Artikulimi dhe mbështetja e aktakuzave/vendimeve gjyqësore - shkrimi ligjor

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të njoftohen rreth rëndësisë së shkrimit ligjor, tipareve që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Aktakuzat dhe vendimet gjyqësore duhet të synojnë të përshkruajnë dhe të analizojnë çështje ligjore të ofrojnë argumente dhe artikulime të çarta dhe të mbështesin përfundimet me bazë ligjore. Ato duhet të jenë të çarta dhe të thjeshta të kenë strukturë të çartë, të kenë gjuhë të thjeshtë dhe të çartë, ti shmangemi fjalive komplekse dhe të gjata, të ketë saktësi dhe paraqitje të fakteve të plota dhe të sakta, të ketë një strukturë logjike me një prezantim të çartë të argumenteve, rend kronologjik të fakteve dhe analizë ligjore. Argumentet duhet të jenë të bazuara në faktet dhe interpretim të drejtë të ligjit pa përfshirë emocione dhe paragjykime dhe të kenë gabim sa më të vogla në drejtshkrim ose gramatik të cilat mund të dëmtojnë besueshmërinë e dokumentit. Shkrimi ligjor paraqet njërin prej faktorëve kryesor për cilësinë e proceseve gjyqësore. Shkrimi ligjor duhet të përmbajë analizë të çartë dhe objektive të cilat ndihmojnë në procese gjyqësore. Metodatat e përdorura për shkrim ligjor, format e parandalimit të krimeve kibernetike. Elementet e veprës penale të krimeve kibernetike, luftimi i krimeve kibernetike në aspektin vendor dhe nderkombëtar


### Objektivat

-  Njohin rëndësinë e shkrimit ligjor;
-  Avancojnë njohitë rreth rregullave bazë të shkrimit të akteve dhe dokumenteve ligjore;
-  Njohin metodologjin dhe standardet e të shkruarit ligjor.


### Përmbajtja

-  Rëndësia, standardet dhe parimet e shkrimit ligjor;
-  Metodologjia e përdorimit të formulës IRAK;
-  Arsyetimi ligjor;
-  Përpilimi i vendimeve gjyqësore;
-  Gjuha e përdorur, struktura, drejtshkrimi, përfundimi dhe konkludimët;
-  Përfundimet dhe argumentet arsyetohen dhe mbështeten siç duhet;
-  Parashtrimi i mjeteve juridike duke u referuar në bazën e duhur ligjore;
-  Përgatitja e materialeve përmbajtjesore (raporteve, letrave, shkresave) në mënyrë të plotë;
-  Paraqitja e duhur e rasteve në gjykatë.


### Metodologjia

-  Trajtimi dhe prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore dhe punë në grupe.

### Përfituesit

-  Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesionalë.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese në AD
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- UNDP

## 17. Krimet e luftës

Hetimi dhe gjykimi i krimeve të luftës në Kosovë paraqet një sfidë të re për sistemin e drejtësisë në Kosovës. Në sistemin juridik të Kosovës, gjatë trajtimit të rasteve të krimeve të luftës aplikohen tri (3) korniza ligjore: (1) rregullat e së drejtës ndërkombëtare (2) rregullat e së drejtës së ish- Jugosllavisë dhe (3) rregullat e së drejtës së Republikës së Kosovës. Sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës ka kaluar nëpër periudha të vështira, dhe përpjekjet për të ndjekur penalisht dhe ndëshkuar ata që kanë kryer krime të luftës vazhdojnë ende. Ne duhet të kujtojmë se krimet e luftës nuk janë thjesht një çështje juridike; ato janë një shkelje e rëndë e moralit dhe të drejtave të njeriut, duke prekur thellë shpirtin e komuniteteve të prekura dhe duke lënë plagë që do të ndjehen për shumë vite. Gjatë këtyre 25 viteve, janë bërë përpjekje të mëdha për të sjellë para drejtësisë ata që kanë kryer krime gjatë luftës. Këto përpjekje kanë përfshirë ngritjen e strukturave të drejta dhe të pavarura, mbështetje për viktimat dhe sigurimin e dokumentimit të saktë dhe të plotë të krimeve. Ndihma ndërkombëtare dhe angazhimi i institucioneve vendase kanë qenë thelbësore në këtë proces dhe jemi angazhuar të vazhdojmë të mbështesim këto përpjekje me të gjitha resurset tona. Është e rëndësishme të theksojmë se krimet e luftës në Kosovë, gjatë këtyre 25 viteve, kanë kaluar nëpër tre periudha të ndryshme kohore. Periudha e parë përfshin kohën kur krimet e luftës u trajtuan nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i njohur si UNMIK.

Në atë kohë, prokurorët dhe gjyqtarët kosovarë kishin shumë pak, për të mos thënë fare, qasje në këto raste, për shkak se ishte kompetencë ekskluzive e prokurorëve dhe gjyqtarëve të UNMIK-ut. Periudha e dytë përfshiu kohën kur krimet e luftës u trajtuan nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, i njohur si EULEX. Edhe gjatë kësaj periudhe, rastet e krimeve të luftës ishin kompetencë ekskluzive e prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it, ndërsa prokurorët dhe gjyqtarët kosovarë kishin shumë pak qasje. Periudha e tretë filloi rreth muajit Qershor të vitit 2018, me procesin e njohur si "Periudha e transferimit të kompetencave dhe dosjeve nga Prokurorët e EULEX-it tek Prokurorët vendor". Ky proces vazhdoi gjatë gjithë vitit 2018 dhe përfundoi rreth fundit të atij vitit. Si rezultat i kësaj, ne kemi pranuar rreth 1000 dosje nga EULEX-i. Duke u përballuar me këtë sfidë të re, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar Strategjinë për Krime të Luftës, ku kemi përcaktuar qasjen tonë institucionale ndaj kësaj situatë.

Trajtimi i viktimave të luftës, veqanërisht viktimave të dhunës seksuale, gjatë hetimit dhe gjyqimit të krimeve të luftës paraqet një sfidë specifike. Korniza ligjore ekzistuese ofron garanci ligjore për të drejtat e viktimave dhe viktimave të dhunës seksuale, në një rast të krimeve të luftës. Janë dy ligje të rëndësishme të cilat ofrojnë garanci që viktimat duke përfshirë edhe viktimat e dhunës seksuale, do të marrin mbështetjen e duhur. Kodi i procedurës penale parasheh një mori të drejtash procedurale për një viktimitë të krimit të luftës, të drejta këto që viktimat mund ti shfrytëzojnë gjatë gjithë procesit gjyqësor. Gjithashtu, Ligji për kompensimin e viktimave të krimit, është një ligj specifik, i cili përcakton të drejtat e viktimave në realizimin e kërkesës pasurore juridike, në rastet kur një pëson është viktimitë e një krimi.

Korniza e re ligjore, në aplikim që nga vitit 2023, ka vendosur një standard të ri procedural: gjykimin në mungesë për rastet e krimeve nga e drejta ndërkombëtare. Me këtë korniz ligjore është përcaktuar decidivisht se çfarë kritere duhet të plotësohen për ta procedura një rast krimeve të luftës në mungesë, cilat janë kushtet ligjore procedurale të cilat duhet të plotësohen gjatë hetimit dhe gjykimit me qëllim të trajtimit të një rasti të krimeve të luftës. Ky trajnim synon që pjesëmarrësit ti ngrisin kapacitete profesioanle rastet praktike vendore dhe ndërkombëtare për krimet e luftës, mbi bazën e të metave praktike të evidentuar, qoftë te rasteve që kane marr epilog.

## Objektivat

- 🎯 Avancimi i njohurive për hetimin dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës;
- 🎯 Avancimi i njohurive lidhur me format e përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- 🎯 Avancimi i njohurive lidhur me përgjegjësinë komanduese si formë e përgjegjësisë penale;
- 🎯 Avancimi i njohurive lidhur me kornizën ligjore për hetimin dhe gjykimin në mungesë, për raste e krimeve të luftës.
- 🎯 Avancimin e njohurive për të drejtat e viktimave të krimeve të luftës, me theks të veçantë viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës;
- 🎯 Avancimi i njohurive lidhur me protokollin vendor dhe ndërkombëtar për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës;
- 🎯 Avancimin e njohurive lidhur me kornizën ligjore të aplikueshme;
- 🎯 Prezantimi i rasteve praktike lidhur me mbrojtjen e të drejtave të viktimave;
- 🎯 Avancimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me OJQ-të lidhur me trajtimin e viktimave të krimeve të luftës.

## Përmbajtja

- 📄 Gjykimi i rasteve te krimeve te luftës ne mungese;
- 📄 Provat rrethore ne vërtetimin e përgjegjësisë për rastet e krimeve te luftës;
- 📄 Gjenocidi dhe dallimet me krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit;
- 📄 Format e zbatueshme të përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- 📄 Praktika gjyqësore: Vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit të Kosovës;
- 📄 Ndërmarrja e përbashkët kriminale;
- 📄 Përgjegjësia komanduese;
- 📄 Përgjegjësia individuale;
- 📄 Gjenocidi;
- 📄 Krime kundër njerëzimit;
- 📄 Krime kundër popullsisë civile;
- 📄 Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtare për rastet e krimeve të luftës (Mekanizmave Rezidual për Tribunalet Ndërkombëtare me seli në Hagë);
- 📄 Të drejtat e viktimave sipas nenit 63 të Kodit të procedurës penale;
- 📄 Të drejtat e viktimave sipas Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit;
- 📄 Strategjia e Qeverisë për Drejtësi Tranzicionale, me theks të veçantë për viktimat e krimeve të luftës;
- 📄 Aspektet procedurale të marrjes së deklaratës së një viktime të krimit të luftës;
- 📄 Praktika gjyqësore lidhur me viktimat e krimeve të luftës.

## **Metodologjia**



Trajnimi do të zbatohet përmes metodave të ligjërimit teorik, praktik dhe të kombinuar. Pjesëmarrësve do u jepen ushtrime praktike nga rastet e trajtuara në prokurori dhe do të kërkohet që të analizojnë dhe prezantojnë çështjet e evidentuara. Sesionet do të organizohen në punëtori individuale dhe grupore. Përmes kësaj metode synohet që pjesëmarrësi të përfshihet aktivisht në çdo çështje dhe në këtë mënyrë edhe do t'i forcojë njohuritë që posedon por edhe do të marr njohuri të reja në fusha të caktuara.

## **Përfituesit**



Gjyqtarët, Prokurorët e Shtetit, Avokatët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët Ligjor, Policët hetues.

## **Kohëzgjatja**



Dy trajnime nga dy ditë (janar-qershor një dhe shtator dhjetor një)

Temë e identifikuar nga:

- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Pyetëtori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## 18. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Qëllimi i këtij trajnimi është zhvillimi i njohurive të pjesëmarrësve përkitazi me sferën e bashkëpunimit juridik në çështjet penale dhe njohuritë me legjislacionin e brendshëm, marrëveshjet me shtetet tjera, si dhe instrumentet ndërkombëtare në sferën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Duke pasur parasysh faktin se shpesh herë veprat penale kryhen në disa vende e gjithashtu kemi situata kur autorë të veprave penale kryejnë vepra penale në vendin tonë apo shtetas të Kosovës kryejnë vepra penale në vendet e tjera, atëherë me qëllim të realizimit të zhvillimit me sukses të procedurës penale nevojitet ndihma juridike në çështje penale. Si bazë e realizimit të ndihmës juridike ndërkombëtare është legjislacioni vendor, përkatësisht Ligji nr. 04/L-213 – për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Gjithashtu me qëllim të realizimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar të rëndësishme janë edhe marrëveshjet e nënshkruara me shtete të veçanta me qëllim të realizimit efikas të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale. E rëndësishme është gjithashtu edhe përfitimi i njohurive përkitazi me legjislacionin relevant ndërkombëtar.

Si çështje e rëndësishme në këtë temë dalin të jenë përcaktimi i kriterëve bazë të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, si dhe bazuar në marrëveshjet mes vendit tonë dhe vendeve tjera me qëllim të realizimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale.

### Objektivat


- 🎯 Avancimi i njohurive rreth aspekteve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në aspektin penal;
- 🎯 Avancimi i njohurive me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar në çështjet e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale;
- 🎯 Zbatimi në mënyrë të drejtë i dispozitave ligjore të legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar në sferën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar

### Përmbajtja


- 📄 Diskutime lidhur me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar përkitazi me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar;
- 📄 Zbatimi i dispozitave relevante nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar;
- 📄 Ekstradimi;
- 📄 Kushtet e ekstradimit;
- 📄 Ndalesat në ekstradim, qëllimi i përfitimit apo shkaktimi i dëmit.




## **Metodologjia**

 Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke filluar nga prezantimi nga ana e trajnuesit dhe gjithashtu do të përdoret metoda interaktive me qëllim të nxitjes së diskutimeve përmes rasteve praktike.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarë dhe Prokurorë.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)

## 19. Trafikimi me qenie njerëzore

Trafikimi i qenieve njerëzore përbën shkelje të të drejtave të njeriut, të vlerave themelore të shoqërive demokratike dhe një kërcënim madhor për sigurinë e rendin publik. Me gjithë përpjekjet e shteteve në nivelet kombëtare, rajonale e ndërkombëtare, trafikimi i qenieve njerëzore mbetet një aktivitet kriminal dinamik në përshtatje e sofistikim të vazhdueshëm. Çdo vit, mijëra njerëz, kryesisht gra dhe fëmijë, trafikohen me qëllim shfrytëzimin seksual apo forma të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë vendit të origjinës. Pothuajse të gjitha vendet në rajon janë vende të origjinës, tranzitit ose destinacionit, ose një kombinim i më sipër. Lufta ndaj trafikimit të qenieve njerëzore duke angazhuar shtetet në reagim të përbashkët e bashkëpunim efikas të mekanizmave kombëtarë të ngritur prej tyre mbetet në prioritetin e shume organizatave ndërkombëtare. Tashmë thuajse dy dekada pas hyrjes në fuqi së Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, nëpërmjet së cilës u arrit formalisht për herë të parë në një qëndrim i përbashkët në nivel ndërkombëtar në lidhje me përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore, ky përkufizim vazhdon të nxisë diskutime, ndonëse është përkrahur dhe mbështetur nga instrumente të tjerë ndërkombëtarë që trajtojnë trafikimin e qenieve njerëzore.<sup>2</sup> Neni 3 (a) i protokollit të Palermos ka bërë përcaktimin e veprës së “trafikimit” përkufizim i cili ka një rëndësi të jashtëzakonshme mbarëbotërore veçanërisht për sa i përket harmonizimit të legjislacioneve vendase në këtë fushë dhe rrjedhimisht rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar bazuar në koncepte të njëjta ose të ngjashme të trafikimit. Megjithatë, vetëm gjatë dekadës së fundit është evidentuar se ky përkufizim në vetvete ka disa paqartësi të cilat reflektohen në zbatimin e tij.





Pavarësisht studimeve të shumta të studiuesve dhe organizatave ndërkombëtare për të shtjelluar kompleksitetin e veprës së trafikimit, mbetet ende e madhe nevoja për studimin e praktikës gjyqësore në lidhje me parashikimet ligjore përkatëse. Formulimi i detajuar, por njëkohësisht dhe fusha e gjerë që mbulon vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore, i japin rëndësi të veçantë praktikës së zhvilluar nga ana e institucioneve gjyqësore shqiptare të cilat kanë vlerë në drejtim të zbrërthimit dhe kuptimit të qëndrueshëm të trafikimit të qenieve njerëzore në fushën e së drejtës. Sipas standardeve të së drejtës ndërkombëtare trafikimi i qenieve njerëzore duhet njohur e trajtuar jo thjesht në drejtim të rendit e sigurisë publike por edhe si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Kështu, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 i Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAË) identifikon trafikimin, me një formë të dhunës me bazë gjinore në kundërshtim me gëzimin e barabartë të të drejtave dhe dinjitetin e gruas.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjithashtu në jurisprudencën e saj ka përcaktuar qartë se trafikimi i qenieve njerëzore, siç përcaktohet në Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Trafikimin dhe Konventën e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit, është i ndaluar nga Neni 4 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të njeriut (KEDNJ) pa qenë e nevojshme që të kualifikohet në ndonjërin nga format e parashikuar shprehimisht nga ana e nenit 4 pra si skllavëri, ose punë e detyruar: “Trafikimi i qenieve njerëzore, për natyrën dhe qëllimin e shfrytëzimit të tij, bazohet në ushtrimin e kompetencave që i përkasin të drejtës së pronësisë. Ajo i trajton qeniet njerëzore si mallra për t’u blerë dhe








shitur dhe për t'u vënë në punë të detyruar, shpesh për pak ose aspak pagesë, zakonisht në industrinë e seksit por edhe në vende të tjera. Kjo nënkupton mbikëqyrje të ngushtë të aktiviteteve të viktimave, lëvizjet e të cilëve shpesh janë të kufizuara. Ai përfshin përdorimin e dhunës dhe kërcënimeve ndaj viktimave, të cilët jetojnë dhe punojnë në kushte të këqija”.

Çka nënkupton trafikimi me qenie njerëzore, cilat janë elementet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore, cili është dallimi midis trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me migrant dhe mundimi në prostitucion. Elementet e veprës penale të trafikimi me qenie njerëzore, koncepti i trafikimit me qenie njerëzore sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, hetimi dhe ndjekja penale, kompensimi për viktimat e trafikimit dhe mbështetja e viktimave gjatë gjyqimit.


## Objektivat

-  Kuptojnë përkufizimin e veprës penale trafikimi me qenie njerëzore;
-  Kuptojnë të drejtat e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;
-  Njohin metodat bash kohore të hetimit dhe ndjekjes penale;
-  Avancojnë njohurite rreth trajtimit të viktimave të trafikimit në procedurë penale.


## Përmbajtja

-  Koncepti i trafikimit me qenie njerëzore;
-  Elementet e veprës penale;
-  Trafikimi i fëmijëve;
-  Identifikimi i viktimave;
-  Hetimi dhe ndjekja penale;
-  Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë;
-  Kompensimi dhe mbështetja e viktimave.


## Metodologjia

-  Diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët, Prokuror, bashkëpunëtor profesionale, zyrtar policor, mbrojtësit e viktimave, hetuesit policor.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për gjyqtarë/prokuror për nevojat trajnuese
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Trajnuesi i përhershëm

## 20. Veprat penale kundër mjedisit

Krimi mjedisor, krimi kundër natyrës dhe krimi kundër pyjeve në Republikën e Kosovës, prej vitësh tashmë është mjaft i formatuar si nga ana e parashikimeve ligjore për parandalimin dhe ndëshkimin e veprave të këtyre fushave, ashtu edhe nga lloji i veprave penale që janë shfaqur dhe shfaqen çdo ditë me evoluimin e shoqërisë në përgjithësi dhe të teknologjisë në veçanti. Në vendin tonë, po vërehet gjithnjë e më tepër ndotja dhe degradimi i ambientit, pastaj prerja ilegale e pyjeve, djegia e pyjeve apo zjarrvënja. Kjo gjë ndryshon florën dhe faunën e sipërfaqes së cenuar në mënyrë të pakthyeshme kështu dëmtohet mjedisi, pyjet dhe natyra.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin 27 rregullon veprat penale kundër mjedisit, si “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit”; “shkretërimi i pyjeve”; “Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme”; “Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin”; dhe shumë vepra tjera penale.

Në një epokë ku ndotja e mjedisit është bërë një sfidë globale, mbrojtja e mjedisit ka fituar një rëndësi të jashtëzakonshme në botën bashkëkohore. Studimet dhe hulumtimet e kësaj sfide tregojnë se përpjekjet për të ruajtur dhe promovuar mjedisin janë të domosdoshme për të garantuar të ardhmen tonë dhe të brezave të ardhshëm. Në përpjekje për të arritur këtë synim të rëndësishëm, shumë shtete bashkëkohore kanë penalizuar një mori veprimesh që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit, duke i parashikuar si vepra të kundërligjshme, qoftë në formë të veprave penale (kundërvajtjeve penale), kundërvajtjeve, shkeljeve administrative dhe shkeljeve të tjera. Këto masa kanë për qëllim të kujdesen për të drejtën e qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Në këtë mënyrë, trajtimi i këtyre çështjeve mjedisore në tryeza dhe forume të ndryshme në mes të gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjetër vlerësohet se është i një rëndësie të veçantë.

### Objektivat

- 🎯 Të identifikojnë veprat penale kundër ndotjes dhe degradimit të mjedisit;
- 🎯 Aplikojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që i referohen veprave penale kundër mjedisit;
- 🎯 Kuptojnë në mënyrë sa më të qartë elementet e figurave të veprave penale kundër mjedisit, duke pasur parasysh edhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi;

### Përmbajtja

- 📖 Kuptimi i veprave penale në fushën e mjedisit, pyllit dhe natyrës;
- 📖 Legjislacioni vendor për mbrojtjen e mjedisit pyllit dhe natyrës;
- 📖 Llogaritja e dënimit të shqiptuar për kundërvajtje në dënimin e shqiptuar për vepra penale;
- 📖 Konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit;
- 📖 Organizmat ndërkombëtare që veprojnë në luftën kundër krimeve mjedisore;
- 📖 Konventat e Këshillit të Evropës mbi Mjedisin;
- 📖 Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut për çështjet mjedisore.

## **Metodologjia**



Metodat e kombinuara të shpjegimit dhe diskutimit të çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me veprat penale kundër mjedisit. Në këtë drejtim, do të ketë diskutime interaktive dhe elaborim të rasteve nga praktika gjyqësore, punë në grupe.

## **Përfituesit**



Gjyqtarët, prokurorët, hetues policor dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Kohëzgjatja**



Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:




- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit

## 21. Ankesa e të dëmtuarit në rastin e hedhjes së kallëzimit penal ose pushimi i hetimit





Me dispozitat e reja të KPPK-ës respektivisht neni 84 dhe 156 tani të dëmtuarit si palë në procedurë kanë të drejtën e paraqitjes së ankesës ndaj vendimit të prokurorit të shtetit të shkallës së parë për hüdhe të kallëzimit penal dhe pushimit të hetimit si dhe në rastet kur prokurori i shtetit nga shkalla e parë nuk e trajton rastin brenda afatit 6 mujor nga dita e paraqitjes së kallëzimit penal.

E drejta e të dëmtuarit për të paraqitur ankesë në raste konkrete është një mbrojtje e rëndësishme për të siguruar që viktimat e një vepre penale të kenë një mjet për të sfiduar vendimet e prokurorive të shkallës së parë kur këto vendime nuk përputhen me pritshmëritë e tyre për drejtësi. Kjo e drejtë e mbështet viktimën në ruajtjen e balancës midis autoritetit të prokurorisë dhe kërkesës për drejtësi nga ana e të dëmtuarve. Kush ka të drejtë të parashtrimit të ankesës ndaj vendimit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal dhe pushimit të hetimit, Kush vendos për ankesën e të dëmtuarit, Afati për paraqitjen e ankesës dhe afatin për vendosje lidhur me ankesën. Përmbajtja e ankesës, vendimet e Prokurorisë së Apelit lidhur me ankesën, aspekti ligjor për mbrojtjen e të drejtave të viktimave


### Objektivat

-  Kuptojnë saktë të drejtat e viktimave në procedurë penale;
-  Baza ligjore për të drejtën në ankesë ndaj aktvendimit për hedhje poshtë të kallëzimit penal dhe pushimit të hetimit;
-  Procedura e ankesës në Prokurori.

### Përmbajtja

-  E drejta në ankesë e të dëmtuarit,
-  Bazat ankimore;
-  Vendimet e prokurorit të shtetit në raport me ankesën;
-  Zbatimi i udhëzimeve të Prokurorisë së Apelit nga prokurorët e prokurorive të shkallës së parë.


### Metodologjia

-  Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës.

### Përfituesit

-  Prokurorë, bashkëpunëtor profesionale, zyrtar ligjor, mbrojtësit e viktimave.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

## 22. Hetimi dhe ndjekja e krimeve ekonomike

Veprat penale kundër ekonomisë padyshim se shkaktojnë pasoja të shumta në sistemin ekonomik dhe financiar. Këto vepra penal kanë shënuar rritje në vitet e fundit dhe cenojnë rendin ekonomik, tregtinë e lirë dhe konkurrencën e lirë. Këto vepra dëmtojnë stabilitetin ekonomik, zvogëlojnë të ardhurat dhe pengojnë zhvillimin e tregut të ndershëm. Shtetet zakonisht ndërmarrin masa të rrepta për t'i parandaluar dhe ndëshkuar këto veprime me qëllim të mbrojtjes së ekonomisë dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Shteti duhet të forcojë mekanizmat ligjorë dhe duhet të ketë qasje praktike për rritjen efektive të ndjekjes penale, dënimeve dhe konfiskimeve për veprat penale që gjenerojnë pasuri, të cilat synojnë të kontribuojnë në forcimin e luftës kundër krimeve ekonomike, mashtrimit, pastrimit të parave, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074 në kuadër të kapitullit XXV të Veprave penale kundër ekonomisë, ka paraparë veprat penale si: cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike, shkaktimi i falimentimit, shkaktimi i falimentimit të rrejshëm, keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, mashtrimi i konsumatorëve, organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, falsifikimi i parasë, tregtia e ndaluar, shpërlarja e parave, shmangia nga tatimit, dhënia dhe marrja e rryshfetit në sektorin privat, kontrabandimi i mallrave, shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore e shume vepra tjera penale. Në këtë mënyrë, trajtimi i këtyre çështjeve në tryeza dhe forume të ndryshme në mes të gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjetër vlerësohet se është i një rëndësie të veçantë.

### Objektivat

- 🎯 Avancimi i njohurive rreth veprave penale kundër ekonomisë (me theks të veçantë të mashtrimit, pastrimit të parave, shmangies nga tatimi, falsifikimi i parave, shkelja e të drejtave të autorit dhe patentës, kontrabandimi i mallrave, shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore);
- 🎯 Të identifikojnë indikatorët e këtyre veprave penale;
- 🎯 Aplikojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që i referohen veprave penale kundër ekonomisë;
- 🎯 Kuptojnë mënyrën e hetimit dhe parandalimit të këtyre veprave penale.

### Përmbajtja

- 📄 Kuptimi i veprave penale kundër ekonomisë me theks të veçantë të mashtrimit, pastrimit të parave, shmangies nga tatimi, falsifikimi i parave, shkelja e të drejtave të autorit dhe patentës, kontrabandimi i mallrave, shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore;
- 📄 Zbulimi i indikatorëve të veprave penale kundër ekonomisë;
- 📄 Përdorimi i metodave bashkëkohore të hetimit dhe luftimit të këtyre veprave penale;
- 📄 Shkëmbimi i informacioneve me organet tjera ligj zbatuese.

## **Metodologjia**



Aplikimi i metodave të kombinuara të shpjegimit dhe diskutimit të çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me keto vepra penale. Në këtë drejtim, do të ketë diskutime interaktive dhe elaborim të rasteve nga praktika gjyqësore, punë në grupe, simulimet e ndryshme etj.

## **Përfituesit**



Gjyqtarët, prokurorët, hetues policor dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Kohëzgjatja**



Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.



Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

### 23. Masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedure penale

KPPK ka paraparë masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë si instrumente me të cilat bëhet kufizimi i lirisë së lëvizjes, dhe përcaktohen kushtet ligjore me qëllim të zhvillimit me sukses të procedurës penale. Paraburgimi është masa më e rëndë në kuadër të këtyre masave. Instrumenteve ndërkombëtare dhe legjislacioni vendor sugjeron që paraburgimi të aplikohet vetëm kur shteren të gjitha mundësitë tjera për ta arritur qëllimin. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, shpeshherë nuk janë zbatuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara me ligj, andaj në praktikën gjyqësore ende ka vështirësi në identifikimin, vlerësimin dhe analizimin e rrethanave lidhur me vendosjen për secilën bazë për këto masa. Në praktikën gjyqësore, po ashtu paraqiten vështirësi në përgatitjen e kërkesave për këto masa e veçanërisht për paraburgim, ka vështirësi në arsyetimin e bazave për caktimin e këtyre masave sepse dispozitat ligjore kërkojnë që për secilën bazë ligjore të këtë arsyetim konkret e jo abstrakt.

#### Objektivat

- 🎯 Avancojnë njohurite rreth kërkeses së bazuar për caktimin e sigurisë së të pandehurit në procedure penale;
- 🎯 Vlerësojnë drejtë elementet për përcaktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedure;
- 🎯 Zbatojnë parimet bazë lidhur me këto masa;
- 🎯 Hartojnë dhe arsyetojnë mjaftueshëm vendimet për shqiptimin e këtyre masave.

#### Përmbajtja

- 📄 Kërkesa e bazuar për caktimin e sigurisë së të pandehurit në procedure penale;
- 📄 Kushtet ligjore-bazat për caktimin e masave për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë;
- 📄 Paraburgimi dhe arsyetimi i aktvendimit për caktimin për paraburgim;
- 📄 Paraburgimi dhe masat tjera në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut (paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni).


#### Metodologjia

- 📖 Në trajnim do të aplikohen metoda të kombinuara duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, diskutim instruktiv dhe trajtim i rasteve nga praktika.

#### Përfitues

- 👥 Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore, të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale.

#### Kohëzgjatja:

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

## ***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA CIVILE***

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## 1. Unifikimi i praktikës gjyqësore nga marrëdhëniet e detyrimeve




Numri i madh i kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit, veçanërisht dëmit jo material, praktika gjyqësore jo e harmonizuar sa i përket vendosjes dhe kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material, janë indikator që tregojnë se kjo temë është shumë me rëndësi të trajtohet. Mbrojtja juridiko civile e të mirave dhe ekzistimi i përgjegjësisë juridike civile (nëse dikush i cenon këto të mira) është segment i rëndësishëm në kuadër të sigurimit të një niveli më të lartë të mbrojtjes së të mirave njerëzore të mbrojtura juridikisht. Përcaktimi i saktë i përgjegjësisë së shkaktarit të dëmit dhe të realizimit të drejtës së palës së dëmtuar në shpërblimin e dëmit, në marrëdhënien juridike civile jo kontraktuale është një prej sfidave të gjyqtarëve të fushës civile.

Ndonëse praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë temë, mirëpo numri i madh i rasteve nëpër gjykatat e Kosovës, dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për shpërblim të dëmit, ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore sidomos sa i përket kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material, por edhe mënyra e vërtetimit të gjendjes faktike në këto raste shpesh ka të meta. Baza e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit material dhe jo material? Cilat janë kriteret për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material? Si provohet gjendja faktike në procedurën e shpërblimit të dëmit material dhe jo material? Si të bëhet zbatimi në praktikë i dispozitave materiale në rastet konkrete të kontestit për shpërblimin e dëmit material dhe jo material? Cila është praktika për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material? Tematika e trajnimit është strukturuar në mënyrën që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha dispozitave materiale juridike që i referohen shpërblimit të dëmit material dhe jo material.




Në praktikën gjyqësore kemi dilema dhe vendimmarrje ndryshe sa i përket institutit të parashkrimit në marrëdhëniet detyrimeve në veçanti në rastet e shpërblimit të dëmit, regresit si dhe shërbimeve komunale. Dilemat dhe vendimmarrja ndryshe kryesisht i referohet llogaritjes së parashkrimit (kur fillon afati i parashkrimit, kur ndërprehet apo ndalet?) Poashtu në praktikën gjyqësore janë identifikuar dilema dhe vendimmarrje ndryshe në rastet e paraqitura që i referohen kërkesave për kompensimin e dëmit-gjegjësisht fitimit të humbur, të provuarit dhe mjetet provuese si dhe vlerësimi i kushteve me rastin e ndryshimit të vendimeve që i referohen kësaj kategorie të dëmit.

Tryeza synon eliminimin e divergjencave në vendimmarrje duke u bazuar në problemet e identifikuar. Çështjet për diskutim në këtë tryezë mund të jenë si në vijim: Dëmi Jomaterial, shpërblimi në të holla, specifikimi i kërkesave për kategoritë kompensuese sipas LMD-së, baza juridike, caktimi i lartësisë së kërkesëpadisë si dhe kriteret për caktimin e lartësisë për shpërblimin në të holla. Parashkrimi në marrëdhëniet e detyrimeve, llogaritja e afatit të përshkrimit, ndërprerja dhe ndalja e parashkrimit. Fitimi i humbur, renta e arritur dhe renta për të ardhmen, të provuarit dhe mjetet provuese dhe ndryshimi i vendimeve që i referohen fitimit të humbur.


## Objektivat

-  Unifikimi i praktikës gjyqësore;
-  Zbatimi unik i ligjeve;
-  Ngritja e cilësisë në vendimarrje.


## Përmbajtja

-  Shpërblimi i dëmit jo material dhe praktika gjyqësore;
-  Parashkrimi;
-  Fitimi i Humbur.


## Metodologjia

-  Në këtë tryezës të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Apelit dhe Gjykatave Themelore.

## Kohëzgjatja

-  Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024

## 2. Unifikimi i praktikës gjyqësore në Gjykatën e Apelit

Tryeza ka për qëllim që adresojë divergjencat në vendimarrje nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, e të cilat shkaktojnë konfuzitet tek gjyqtarët e gjykatave themelore dhe kjo pastaj reflekton në cenim të sigurisë juridike. Si fokus të veçantë i trajtimit në tryezë do të jenë vendimet në procedurën përmbartimore, masat e sigurimit të kërkesëpadisë, Çështjet familjare (me fokus tek besimi i fëmijëve, alimentacioni dhe kontakti me fëmijë). Para gjyqtarëve do të jepet një përshkrim i shkurtër i problematikës në secilën lëmi të trajtuar duke nxitur debat që në fund të kurorëzohet me një përafrim dhe unifikim të vendimmarrjes. Në raport me masat e sigurimit fokusi do të jetë që nga ana e gjyqtarëve të Apelit të sigurohet që vendimet në raport me masat e sigurimit të ketë qasje unike duke shmangur anulimin e këtyre vendimeve më tepër se një herë dhe mos të përdoret standard i dyfishtë me rastin e kthimit të lëndës në rigjykim. Tek kontestet familjare me fokus të të provuarit dhe mjeteve provuese, zbatimi unik i ligjeve, roli aktiv i gjykatës dhe me rastin e vendosjes të merren për bazë edhe standardet ndërkombëtare në raport me mbrojtjen e dhe vlerësimin më të mirë të interesit të fëmijëve. Tryeza synon eliminimin e divergjencave në vendimarrje duke u bazuar në problemet e identifikuara. Dilemat do të jenë rreth vendimmarrjes së ndryshme nga gjyqtarët e gjykatës së Apelit për qështje esencialisht të njëjta që i referohen qështjeve se kush është organ përmbartues, vlerësimin e kushteve ligjore për lejimin dhe zbatimin e përmbartimit, kompetenca lëndore sipas mjeteve të goditjes në proedurë përmbartimore si dhe qështje tjera, masat e sigurimit, kushtet për caktimin dhe zëvendësimin e masave të sigurimit dhe mjeteve të goditjes. Në qështjet familjare si dilema na paraqitet të provuarit dhe mjetet provuese, roli aktiv i gjykatës në këto konteste si dhe detyrimi i zbatimit të stadnadareve ndërkombëtare për brojtjen e inetersit më të mirë të fëmijëve në këto konteste.

### Objektivat

- 🎯 Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- 🎯 Zbatimi unik i ligjeve;
- 🎯 Ngritja e cilësisë në vendimarrje.

### Përmbajtja

- 📄 Procedura përmbartimore;
- 📄 Masat e sigurimit të kërkesëpadisë;
- 📄 Kontestet familjae me fokus (besimi i fëmijëve, alimentacioni dhe kontakti me fëmijë) dhe ndryshimi i vendimeve.


### Metodologjia

- 📖 Metoda të kombinuara të shpjegimit, shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

### Përfituesit

- 👥 Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit

### Kohëzgjatja

 Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.




Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Raporti i monitorimit të Proceeseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor



### **3. Anulimi i vendime gjyqësore - të gjeturat e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim**

Tryeza ka për qëllim që adresojë problemet që janë evidentuar nga Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim, e të cilat probleme kanë diktuar mos zbatimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga gjykata më e lartë, gjykatave të instancave më të ulëta me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim. Si sfidë tjetër që është identifikuar ka qenë moszbatimi i Mendimeve Juridike, Udhëzuesve Juridik dhe Qëndrimeve Parimore të Gjykatës Supreme nga ana e gjykatave të instancave më të ulëta, e që kanë rezultuar me divergjencë të praktikës gjyqësore, dhe si pasojë ka ardhur deri te cenimi i sigurisë juridike dhe trajtimi i pabarabartë i palëve në procedurë në qështje esencialisht të njëjta. Në disa raste udhëzimet dhe rekomandimet e gjykatave më të larta me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim nuk janë të qarta, janë të përgjithësuara dhe konfuze për gjykatat e instancave më të ulëta dhe si të tilla paraqesin dilema se si të veprojnë gjykatat me rastin e shqyrtimit të rasteve në rigjykim. Një nga të gjeturat e identifikuara është se në disa raste gjykatat e instancave më të larta me rastin e shqyrtimit ta rasteve sipas mjeteve të goditjes tejkalojnë kufijtë e ekzaminimit të këtyre mjeteve duke mos u kujdesur në respektimin e parimit “reformatio in pejus”. Çështjet për diskutim në këtë tryezë mund të jenë si në vijim: Kufijtë e ekzaminimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga ana e gjykatave të instancave më të larta. Të provuarit dhe mjetet provuese me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim, Parimi “reformatio in pejus”, Zbatimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve nga gjykatat e instancave më të ulëta, Zbatimi i Mendimeve Juridike, Udhëzuesve dhe Qëndrimeve Parimore të Gjykatës Supreme.


#### **Objektivat**

-  Unifikimi i praktikës gjyqësore;
-  Zbatimi unik i ligjeve procedurale dhe materiale;
-  Ngritja e efikasitetit dhe cilësisë në vendimmarrje.

#### **Përmbajtja**

-  Procedura Kontestimore sipas mjeteve të goditjes;
-  Të gjeturat e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim.


#### **Metodologjia**

-  Metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimit.

#### **Përfituesit**

-  Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore.

#### **Kohëzgjatja**

 Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Pyetëtori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese

#### 4. Unifikimi i praktikës gjyqësore në çështjet pronësore




Tryeza për çështje pronësore ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale në fushën e të drejtës pronësore. Në tryezën për çështje pronësore do të trajtohen çështjet ma thelbësore në kuadër të së drejtës pronësore. Çështjet pronësore në vendin tonë tërheqin pas tyre një tërësi të gjerë problematikash duke filluar nga ato ligjore e deri tek praktika gjyqësore e zbatimit jounike të ligjit material. Nisur nga rëndësia e marrëdhënieve pronësore juridik jo vetem për qytetaret por edhe për vete vendin, por edhe nga kompleksiteti dhe sfidat e kësaj fushe, kësaj tryeze duhet kushtuar rëndësia e duhur në programin e vazhdueshëm të arsimit ligjor. Ndryshimet ligjore që kanë ndodhur viteve të fundit lidhur me mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve pronësore, ndryshimi i sistemit shoqëror lidhur me konceptin e pronës dhe llojet e pronës, transaksionet joformale të transferimit të pronësisë, mos shqyrtimi i trashëgimisë, etj, kanë ndikuar që numri i rasteve të jetë tejet i madh në gjykata tonë. Praktika gjyqësore përballët me sfida të mëdha të cilat nuk kanë adresuar në mënyrë unike në sistemin gjyqësor, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejtë në sigurinë juridike. Gjykata Supreme e Kosovës në kuadër të juridiksionit të saj si gjykata e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimmarrjes në nivelet tjera gjyqësore, synon që përmes kësaj tryeze të organizuara nga Akademia e Drejtësisë të mbështes drejtpërdrejtë rritjen e performancës gjyqësore përmes rritjes së efikasitetit, cilësisë, zbatimit unik të dispozitave ligjore në mënyrë që puna e gjykatave të jetë objektive, ligjore dhe e besueshme. Temat e përfshira në këtë për këtë tryezë janë një përzgjedhje e kujdesshme e çështjeve më të rëndësishme dhe më aktuale, të cilat përmblihen në: Fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, të drejtës së ndërtimit dhe trashëgimisë. Arsyeshmëria e fokusimit në këto tru baza është për shkak të nevojave imediate si rezultat i praktikave jo unike, duke synuar në unifikim të praktikave gjyqësore që do të siguronin parimin e sigurisë juridike.

Punimet tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve pronësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Punimet e tryezës duhet të mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve pronësore, për çka moderatorët duhet të jenë të përgatitur për të dhënë komente e tyre të mbështetura në praktikën gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e fushës që trajtohet. Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Panelistet duhet të jenë të përgatitur dhe të hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlidhur ma temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitike të çështjes përkatëse por duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshme që dalin nga rastin që diskutohet. Adresimi i secilës çështje/temë të përmbledhur në këtë tryezë duhet të bëhet edhe përmes një prezantimi të fare të shkurtës (teorik) të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht duhet të pasohet me shembuj për secilën temë/çështje. Shembujet duhet të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe duhet të kenë mbështetje në një praktikë gjyqësore të konsoliduar. Në fund të punimeve në




tryezë moderatorët duhet të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Raporti do të shërbej për të shpërndarë rezultate e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çyshtej që duhet të përfshihet në programet e akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme Gjykatës Supreme të Kosovës. Tryeza synon eliminimin e divergjencave në vendimmarrje duke u bazuar në problemet e identifikuar.

Fitimi i Pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (kushtet ligjore për fitimin e pronësisë mbi bazën e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues, legjislacioni i aplikueshëm), ndërtimit (kushtet ligjore për fitimin e pronësisë mbi bazën e të drejtës së ndërtimit sipas LMTHJP-së, ndërtimi përtej kufirit sipas LPTDS-së) dhe trashëgimisë (kushtet ligjore për fitimin e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, rendet ligjore sipas LTK-së dhe anulimi i punëve juridike për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme)


## Objektivat

-  Unifikimi i praktikës gjyqësore;
-  Zbatimi unik i ligjeve;
-  Ngritja e cilësisë në vendimmarrje.


## Përmbajtja

-  Fitimi i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues;
-  Fitimi i pronësisë në bazë të së drejtës së ndërtimit dhe
-  Fitimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë.


## Metodologjia

-  Metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Apelit dhe Gjykatave Themelore.

## Kohëzgjatja

-  Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Pyetëtori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)

## 5. Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile



Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile është një prej fushave më komplekse e karakterizuar me vështirësi në përcaktimin, eksplorimin dhe aplikimin e ligjit të huaj, përfshirë







këtu edhe një numër të çështjeve procedurale, siç janë çështjet e shërbimeve të dokumenteve ndërkufitare, ndihma juridike ndërkombëtare, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore, etj. Secili gjyqtar është ballafaquar njëjtë si me çështje të brendshme ashtu edhe me ato ndërkufitare, dhe si rrjedhojë secili gjyqtar civilist ka nevojë për trajnim në trajtimin e rasteve me element ndërkombëtar. Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe shqyrtimit të rasteve praktike. Gjithashtu përmes rasteve studimore do të trajtohet praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Tryeza synon eliminimin e divergjencave në vendimmarrje duke u bazuar në problemet e identifikuar.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Praktika aktuale dhe sfidat e identifikuar në rastet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.


## Objektivat

-  Avancojnë njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet civile;
-  Zbatojnë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë bashkëpunimin ndërkufitar në çështjet civile.

## Përmbajtja

-  Dërgimi i shkresave;
-  Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të huaja;
-  Kompetenca gjyqësore;
-  Sigurimi i shpenzimeve të procedurës.


## Metodologjia

-  Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke përfshirë shpjegime teorike të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e gjykatave themelore.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjqytarë/prokurorë)
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese

## 6. Procedurat gjyqësore të shpronësimit





Instituti juridik i eksproprijimit, e që tani quhet shpronësim, deri në vitin 2009, ka qenë juridikisht i rregulluar me ligjin për eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 21/1978) me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tij, ndërsa pas shpalljes së pavarësisë, Republika e Kosovës nxori Ligj tjetër me të cilin ka rregulluar juridikisht këtë institut juridik i cili quhet Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 52, datë 8 maj 2009 kur edhe ka hyrë në fuqi ky ligj. Tani ky ligj, përcakton autoritetet përgjegjëse dhe ndarjen e përgjegjësisë në nivel qendror dhe komunal, përcakton kushtet dhe rregullat e procedurat për shpronësim, përcakton kushtet, rregullat dhe procedurat për kufizimin e shfrytëzimit të përkohshëm të pronës së paluajtshme, përcakton edhe kushtet, rregullat dhe kriteret e procedurave për caktimin e kompensimit. Si kundër Konventa Evropiane për Drejtat njeriut dhe lirit themelore, ashtu edhe neni 1 i Protokoli 1 i Konventës ka përcaktuar se ndërhyrja në të drejtat pronësore duhet të jetë i bazuar në ligj dhe se kjo duhet të jetë masë e fundit ndërhyrëse për arritjen e qëllimit të paraparë. Elemente e kërkuar sipas KEDNJ dhe Protokolit 1 të Konventës si dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për drejtat e njeriut janë: T'i shërbejë interesit të përgjithshëm, Ligji që cakton shpronësimin duhet të jetë qasshëm dhe preciz, Shpërblimi –kompensimi duhet të jetë adekuat nga ana e shtetit ndaj personave drejta e pronësisë të cilëve është prekur.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në kapitullin II të neni 46 paragrafi 3 lejon shpronësimin e pronës private, vetëm nëse është në interesin e publik. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, shpronësimi mund të bëhet vetëm nëse është caktuar me ligj dhe nëse është i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave shpronësohet. Korniza ligjore e cila rregullon shpronësimin në Kosovë është Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e këtij Ligji). Para hyrjes në fuqi ligjit në fjalë në Kosovë ka qenë e aplikueshme Ligji mbi eksproprijimin (Gazeta Zyrtare 21 /78 të Republikës së Kosovës). Me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme në mënyrë specifike parashikohen këto faza të cilat duhet të zbatojnë autoritetet shtetërore: Caktimi i interesit të përgjithshëm, Punët përgatitore, Procedura e shpronësimit, Vendimi i kompensimit. Dilemat që janë shfaqur kanë të bëjnë me kompetencën kur atakohet vendimi preliminar, pastaj divergjenca me rastin e gjykimit të diferencës së qmimit nga vlerësimi i organit shpronësues, kamata dhe llogaritja e saj si dhe humbja e vlerës dhe mënyra e të provuarit.


### Objektivat

- 🎯 Analizojnë procedurat e shpronësimit;
- 🎯 Avancojnë njohuritë rreth procedurës së caktimit të kompensimit;
- 🎯 Të vlerësojnë se çka përfshinë kompensimi;
- 🎯 Të kuptojnë mënyrën e caktimit të kompensimit.

## **Përmbajtja**

-  Procedura e caktimit të lartësisë së kompensimit të shpronësimit;
-  Kufizimet e të drejtës në pronë me KEDNJ dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
-  Caktimi i kompensimit dhe pagesa e kompensimit;
-  Metodatat e vlerësimit.


## **Metodologjia**

-  Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodatat interaktive të diskutimit dhe shtjellimit të rasteve, punë në grupe dhe do të zërthehen raste praktike.

## **Përfituesit**

-  Gjyqtarët e gjykatave themelore.

## **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për gjyqtar/prokuror për nevojat trajnuese 2025

## 7. Mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës

Trajnimi për mbrojtjen gjyqësore në kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, sipas Ligjit të Punës, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës së punës. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth procedurës së filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësve, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve paraprake të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi para se t'i drejtohet gjykatës me padi për të siguruar mbrojtje gjyqësore në konteste të tilla, procedurën e gjykatës dhe llojet e vendimmarrjes së kësaj të fundit lidhur me këto konteste. Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Cilat janë llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës? Cilat janë shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënies të punës sipas Ligjit të Punës? Cila është procedura para ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit? Cilat janë mjetet e punëmarrësit për të siguruar mbrojtje gjyqësore? Cilat janë afatet ligjore për sigurimin e mbrojtjes gjyqësore të kontestet e punës? Cilat janë vendimet gjyqësore të gjykatës në kontestet e punës? etj. Trajnimi do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore.

Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të vepron në të ardhmen.


### Objektivat

- 🎯 Zgjerojnë njohuritë lidhur me kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- 🎯 Identifikojnë legjislacionin e zbatueshëm vendor dhe ndërkombëtar në kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- 🎯 Dallojnë kontestet për nëpunësit e shërbimit civil dhe kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- 🎯 Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës duke vlerësuar afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.


### Përmbajtja

- 📄 Kontratat e punës dhe llojet e tyre;
- 📄 Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- 📄 Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës;
- 📄 Respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore;
- 📄 Zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive dhe Sektoriale.


## **Metodologjia**

 Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Projekti për Fuqizimin e Përmbartimit në Ballkan (BESP)" - i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës dhe i zbatuar nga Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor (CILC).

## 8. Marrëdhëniet detyrimore dhe sendore me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Ky trajnim është disejnuar për të dhënë njohuri të përgjithshme mbi risitë në fushën e së drejtës private në Kosovë në fokus në marrëdhëniet detyrimore dhe ato sendore. Si e tillë, ky trajnim do të adresojë e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe pjesën e specializuar të marrëdhënieve detyrimore dhe sendore, si dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Qëllimi i trajnimit është përditësimi i njohurive të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse në pjesën e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe mbi risitë e ligjit në përgjithësi, institutet dhe shtyllat kryesore të së drejtës ndërkombëtare private dhe do të njoftohen mbi risitë kryesore në tri shtyllat kryesore të tij: në përcaktimin e së drejtës kompetente, në kompetencën e gjykatave dhe në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe me specifikat e marrëdhënieve detyrimore me element të huaj dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar nga kjo fushë.


### Objektivat

- 🎯 Përditësimi i njohurive: Trajnimi synon të ofrojë njohuri të përgjithshme dhe specializuar mbi risitë në fushën e së drejtës private në Kosovë, me theks të veçantë në marrëdhëniet detyrimore. Qëllimi kryesor është përditësimi i njohurive të gjyqtarëve për risitë e ligjit dhe praktikën në këtë fushë.
- 🎯 Praktikën ndërkombëtare: Trajnimi do të ofrojë shpjegime mbi praktikën e Gjykatës së Drejtësisë të Unionit Evropian
- 🎯 Rishikimi i vendimeve gjyqësore: Trajnimi synon të njohë gjyqtarët me procedurat dhe sfidat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve detyrimore.
- 🎯 Bashkëpunimi ndërkombëtar: Trajnimi synon të promovojë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, duke ofruar shembuj praktikë të bashkëpunimit në fushën e ndërkombëtare private.


### Përmbajtja

- 📄 Përcaktimi i së drejtës kompetente në marrëdhëniet kontraktore me element të huaj në përgjithësi dhe në marrëdhëniet kontraktore me konsumatorë;
- 📄 Përcaktimi i së drejtës kompetente në kontratat individuale të punësimit me element të huaj;
- 📄 Përcaktimi i së drejtës kompetente në marrëdhëniet jashtkontraktore e vecanërisht në shkaktimin e dëmit me element të huaj;
- 📄 Përcaktimi i së drejtës kompetente në marrëdhëniet sendore me element të huaj;
- 📄 Juridiksioni i gjykatave të Kosovës në marrëdhëniet e lartcekura;
- 📄 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në këto marrëdhënie në Kosovë dhe anasjelltas.
- 📄 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në këtë fushë: shpjegime praktike mbi bashkëpunimin e gjykatave në marrjen e provave dhe shërbimin e dokumenteve.


## Metodologjia

 Në trajnim do të aplikohet metodologjia e kombinuar mes spjegimeve teorike të ndryshimeve që sjellë ligji dhe pjesës praktike të përbërë nga ushtrimet. Shpjegimet mbi risitë e ligjit dhe institutet e kësaj fushe të së drejtës bëhen duke elaboruar rastet kryesore në praktikë të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Unionit Evropian. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, përveç që është shumë e pasur, është tejet udhëzuese për gjyqtarët kosovarë meqë interpreton dispozitat e njëjta të cilat janë transpozuar në LDNP në Kosovë. Ndërkaq, në pjesën e ushtrimeve, gjyqtarëve u prezantohen probleme hipotetike të fushave të caktuara, të cilat ndërthurin dilema të përcaktimit të së drejtës kompetente, kompetencës së tyre si gjykata në Kosovë dhe/apo dilema mbi njohjen apo refuzimin e njohjes së një vendimi të huaj.

## Përfituesit

 Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore, në divizionin civil, gjyqtarët e gjykatës së Apelit në divizionin civil.

## Kohëzgjatja

 Trajnim to të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Projekti për Fuqizimin e Përmbartimit në Ballkan (BESP)" - i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës dhe i zbatuar nga Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor (CILC).

## 9. Marrëdhëniet familjare me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Ky trajnim është disejnuar për të dhënë njohuri të përgjithshme mbi risitë në fushën e së drejtës private në Kosovë në fokus në marrëdhëniet familjare. Si e tillë, ky trajnim do të adresojë e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe pjesën e specializuar të marrëdhënieve familjare dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Qëllimi i trajnimit është përditësimi i njohurive të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse në pjesën e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe mbi risitë e ligjit në përgjithësi, institutet dhe shtyllat kryesore të së drejtës ndërkombëtare private dhe do të njoftohen mbi risitë kryesore në tri shtyllat kryesore të tij: në përcaktimin e së drejtës kompetente, në kompetencën e gjykatave dhe në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe me specifikat e marrëdhënieve detyrimore me element të huaj dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar nga kjo fushë.

### Objektivat


- 🎯 Përditësimi i njohurive: Trajnimi synon të ofrojë njohuri të përgjithshme dhe specializuar mbi risitë në fushën e së drejtës private në Kosovë, me theks të veçantë në marrëdhëniet familjare. Qëllimi kryesor është përditësimi i njohurive të gjyqtarëve për risitë e ligjit dhe praktikën në këtë fushë.
- 🎯 Praktikën ndërkombëtare: Trajnimi do të ofrojë shpjegime mbi praktikën e Gjykatës së Drejtësisë të Unionit Evropian.
- 🎯 Rishikimi i vendimeve gjyqësore: Trajnimi synon të njohë gjyqtarët me procedurat dhe sfidat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve detyrimore.
- 🎯 Bashkëpunimi ndërkombëtar: Trajnimi synon të promovojë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, duke ofruar shembuj praktikë të bashkëpunimit në fushën e ndërkombëtare private.

### Përmbajtja


- 📄 Hyrje e përgjithshme në të Drejtën Ndërkombëtare Private (LDNP) në Kosovë;
- 📄 Ndryshimet kryesore të LDNP me ligjin e ri;
- 📄 Kompetenca dhe e drejta kompetente;
- 📄 Hyrje e përgjithshme në Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile (BJNÇC);
- 📄 Marrëveshjet dypalëshe dhe aplikimi i tyre;
- 📄 Temat specifike familjare me element të huaj;
- 📄 Shkurorëzimet, mbajtja (ushqimia) dhe regjimi pasuror martesor;
- 📄 Përgjegjësia prindërore;
- 📄 Trashëgimia.




## Metodologjia

 Trajnimi do të udhëhiqet më një metodologji që në plan të parë ka ligjërimit interaktiv dhe prezantimet e trajnerëve. Për të nxitur ndërveprimin me audiencën, për trajnimin do të hartohen raste studimi dhe ushtrime praktike që vëjnë në pah dilemat kryesore praktike gjatë zbatimit të kornizës ligjore. Shpjegimet mbi risitë e ligjit dhe institutet e kësaj fushe të së drejtës bëhen duke elaboruar rastet kryesore në praktikë të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Unionit Evropian. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, përveç që është shumë e pasur, është tejet udhëzuese për gjyqtarët kosovarë meqë interpreton dispozitat e njëjta të cilat janë transpozuar në LDNP në Kosovë. Ndërkaq, në pjesën e ushtrimeve, gjyqtarëve u prezantohen probleme hipotetike të fushave të caktuara, të cilat ndërthurin dilema të përcaktimit të së drejtës kompetente, kompetencës së tyre si gjykata në Kosovë dhe/apo dilema mbi njohjen apo refuzimin e njohjes së një vendimi të huaj.

## Përfituesit

 Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore, në divizionin civil, gjyqtarët e gjykatës së Apelit në divizionin civil.

## Kohëzgjatja

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA  
DREJTËSISË PËR FËMIJË***

## Aspekti Civil

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Formulari për vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

### 1. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit

Trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Gjithashtu do të diskutohet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në këto raste, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe risitë e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Cilat janë parimet dhe procedura për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi, në rastet e besimit të fëmijës në prind, pagimin e alimentacionit dhe caktimin e kontakteve personale? Cili është legjislacioni ndërkombëtar i aplikueshëm në këto raste? Mbi çfarë kritere vendos gjykata në këto raste? Cilat janë pasojat e fëmijëve si pasojë e dhunës në familje? Kush mund të kërkojë një urdhër mbrojtjeje? Çfarë informacioni duhet të përfshijë kërkesë-padia? Kush njoftohet për urdhrin e mbrojtjes? Trajnimi do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore. Trajnimi do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve familjare, me theks të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurë gjyqësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit, besimit të fëmijës, alimentacionit dhe caktimit të kontakteve personale, si dhe në rastet e dhunës në familje etj. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të vepron në të ardhmen.

## Objektivat

- 🎯 Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Familjen i Kosovës, të cilat ndërliohen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe dhunës në familje;
- 🎯 Unifikimi i praktikave në gjykatat e instancave më të ulëta;
- 🎯 Identifikimi dhe adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

## Përmbajtja

- 📄 Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar;
- 📄 Kriteret që merr për baze gjykata në rastet e besimit të fëmijëve dhe parimet për përcaktimin e alimentacionit; caktimi i kontakteve personale, si dhe masat e përkohshme sipas LFK;
- 📄 Dhuna në familje, urdhri për mbrojtje dhe procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, në rastet kur pjesëmarrës janë fëmijët;
- 📄 Llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrin për mbrojtje, në raport me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

## Metodologjia

- 📖 Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

## Përfituesit

- 👥 Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas.

## Kohëzgjatja

- 🕒 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

## 2. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre




Trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Gjithashtu do të diskutohet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe risitë e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për tu njohur dhe vërtetuar e drejta e amësisë dhe atësisë? Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen dhe procedura gjyqësore që duhet të zhvillohet në rastet e kundërshtimit të atësisë apo amësisë? Cilat janë aktet vendore dhe ndërkombëtare që zbatohen në procedurën e vërtetimit/kundërshtimit të amësisë/atësisë? Cilat janë efektet e njohjes apo kundërshtimit të atësisë/amësisë në raport me fëmijën? etj.

Trajnimi do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore në procedurën për mbrojtjen e fëmijëve me rastin e ndryshimit të statusit të tyre. Trajnimi do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve familjare, me theks të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me rastin e ndryshimit të statusit të tyre në procedurë gjyqësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.


### Objektivat

- 🎯 Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Familjen i Kosovës, të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre;
- 🎯 Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- 🎯 Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.


## Përmbajtja

-  Amësia dhe atësia;
-  Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën e kundërshtimit dhe vërtetimit të atësisë apo amësisë dhe parimi i interesit më të lartë të fëmijës;
-  Risetë dhe zbatimi në praktikë i dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.


## Metodologjia

-  Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS); Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

### 3. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror

Trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Gjithashtu do të diskutohet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe risitë e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.





Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për tu lejuar adoptimi i fëmijës? Cila është procedura ligjore që duhet të ndiqet nga prindi adoptues për të adoptuar një fëmijë? A mund të adoptohen fëmijët shtetas të Kosovës nga shtetasit e huaj? Cilat janë aktet ndërkombëtare që zbatohen në procedurën e themelimit të adoptimit? Cilat janë format tjera të përkujdesjes prindërore të parapara me LFK? Si vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës në këtë procedurë? Cilat janë metodat e komunikimit me fëmijët në procedurën e adoptimit? Etj.

Trajnimi do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore në procedurën e themelimit të adoptimit dhe jo vetëm. Trajnimi do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve familjare, me theks të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror në procedurë gjyqësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.


#### Objektivat

- 🎯 Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Familjen i Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- 🎯 Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- 🎯 Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.


## **Përmbajtja**

-  Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
-  Adoptimi;
-  Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore;
-  Parimi i interesit më të lartë të fëmijës.


## **Metodologjia**

-  Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

## **Përfituesit**

-  Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas.

## **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.



## Aspekti Penal

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

### 1. Veprat penale kundër integritetit seksual

Nevoja për trajnimin e kësaj teme ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të veprave penale të kësaj natyre ku fatkeqësisht viktimat të dhunës seksuale paraqiten fëmijët, pastaj ndjeshmëria gjatë trajtimit të rasteve të tilla në praktikë duke filluar nga paraqitja e rastit në polici, metodat dhe mënyrat e trajtimit të rastit nga policia, prokuroria dhe gjykata, duke përfshirë të gjithë akterët e tjerë të nevojshëm për trajtimin e rasteve të tilla.

Po ashtu me qëllim të analizimit dhe diskutimit për të arritur deri te praktikat më të mira, në aplikimin e metodave për trajtimin e rasteve ku fëmijët paraqiten viktimat të dhunës seksuale, për të arritur tek konkluzionet sa më të qarta në interpretimin e dispozitave ligjore të KPK-së, KPPK-së dhe KDM-së, në drejtim të trajtimit të rasteve të tilla duke marrë për bazë ndjeshmërinë e veprave penale kundër integritetit seksual sidomos kur fëmijët janë viktimat, kërkohet një trajtim më i detajuar i rasteve të tilla duke mos lënë dilema në interpretimin e dispozitave ligjore përkatëse. Nga pjesëmarrësit pritet që të diskutohet në mënyrë interaktive me trajnuesit dhe në mes vete në lidhje me dilemat dhe vështirësitë gjatë punës së tyre praktike, ashtu që në përfundim të trajnimit të jenë sa më të qarta objektivat e këtij trajnimi dhe ngritjen e profesionalizmit në aplikimin e dispozitave ligjore më praktike në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, veçanërisht kur viktimat janë fëmijët.

Një ndër sfidat më të rënda në shoqërinë tona, është prania e viktimave fëmijë si pasojë e veprave penale kundër integritetit seksual si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm, kështu që zhvillimi i shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur lidhur me trajtimin e rasteve të tilla kërkon qasje serioze dhe ngritjen e aftësive profesionale.


### Objektivat

- 🎯 Zgjerimi i njohurive materiale dhe procedurale kur fëmija është viktimë e dhunës seksuale;
- 🎯 Analizimi dhe format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera lidhur me integritetin seksual;
- 🎯 Aplikimi i drejtë i dispozitave ligjore lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual;
- 🎯 Zbatimi i kufizimit ligjor për marrjen e deklaratës së fëmijës – viktimë e dhunës seksuale;


### Përmbajtja

- 📄 Dhunimi seksual, sulmi seksual;
- 📄 Ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve – viktimat të dhunës seksuale;
- 📄 Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i fëmijëve në internet.


## **Metodologjia**

 Gjatë trajnimit do të përdoren metoda interaktive me pjesëmarrës në trajnim, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit, aplikimi i praktikës më të mirë në trajtimin e rasteve kur kemi të bëjmë me fëmijë – viktime të dhunës seksuale.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarë dhe prokurorë, zyrtar nga zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, bashkëpunëtorë profesional, zyrtar policor dhe zyrtar nga Qendra për Punë Sociale duke përfshirë psikolog.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Trajnuesi i përhershëm
- Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)

## 2. Procedura penale që zhvillohet për fëmijë dhe të miturit

Pjesëmarrja e të miturve në aktivitetet kriminale, sjelljet e tyre antisociale të cilat parashihen si vepra penale, obligon organet e drejtësisë në aplikimin në ndërmarrjen e veprimeve në përputhje me ligjin. Një ndër sfidat më të rënda, është prania e delikuencës së të miturve si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm, kështu që zhvillimi i shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur lidhur me shqiptimin e masave dhe dënimeve të parapara me KDM-se, është nevojë e vazhdueshme. Në këtë aspekt, Kosova ka treguar tendenca të realizimit të një lufte adekuate kundër sjelljeve kriminale, me qëllim të parandalimit dhe luftimit më efikas të sjelljeve të tilla të miturve si dhe shqiptimin e masave apo dënimeve adekuate kur vërtetohet se një i mitur ka kryer vepër penale.

Nga pjesëmarrësit pritët që të diskutohet në mënyrë interaktive me trajnuesit dhe në mes vete në lidhje me dilemat dhe vështirësitë gjatë punës së tyre praktike, ashtu që në përfundim të trajnimit të jenë sa më të qarta objektivat e këtij trajnimi dhe ngritjen e profesionalizmit në aplikimin e dispozitave ligjore më praktike në trajtimin e rasteve kur kryerësit e veprave penale janë të miturit që ndaj tyre prokurori apo gjyqtari për të mitur i shqipton masat apo dënimet e parapara me KDM-se.

Një nga sfidat e sistemit të drejtësisë ka të bëjë edhe me delikuencën e të miturve, që përfshihen në kryerjen e veprave penale, pastaj fakti i rritjes së numrit të rasteve ku të miturit paraqiten si kryerës të veprave penale, shqetësuese mbetet edhe recidivizmi i tyre dhe aplikimi i masave apo dënimeve adekuate me qëllim të arritjes së preventives në kryerjen e veprave penale.

### Objektivat

- 🎯 Identifikojnë rastet kur ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin zbatohet procedura penale;
- 🎯 Përcaktojnë se për cilat raste mund të shqiptohen masat apo dënimet ndaj një të mituri;
- 🎯 Zbatojnë drejt dispozitat ligjore të Kodit të Drejtësisë për të mitur dhe akteve ndërkombëtare.

### Përmbajtja

- 📄 Masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturve;
- 📄 Ndihma post penale në procedurën për të mitur;
- 📄 Llojet e masave të diversitetit – vërejtja policore;
- 📄 Detyrimet e veçanta lidhur me masat e mbikëqyrjes së shtuar – këshillimi psikologjik, përmbajtja nga përdorimi i drogës dhe alkoolit.

## **Metodologjia**



Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodologjia interaktive në formë të diskutimit e kombinuar me raste praktike – puna në grupe.

## **Përfituesit**



Gjyqtarë dhe prokurorë për të mitur, bashkëpunëtor profesional, zyrtar nga shërbimi sprovues, zyrtar policor dhe zyrtar nga Qendra për Punë Sociale duke përfshirë psikolog.

## **Kohëzgjatja**



Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA  
KOMERCIALE***





Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale




## 1. Ndryshimet me Hyrjen në Fuqi të Kodit të Ri Doganor dhe të Akcizave të Kosovës

Përmes këtij trajnimi gjyqtarët do të arrijnë njohuri të avancuara për trajtimin e metodave të vlerësimit të mallit importues dhe metodave të vlerësimit të shpenzimeve të transportit duke analizuar Udhëzimin Administrativ përkatës dhe përcaktimi i kodeve tarifore. Në këtë trajnim do të zërthehen dispozitat ligjore që përmban Kodi i ri Doganor dhe i Akcizave të Kosovës dhe udhëzimet administrative përcjellëse për zbatimin e tij që janë në fuqi. Gjithashtu do të trajtohet vendosja e kodeve tarifore duke u mbështetur në dokumentacionet përcjellëse që duhet t'i bashkëngjiten Deklaratës Doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë. Me interes do të jetë edhe trajtimi i çështjes së importeve të përkohshme.


### Objektivat

-  Zbatojnë drejtë rregullat e aplikimit të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës;
-  Vlerësojnë drejtë kodet tarifore dhe dokumentet e detyrueshme doganore;
-  Zbatojnë drejtë dispozitat që përmban Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës dhe udhëzimet administrative përcjellëse në kontestet gjyqësore;
-  Zbatojnë drejtë dispozitat dhe kriteret mbi importet e përkohshme.


### Përmbajtja

-  Aplikimi i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës;
-  Kodet tarifore (TARIK) dhe dokumentet e detyrueshme doganore për vlerësimin e drejtë të kodit tarifor;
-  Trajtimi i importeve të përkohshme.


### Metodologjia

-  Adresimi i dilemat dhe çështjet në trajnimit do të behen permes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret, përmes ushtrimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Kodit Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, puna në grupe dhe raste praktike.

### Përfituesit

-  Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Agjencia për Pronësi Industriale/MINT
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurore)
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale

## 2. Zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale, markat tregtare dhe patentat





E drejta e pronës intelektuale në përgjithësi dhe ajo e markave tregtare dhe patentave në veçanti (të gjitha së bashku referuar si pronësi intelektuale apo PI) është fushë e së drejtës relativisht e re në Kosovë. Institutet apo konceptet e kësaj lëmie me të cilat ballafaqohet sistemi gjyqësor janë shumë specifike dhe aspak të ngjashme me ato të cilat është ballafaquar sistemi gjyqësor tradicionalisht. Prandaj, vendimet gjyqësore mund të mos jenë të një niveli të duhur si për nga aspekti procedural ashtu edhe përmbajtësor gjë që zvogëlon besimin e komunitetit të biznesit tek gjyqësori. Trajnimi do të fokusohet në përditësimin e njohurive në këtë lëmi që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për një gjyqësor të efektshëm. Trajnimi gjithashtu do të fokusohet edhe në sqarimet e hollësishme rreth teknologjisë dhe impakti i saj në sistemin e drejtësisë veçanërisht në fushën e të drejtës elektronike komerciale si përgjegjësia ligjore, ndërmjetësuesit e shërbimeve, kontratat dixhitale etj. dhe në këtë vështrim do të ofrohen praktikat më të mira në zgjidhjen e këtyre çështjeve.

### Objektivat


- 🎯 Njohin institutet kryesore e të drejtave të PI, markave tregtare e treguesve gjeografik, patentave e dizajneve industriale, si dhe të njohin dallimet midis këtyre instituteve;
- 🎯 Aplikojnë parimet e së drejtës së PI dhe praktikat e mira në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;
- 🎯 Aplikojnë parimet e së drejtës së PI dhe praktikat e mira në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për marka tregtare dhe treguesit gjeografik si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për patenta dhe dizajnit industrial;
- 🎯 Interpretojnë legjislacionet, politikat dhe praktikat e mira rajonale dhe globale nga shtete apo organizata të ndryshme dhe të mund t'i përdorin këto njohuri sa më mirë për të zgjidhur rastet në Kosovë;
- 🎯 Identifikojnë akteret përgjegjës dhe institucionet globale që mund të ndihmojnë në hetimin dhe identifikimin e aktereve përgjegjës;
- 🎯 Njohin problematikat specifike në TIK si: përgjegjësia ligjore; pronësia; licencimi, privatësia etj.

### Përmbajtja


- 📄 Të drejtat e PI - mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta;
- 📄 Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave nga markat tregtare dhe treguesit gjeografik;
- 📄 Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave nga patentat dhe dizajni industrial;
- 📄 Mjetet juridike për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- 📄 Baza e TI dhe e drejta elektronike komerciale;
- 📄 Teknologjia e informacionit dhe komunikacionit;

-  Sfidat ligjore dhe etike që paraqet TIK;
-  Rregullimi i TIK;
-  Komerçi elektronik;
-  Të drejtat e autorit online, sfidat ligjore, rregullimi online, domenet dhe licencimi pronësisë intelektuale.


### **Metodologjia**

-  Në këtë trajnim do të aplikohet metodologjia interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

### **Përfituesit**

-  Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerçiale.

### **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.






Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Agjencia për Pronësi Industriale/MINT
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale


### 3. Njohja dhe Përmbartimi i Vendimeve të Arbitrazhit Vendor dhe të Huaj

Trajnimi me temën njohja dhe përmbartimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit vendor dhe të huaj ka për qëllim të sqaron saktësisht rëndësinë dhe procedurën e njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit si ato vendore ashtu edhe të huaja duke ndihmuar gjyqtarët të unifikojnë praktikën e njohjes dhe përmbartimit të këtyre vendimeve. Trajnimi synon të arrijë ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve në drejtim të interpretimit të drejtë dhe të saktë të dispozitave që mund të kenë dykuptimësi të njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit. Cilat janë sfidat që hasin gjyqtarët gjatë procedurës së njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit vendor dhe të huaj? Cilat janë të metat eventuale që gjyqtarët shohin në aspektin e procedurës së njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit? A ekziston ndonjë sfidë eventuale lidhur me implementimin apo përmbajtjen e Ligjit për Arbitrazhin? Mënyra më e mirë e kuptimit të të gjitha koncepteve dhe zgjidhjes së dilemave është biseda interaktive me gjyqtarët dhe shtrimi i pyetjeve dhe nxjerrja e konkluzioneve për çështjet e ngritura përmes shpalosjes së praktikave më të mira dhe qartësisht të problematikave mbi shembuj apo koncepte praktike.


#### Objektivat

-  Kuptojnë saktë rolin e gjyqtarëve në procesin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit
-  Zbatojnë drejtë bazën ligjore të arbitrazhit;
-  Unifikojnë praktikën e njohjes dhe përmbartimit.

#### Përmbajtja

-  Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës


#### Metodologjia

-  Trajnimi do të zhvillohet në mënyrë interaktive nga pjesëmarrësit dhe shtjellime të rasteve praktike.

#### Përfituesit

-  Gjyqtarët e Gjykatës Komerciale dhe bashkëpunëtorët profesional.

#### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale

#### 4. Implikimet Praktike të Ligjit për Shoqëritë Tregtare

Trajnimi do të fokusohet në shpjegimin e të gjitha shoqërive tregtare që mund të themelohen në Kosovë në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, strukturat organizative dhe aktivitetet ekonomike që mund të ushtrojnë. Po ashtu në përgjegjësitë dhe kompetencat e ARBK-së në aspektet si: kapitali themeltar, aksionet preferenciale, aksionet e zakonshme, dokumentet e themelimit, ruajtja e tyre, shpërndarja e dividendes etj. si dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që lindin nga Ligji për Shoqëritë Tregtare. Për më tepër, në këtë trajnim do të trajtohen edhe qeverisja korporative, strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve si dhe bashkimet, ndarjet, dhe qarkullimi i korporatës.

##### Objektivat

- 🎯 Avancojnë njohurite rreth shoqërive të ndryshme tregtare;
- 🎯 Përshkruajnë formën e organizimit të shoqërive tregtare dhe strukturat e tyre pronësore;
- 🎯 Dallojnë të drejtat dhe detyrimet e aksionareve, përfaqësuesve të autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve, dhe palëve të treta në lidhje me shoqëritë tregtare;
- 🎯 Përshkruajnë dhe diskutojnë mosmarrëveshjet (problemet) që lindin deri tek rastet gjyqësore.
- 🎯 Të kenë njohuri mbi qeverisjen korporative, strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve
- 🎯 Të kuptojnë në përgjithësi se si bëhet bashkimi, ndarja dhe qarkullimi i korporatës.

##### Përmbajtja

- 📄 Llojet e Shoqërive Tregtare - Funkzionet dhe Kompetencat e ARBK-së;
- 📄 Natyra e Organizimit të Shoqërive Tregtare dhe Struktura Pronësore;
- 📄 Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë;
- 📄 Qeverisja korporative;
- 📄 Strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve;
- 📄 Bashkimet, ndarjet, dhe qarkullimi i korporatës.

##### Metodologjia

- 📖 Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

##### Përfituesit

- 👥 Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

##### Kohëzgjatja

- 🕒 Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale

## 5. Kontratat në Ekonomi

Në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari specifike, përdorin kontrata që janë specifike për afarizmin e tyre, e të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët.

Trajnimi do të shërbejë që të: rritet ekspertiza profesionale e gjyqtarëve në këtë fushë, të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon, avancimin e njohurive për aplikimin e instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë. Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve të pjesshme teorike, diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe prezantimit të rasteve praktike.

### Objektivat

- 🎯 Njohin kontratën e franshizës, asignacionit, lizingut, know-how, licencën;
- 🎯 Njohin kontratën publike dhe specifikat e tyre;
- 🎯 Njohin kontratën për shitje ndërkombëtare të mallrave dhe specifikat e tyre;
- 🎯 Zbatojnë drejtë Konventën Ndërkombëtare për Shitjen e Mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në Kosovë;

### Përmbajtja

- 📄 Kontrata franshizës, e asignacionit, lizingut dhe karakteristikat e saj;
- 📄 Kontrata për know-how dhe per licencën dhe karakteristikat e saj;
- 📄 Kontratat publike, llojet e tyre, specifikat dhe karakteristikat tjera;
- 📄 Konventa ndërkombëtare për shitjen e mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në raportet afariste me element të huaj;
- 📄 Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- 📄 Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.

### Metodologjia

- 📖 Trajnimi është i dizajnuar në atë formë që përbëhet prej trajtimit teorik dhe prezantimit të rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore si dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

### Përfituesit

- 👥 Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

### Kohëzgjatja

- 🕒 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale

## 6. Procedura e Falimentimit

Ligji për falimentimin përbën ligj gjithëpërfshirës mbi falimentimin dhe josolvencen, i cili i pasqyron praktikën më të mira ndërkombëtare, por përmban shumë institute dhe specifika tjera të cilat pothuajse ishin të panjohura në sistemin tonë juridik. Prandaj, trajnimi ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve komercial në fushën specifike të falimentimit me qëllim të krijimit të një praktike gjyqësore të avancuar dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Për më tepër Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin e ri për Falimentimin (Ligji Nr. 08/L-256), i cili ka hyrë në fuqi më 06.08.2024, dhe ky ligj përfshin risi në procedurën e Falimentimit, andaj gjyqtarët duhet të marrin njohuri të detajuara për institutet ligjore dhe ndryshimet në ligjin e ri.

### Objektivat

- 🎯 Avancojnë njohuritë rreth instituteve kryesore të ligjit për Falimentimin;
- 🎯 Shpjegojnë pasojat e hapjes së rastit të falimentimit;
- 🎯 Zhvillojnë procedurën e falimentimit dhe të aplikojnë specifikat e saj;
- 🎯 Vlerësojnë kërkesat e kreditorëve, rregullsinë e paraqitjes, afatet dhe prioritetin e kërkesave;
- 🎯 Vlerësojnë kushtet ligjore dhe të mbikëqyrin procedurën e ri-organizimit apo likuidimit të shoqërive tregtare;
- 🎯 Të aplikojnë dispozitat ndërkufitare.

### Përmbajtja

- 📄 Kuptimi i falimentimit, dispozitat e përgjithshme të Ligjit për falimentimin;
- 📄 Procedurat e përshpejtuara (NMV dhe para-pakot);
- 📄 Fillimi dhe hapja e rasteve, pasojat e hapjes së rasteve;
- 📄 Kërkesat e kreditorëve;
- 📄 Riorganizimi;
- 📄 Likuidimi;
- 📄 Lirimi individual dhe mbyllja e rastit;
- 📄 Dispozitat ndërkufitare.

### Metodologjia

- 👤 Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

### Përfituesit

- 👤 Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

### Kohëzgjatja

- 🕒 Trajnimi do të zgjatë tri (3) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Kryetari i Gjykatës Komerciale
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale

## 7. Shkëputja e Kontratës dhe Efektet e Shkëputjes

Edhe pse palët i lidhin kontratat në bazë të vullnetit të tyre më qëllim të përmbushjes dhe realizimit të qëllimit për të cilin i lidhin, megjithatë në praktikë gjatë implementimit të kontratave paraqiten situata të ndryshme të cilat imponojnë shkëputjen e kontratave respektivisht pamundësojnë përmbushjen e tyre. Te disa kontrata na paraqiten edhe dispozita nule të cilat nuk krijojnë efekte juridike ndaj palëve kontraktuese. Mos përmbushja e kontratës, shkëputja e saj dhe nulimi i dispozitave kontraktuese, krijon pasojë juridike për palët kontraktuese të cilat shpesh bëhen objekt shqyrtimi në procedura gjyqësore. Këto pasoja janë të theksuara në sektorin ekonomik sepse kompanitë gjatë operimit të tyre për shkak të shkëputjes së kontratës mund të pësojnë dëme të natyrave specifike, si fitimi i humbur, dëmi ndaj palëve të treta, kompensimi i penalteteve ndaj kontraktorëve tjerë, etj. Prandaj trajtimi i këtyre rasteve kërkon njohuri specifike, jo vetëm të ligjeve materiale por edhe të specifikave të operimit në fushën ekonomike. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve të kësaj natyre, sidomos në sferën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, është i konsiderueshëm me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë.


### Objektivat

- 🎯 Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve në sferën kontraktuale;
- 🎯 Pasojë juridike për palët kontraktuese në rastet e mos përmbushjes së kontratës, shkëputjes së kontratës dhe nulimin e dispozitave kontraktuese;
- 🎯 Specifikat e shkëputjes, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- 🎯 Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
- 🎯 Aplikimi në praktikë i përvojave dhe praktikave me të mira të shteteve në rajon;
- 🎯 Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë.


### Përmbajtja

- 📄 Karakteristikat e kontratave në ekonomi dhe detyrimet kontraktuese;
- 📄 Mos përmbushja e plotë dhe mos përmbushja e pjesshme e kontratës;
- 📄 Kushtet specifike të kontraktuara në rast të mos përmbushjes së kontratës;
- 📄 Të drejtat e palëve në rast të mos përmbushjes së kontratës;
- 📄 Pasojat juridike në rast të shkëputjes së kontratës;
- 📄 Pasojat juridike në rast të nulitetit të dispozitave kontraktuese;
- 📄 Llojet e kompensimit për shkak të mos përmbushjes së kontratave në ekonomi;
- 📄 Mënyra e llogaritjes së lartësisë së kompensimit;
- 📄 Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- 📄 Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.


## Metodologjia

 Zbatimi i metodologjise interaktive, ushtrime dhe diskutime, trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete, diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve, me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinionëve.

## Përfituesit

 Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

## Kohëzgjatja

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.






Temë e identifikuar nga:

- Kryetari i Gjykatës Komerciale
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale






## 8. Kontrata e Sigurimit dhe Kompensimi i Dëmit

Për trajtimin e duhur të rasteve të sigurimit kërkohen njohuri të mjaftueshme jo vetëm në aspektin e trajtimit të dëmeve që lindin nga rastet e siguruara por edhe njohuri lidhur me natyrën e sigurimeve, specifikat e kontratave të sigurimit, mënyrën e lidhjes dhe interpretimit të tyre, procedurën e trajtimit të dëmit si dhe mënyrat e vlerësimit të dëmit në aspektin e përgjegjësisë dhe kompensimit adekuat. Meqenëse në praktikën gjyqësore numri më i madh i kontesteve paraqiten nga sfera e dëmeve të shkaktuara në komunikacion, fokusi i trajnimit do të jetë sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia duke përfshirë: mënyrat e trajtimit të dëmit, kompensimi i dëmit, bazat e përgjegjësisë dhe regresimi në rastet e sigurimeve “kasko”. Si të rritet ekspertiza profesionale e gjyqtarëve në këtë fushë? Si të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane? Cilat janë përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon? Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve të pjesshme teorike, diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe prezantimit të rasteve praktike.


### Objektivat

-  Njohin specifikat e kontratës së sigurimit – kushtet e përgjithshme dhe të veçanta;
-  Dallojnë procedurat për kompensimin e dëmit jashtë procedurës gjyqësore;
-  Zbatojnë drejtë procedurën gjyqësore për kompensimin e dëmit;
-  Njohin bazat e përgjegjësisë në rastet e shkaktimit të dëmit;
-  Identifikojnë llojet e kompensimit adekuat në rastet e dëmeve të paraqitura.


### Përmbajtja

-  Subjektet e të drejtës së sigurimeve; Sigurimi nga auto përgjegjësia; Polica e sigurimit TPL dhe kufijtë e mbulesës;
-  Kërkesa për kompensim të dëmit;
-  Shpërblimi i dëmit material dhe jomaterial nga polica e sigurimit;
-  E drejta në rentë;
-  Regresimi i dëmit.


### Metodologjia

-  Gjatë trajnimit do të aplikohet metodologji interaktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ushtrimeve dhe diskutimeve, prezantim i rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

### Përfituesit

-  Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026;
- Rekomandimet e trajnuesve pas sesioneve trajnuese
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale

## 9. Marrëdhëniet Komerciale me Element të Huaj dhe Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në Çështje Komerciale

Trajnimi ka për qëllim përditësimin e njohurive të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse në pjesën e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe mbi risitë e ligjit në përgjithësi, institutet dhe shtyllat kryesore të së drejtës ndërkombëtare private dhe do të njoftohen mbi risitë kryesore në tri shtyllat kryesore të tij: në përcaktimin e së drejtës kompetente, në kompetencën e gjykatave dhe në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe me specifikat e marrëdhënieve komerciale/tregtare me element të huaj.

### Objektivat


- 🎯 Trajnimi synon të përditësojë njohuritë e gjyqtarëve të gjykatave të Kosovës në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, me theks të veçantë në marrëdhëniet komerciale dhe tregtare. Ky qëllim përfshin njohurinë për risitë ligjore dhe institucionet që lidhen me marrëdhëniet me element të huaj.
- 🎯 Kuptimi i autonomisë së vullnetit: Trajnimi synon të ndihmojë gjyqtarët në kuptimin e autonomisë së vullnetit të palëve në përcaktimin e së drejtës kompetente në marrëdhëniet komerciale me element të huaj.
- 🎯 Praktikat ndërkombëtare: Trajnimi do të ofrojë shpjegime mbi praktikën e Gjykatës së Drejtësisë të Unionit Evropian
- 🎯 Rishikimi i vendimeve gjyqësore: Trajnimi synon të njohë gjyqtarët me procedurat dhe sfidat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve tregtare dhe të punës
- 🎯 Bashkëpunimi ndërkombëtar: Trajnimi synon të promovojë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, duke ofruar shembuj praktikë të bashkëpunimit në fushën e ndërkombëtare private.

### Përmbajtja


- 📄 Përcaktimi i të drejtës kompetente në marrëdhëniet tregtare me element të huaj, autonomia e vullnetit të palëve në këtë përcaktim;
- 📄 Juridiksioni i gjykatave të Kosovës në marrëdhëniet tregtare me element të huaj dhe në kontestet nga e drejta e punës;
- 📄 Juridiksioni i Gjykatës Komerciale në Kosovë në këto marrëdhënie;
- 📄 Autonomia e vullnetit të palëve në përcaktimin e gjykatës kompetente (të Kosovës apo të huaj);
- 📄 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve tregtare dhe e drejta e punës;
- 📄 Njohja e vendimeve gjyqësore të Kosovës në vendet tjera;
- 📄 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në këtë fushë: shpjegime praktike mbi bashkëpunimin e gjykatave në marrjen e provave dhe shërbimin e dokumenteve.




## Metodologjia

 Aplikimi i metodologjis së kombinuar mes shpjegimeve teorike të ndryshimeve që sjellë ligji dhe pjesës praktike të përbërë nga ushtrimet. Shpjegimet mbi risitë e ligjit dhe institutet e kësaj fushe të së drejtës bëhen duke elaboruar rastet kryesore në praktikë të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Unionit Evropian. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, përveç që është shumë e pasur, është tejet udhëzuese për gjyqtarët kosovarë meqë interpreton dispozitat e njëjta të cilat janë transpozuar në LDNP në Kosovë.

## Përfituesit

 Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

## Kohëzgjatja

 Trajnim do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Kryetari i Gjykatës Komerciale
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale

## 10. Kontrata e Ndërtimit

Kontrata mbi ndërtimin dhe kontrata e inxhinjeringut aktualisht kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e ndërtimit duke pasur parasysh fazën e rindërtimit të vendit. Po ashtu kontratat publike kanë një përdorim të gjerë në sferën publike. Ndërsa shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për Shitje Ndërkombëtare të Mallrave. Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçantë me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkojnë njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata, për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga raporti afarist i krijuar përmes këtyre kontratave. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

Si të rritet ekspertiza profesionale e gjyqtarëve në këtë fushë? Si të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane? Cilat janë përvojat dhe praktikave më të mira të shteteve në rajon? Si të aplikohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë?


### Objektivat

- 🎯 Njohin specifikat, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera të kontratës së ndërtimit, inxhinjeringut dhe kontratave publike;
- 🎯 Zbatojnë drejtë Konventën Ndërkombëtare për Shitjen e Mallrave, në raportet afariste me element të huaj;
- 🎯 Zbatojnë drejtë procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- 🎯 Njohin mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.


### Përmbajtja

- 📄 Karakteristikat e kontratës publike të ndërtimit dhe specifikat e tyre;
- 📄 Kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës;
- 📄 Klauzola “çelësi në dorë”;
- 📄 Ndryshimet e çmimeve për shkak të ndryshimeve në treg;
- 📄 Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- 📄 Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.


## **Metodologjia**

 Trajnimi do të aplikojë një metodologji interaktive të të mësuarit e cila përbëhet nga prezantimi i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore si dhe diskutimeve për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete dhe ofrimin e zgjidhjeve dhe opinioneve.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.





Temë e identifikuar nga:

- Kryetari i Gjykatës Komerciale
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerciale








## 11. Kontrata e Kredisë

Kontratat e kredisë kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçanta gjatë zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkojnë njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata. Për më tepër tregu financiar në Republikën e Kosovës në vazhdimësi ka pësuar ndryshime thelbësore çka ka pasuar edhe me ndryshim legjislativ në këtë fushë. Për të mundësuar përditësimin e njohurive të gjyqtarëve me ndryshimet legjislative dhe aplikimin e tyre në kontestet që paraqiten në gjykata, është i nevojshëm trajnimi i vazhdueshëm në këtë fushë.


### Objektivat

-  Avancimi i njohurive për ta trajtuar Kontratën e kredisë;
-  Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
-  Njohuri lidhur me përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon;
-  Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë.


### Përmbajtja

-  Kuptimi i kontratës së kredisë, elementet dhe specifikat e saj;
-  Klauzolat e posaçme lidhur me kamatat dhe llogaritjen e tyre;
-  Klauzolat e veçanta për kamatëvonesën dhe penalitetet;
-  Kthimi i parakohshëm i kredisë dhe pasojat juridike;
-  Mjetet e sigurimit të përmbushjes së kredisë – Pengu dhe Hipoteka;
-  Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
-  Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet e pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së dispozitave të veçanta kontraktuese.


### Metodologjia

-  Aplikimi i metodologjisë interaktive, trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore, të gjitha këto që të jepen përgjigje dilemave dhe paqartësive të cilat lindin në praktikën gjyqësore.

### Përfituesit

-  Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

### Kohëzgjatja

-  Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Raporti i vlerësimit të nevojave trajnues USAID/Drejtësia Komerçiale

## 12. Njohuritë Financiare

Trajnimi mbi njohuritë Financiare ofron njohuri praktike dhe teorike mbi financat dhe pasqyrat financiare të bizneseve, ku përmes tyre, pjesëmarrësit do të rrisin aftësinë dhe kompetencën financiare të tyre për aspektet financiare të çështjeve komerciale si dhe të përmirësojnë më tej aftësitë dhe ekspertizën duke u mundësuar atyre të hulumtojnë aspektet e ndërlikuara financiare me njohuri edhe më të mëdha.


### Objektivat

- 🎯 Avancimi i njohurive rreth analizës së deklaratave financiare;
- 🎯 Analizimi dhe interpretimi i dokumenteve që përbëjnë deklaratat financiare;
- 🎯 Identifikojnë shembuj praktikë të deklaratave financiare nga entet publike në Kosovë, duke i lejuar pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e tyre në skenarët e botës reale;
- 🎯 Njohin llojet e ndryshme të opinionëve të auditit dhe atë që secili nënkupton në kontekstin e raporteve financiare;
- 🎯 Avancimi i njohurive mbi treguesit kryesorë financiarë dhe implikimet e tyre;
- 🎯 Shqyrtojnë raste që përfshijnë mosmarrëveshje tatimore me ATK, duke shqyrtuar të ardhurat e humbura dhe duke dhënë një shembull konkret të të ardhurave të humbura në një procedim ligjor.


### Përmbajtja

- 📄 Konceptet themelore të raporteve financiare, elementet e pasqyrave financiare;
- 📄 Indikatorët kyç të performancës së bizneseve dhe çfarë tregojnë ata;
- 📄 Llojet e raporteve financiare dhe përdoruesit e tyre, korniza e raportimit;
- 📄 Akterët dhe rolet specifike të akterëve në raportimin financiar global dhe në Kosovë;
- 📄 Kontestet financiare mes operatorëve me impakt ekonomik/financiar;
- 📄 Llojet e dëmeve të cilat shkaktohen gjatë transaksioneve mes palëve;
- 📄 Koncepti i vlerës së parasë në kohë;
- 📄 Përdorimi i konceptit të zhvlerësimit të parasë gjatë kontesteve ekonomike;
- 📄 Ekspertiza financiare dhe ku do të mund të kontribuoj më së shumti;
- 📄 Çështjet tatimore dhe fiskale të bizneseve;
- 📄 Trendët e përgjithshme të kontesteve fiskale;
- 📄 Vështrime nga sektori privat mbi kontestet tatimore dhe fiskale.


## **Metodologjia**

 Gjatë trajnimit do të ketë interaktivitet dhe do të përfshihen shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj konkret, ku të gjithë pjesëmarrësit do të aktiv dhe do të përfshihen në diskutime dhe ushtrime.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerçiale.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA  
ADMINISTRATIVE***

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026;
- Trajnuesi i përhershme i AD-së

## 1. Ligji i ri për Konfliktet Administrative

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e dispozitave të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative<sup>6</sup> që do të hyj në fuqi në janar 2025. Gjithanshëm do të trajtohen dispozitat lidhur me:

- Parimet e përgjithshme të gjykimit në konfliktet administrative, organizimin, kompetencat dhe përbërjen në gjykim si dhe paditë;
- Procedurën gjyqësore në shkallë të parë - paraqitja e padisë; Përgatitja dhe shqyrtimi kryesorë; Rregullat për shqyrtimin dhe kontrollin gjyqësor; Procedura e gjykimit të padive për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ; dhe Vendimet;
- Rolin dhe rëndësinë e mjeteve juridike gjyqësore të zakonshme dhe ato të jashtëzakonshme;
- Sigurimi i padisë dhe i Kërkesë-padisë në konfliktin administrativ; Shpenzimet e procedurës; dhe Përmbarimi i vendimeve të Gjykatës.

Me Ligjin e ri për Konfliktet Administrative përcaktohet se juridiksionit gjyqësor administrativ i përkasin të gjitha konfliktet e të drejtës publike përveç atyre të natyrës kushtetuese në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Ky ligj ka për qëllim, të sigurojë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të subjekteve të së drejtës kundër veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të kryera gjatë ushtrimit të autoritetit publik si dhe ligjshmërinë në ushtrimin e këtij autoriteti. Në këtë trajnim do të shqyrtohen gjithanshëm dispozitat e ligjit të ri për konfliktet administrative lidhur me parimet e përgjithshme, organizimin, kompetencat dhe përbërjen në gjykim si dhe paditë.

Çështje që do të shtrohen dhe që kërkojnë përgjigje janë: Cilët janë parimet e përgjithshme të gjykimit në konfliktet administrative? Cfarë është organizimi, cilat janë kompetencat dhe përbërja në gjykim? Cilat janë synimet kryesore të këtij ligji lidhur me paditë në Kosovë? Gjithashtu në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje dhe që kërkojnë përgjigje si: cilat janë synimet e dispozitave ligjore lidhur me Procedurën gjyqësore në shkallë të parë - paraqitja e padisë; Ku qëndron rëndësia e përgatitjes së shqyrtimit kryesorë? Cili është roli i rregullave për shqyrtimin dhe kontrollin gjyqësor? Cila është rëndësia e dispozitave të posaçme për procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ; dhe cila është pesha e vendimeve dhe procedura e nxjerrjes së tyre? Po ashtu janë edhe këto çështje tjera që kërkojnë përgjigje në këtë trajnim: cili është roli i mjeteve juridike gjyqësore të zakonshme dhe të jashtëzakonshme në konfliktet administrative; cila është rëndësia e sigurimit të padisë dhe kërkesë-padisë në konfliktin administrativ; Cka përmbajnë dispozitat e reja ligjore mbi shpenzimet e procedurës në konfliktin administrativ; dhe si zhvillohet procedura e përmbarimit të vendimeve të Gjykatës. Në këtë trajnim, trajnuesitë përmes shpjegimeve do të interpretojnë dispozitat e Ligjit të ri për Konfliktet Administrative lidhur me temat e lartpërmendura. Çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përveq shpjegimeve edhe duke krahasuar zgjidhjet e reja ligjore me shtetet tjera në regjion si dhe duke elaboruar shembuj praktik





---

<sup>6</sup> Ligjin e ri - NR. 08/L-182 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE i cili është shpallur në GAZETEN ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 3/10 JANAR 2024.







hipotetik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit të ri për konfliktet administrative, punës në grupe dhe diskutimeve interaktive me pjesëmarrës.


## Objektivat

-  Të kuptojnë rolin e parimeve të përgjithshme të gjykimit të konflikteve administrative, organizimin, kompetencat dhe përbërjen në gjykim si dhe paditë;
-  Të avancojnë njohuritë për procedurën gjyqësore në shkallë të parë, shqyrtimin kryesorë si dhe rregullat për shqyrtimin gjyqësor; Procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ dhe Vendimet.
-  Të njihen me rolin dhe rëndësinë e mjeteve juridike gjyqësore të zakonshme dhe atyre të jashtëzakonshme.
-  Të zbatojnë drejte dispozitat ligjore në fuqi lidhur me sigurimin e padisë dhe Kërkesë-padisë në konfliktin administrativ; Shpenzimet e procedurës; dhe Përmbarrimin e vendimeve të Gjykatës.


## Përmbajtja

-  Parimet e përgjithshme të gjykimit në konfliktet administrative, organizimi, kompetencat dhe përbërja në gjykim si dhe paditë;
-  Procedura gjyqësore në shkallë të parë - paraqitja e padisë; Përgatitja dhe Shqyrtimi kryesor; Rregullat për shqyrtimin dhe kontrollin gjyqësor; Procedura e gjykimit të padive për shfuqizimin e Aktit nënligjor normativ; dhe Vendimet.
-  Mjetet juridike gjyqësore të zakonshme dhe atyre të jashtëzakonshme; dhe
-  Sigurimi i padisë dhe i Kërkesë-padisë në konfliktin administrativ; Shpenzimet e procedurës dhe Përmbarrimi i vendimeve të Gjykatës.


## Metodologjia

-  Çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të trajnuesve, duke krahasuar zgjidhjet edhe me shtetet në regjion si dhe duke u bazuar në shembuj konkret, diskutime interaktive dhe shembuj praktik hipotetik dhe punë në grupe me pjesëmarrës.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026;
- Trajnuesi i përhershme i AD-së

## **2. Tryezë e rrumbullakët për Harmonizimin e Praktikës gjyqësore në Konfliktin Administrativ**




Kjo tryezë e diskutimeve ka për qëllim kryesor shqyrtimin e çështjeve aktuale që po paraqiten në lidhje me konfliktet administrative. Fokusi në këtë tryezë do të jetë edhe në trajtimin e çështjeve aktuale nga praktika gjyqësore dhe harmonizimi i kësaj praktike në mes të gjyqtarëve të departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Tryeza do të zhvillohet edhe në kontekstin e dispozitave të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative që do të hyj në fuqi në janar 2025, vecmas ato që sigurojnë mbrojtjen e plotë gjyqësore ndaj çdo forme të mundshme të veprimtarisë administrative; procedura gjyqësore efektive më të thjeshta dhe më të përshtatshme, si dhe rolë shumë më aktiv të gjyqtarit administrativ. Në këtë tryezë do të trajtohen çështjet aktuale nga praktika gjyqësore e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Fokusi do të jetë edhe në harmonizimin e praktikës gjyqësore në mes këtyre tre instancave gjyqësore kur vendosin lëndë nga lëmia e gjyqësisë administrative. Në këtë tryezë pjesëmarrësit do të kenë mundësin që përmes shpjegimit të panelistëve të përzgjedhur dhe bashkëbisedimit të këmbëjnë përvoja në mes vete lidhur me çështjet e ndryshme aktuale nga praktika gjyqësore e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Fokusi i trajnuesve do të jetë edhe në shpjegimin e risive të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative.

### **Objektivat**


- 🎯 Të evitohen dilemat që janë paraqitur në praktikën gjyqësore të departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- 🎯 Të sqarohen dhe evitohen dilemat që janë paraqitur në praktikën gjyqësore të departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit.
- 🎯 Të njihen pjesërisht me risitë kryesore të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative që do të hyj në fuqi në janar 2025,
- 🎯 Të njihen me praktiken gjyqësore aktuale të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe qëndrimet parimore të saj.
- 🎯 Të harmonizohet dhe unifikohet praktika gjyqësore e këtyre tre instancave gjyqësore.

### **Përmbajtja**


- 📄 Mbrojtja e plotë gjyqësore ndaj çdo forme të mundshme të veprimtarisë administrative;
- 📄 Procedura gjyqësore efektive;
- 📄 Roli aktiv i gjyqtarit administrativ;

-  Faktet e reja dhe dëshmitë e reja në konfliktin administrativ;
-  Seanca publike në konfliktin administrativ;
-  Procedurat sipas mjeteve juridike me praktikën aktuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.


## **Metodologjia**

 Në këtë tryezë pyetjet e ngritura dhe dilemat gjatë tryezës do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm të panelistëve të përzgjedhur, duke pas në fokus ato çështje që janë paraqitur në praktikë. Përveq shpjegimeve dhe diskutimeve do të nxjerrën edhe rekomandime lidhur me çështjet e ngritura në tryezë. Tryeza do të jetë e koncipuar në atë mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit përmes diskutimeve të tyre të mund të kontribuojnë në suksesin e saj.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe të Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës.

## **Kohëzgjatja**

 Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026

### 3. Veçoritë e Konfliktit të Jurisdiksionit të Plotë dhe Ekspertiza në Konfliktin Administrativ

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e rolit dhe shpjegimin e veqorive të konfliktit të jurisdiksionit të plotë dhe ekspertizës në konfliktin administrativ. Gjithashtu ky institut juridik do të trajtohet në kontekstine e dispozitave të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative (janar 2025). Ndryshimet ndërmjet konfliktit për ligjshmëri dhe konfliktit të jurisdiksionit të plotë në teorinë juridike gjenden kryesisht në qëllimet e këtyre konflikteve, në kompetencat që kanë gjykatat gjatë zhvillimit të tyre dhe në mënyrën në të cilën parashikohet zhvillimi i tyre. Në trajnim vecmas duhet shpjeguar se konfliktit për ligjshmëri dhe konfliktit të jurisdiksionit të plotë dallohen edhe për nga autorizimet me të cilat disponon gjykata në secilën nga këto lloje të konflikteve. Dallimet në mes konfliktit për ligjshmëri dhe konfliktit të jurisdiksionit të plotë vërehen edhe në mënyrën se si është parashikuar obligimi i gjykatës për zhvillimin e këtyre konflikteve.


Në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje dhe që kërkojnë përgjigje si: Cilat janë synimet e dispozitave ligjore lidhur me konfliktin e jurisdiksionit të plotë; Ku qëndron rëndësia e këtij instituti juridik; Cfarë thotë praktika e deritashme gjyqësore? Cila është pesha e vendimeve në konfliktet e jurisdiksionit të plotë? Kur Gjykata e shkallës së dytë, mund të prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe, të zgjidh vetë çështjen duke ndryshuar apo zëvendësuar aktgjykimin e goditur dhe a mundet të ndryshoj Gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të palës ankuese dhe kur? Në këtë trajnim trajnuesitë përmes shpjegimeve do të interpretojnë dispozitat e Ligjit të ri për Konfliktet Administrative lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen duke shpjeguar dhe krahasuar zgjidhjet e reja ligjore me shtetet në regjion si dhe duke elaboruar shembuj praktik dhe hipotetik mbi konfliktet e jurisdiksionit të plotë? Po ashtu përmes bashkëbisedimit pjesëmarrësit do të këmbëjnë përvoja në mes vete lidhur me çështjet e ndryshme aktuale nga praktika gjyqësore e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit.

#### Objektivat


- 🎯 Avancimi i njohurive për rolin e jurisdiksionit të plotë në konfliktin administrativ;
- 🎯 Avancimi i njohurive për rolin dhe rëndësin e ekspertizës në konfliktin administrativ;
- 🎯 Të dallojnë konfliktin për ligjshmëri dhe konfliktin për juridiksion të plotë;
- 🎯 Të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore në fuqi lidhur me konfliktin e jurisdiksionit të plotë dhe ekspertizën në konfliktin administrativ.

#### Përmbajtja


- 📄 Veçoritë e jurisdiksionit të plotë në konfliktin administrativ;
- 📄 Roli dhe rëndësia e ekspertizës në konfliktin administrativ;
- 📄 Dallimet ndërmjet konfliktit për ligjshmëri dhe konfliktit të jurisdiksionit të plotë;
- 📄 Kur Gjykata e shkallës së dytë, mund të prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe, të zgjidh vetë çështjen duke ndryshuar apo zëvendësuar aktgjykimin e goditur;

 Zbatimi i drejtë i dispozitive ligjore në fuqi lidhur me konfliktin të juridiksionit të plotë dhe ekspertizën në konfliktin administrativ.


### **Metodologjia**

 Në këtë trajnim përmes shpjegimeve do të trajtohen dispozitat e Ligjit të ri për Konfliktet Administrative lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura do të adresohen përmes shpjegimit duke krahasuar zgjidhjet edhe me shtetet në regjion si dhe duke u bazuar në raste dhe shembuj praktik konkret. Gjithashtu tematika e përmendur do të trajtohet përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik hipotetik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit të ri për konfliktet administrative dhe punës në grupe me pjesëmarrës.

### **Përfituesit**

 Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

### **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Trajnuesi i përhershme i AD-së

#### 4. Kontestet e punës - Ligji për Nëpunësit Civil





Qëllimi i këtij trajnimi do të jetë avancimi i njohurive të gjyqtarëve për procedurën që zhvillohet dhe mbrojtjen gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës me përqendrim tek nëpunësit-shërbyesit civil të Republikës së Kosovës. Fokusi do jetë në procedurën – kontestet që zhvillohen me rastin e cenimit të drejtave të nëpunësve-shërbyesve civil si në KPMK dhe në Gjykatën Themelore Prishtinë ku edhe janë paraqitur paqartësi. Ka vështirësi në zbatimin e vendimeve të Këshillit, përmbarimin e vendimeve nga gjykatat, zbatimin e standardeve kushtetuese për të drejtën në punë dhe zbatimin e garancioneve të KEDNJ-së. Gjithashtu do të trajtohen çështjet që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Nëpunësit Civil, institucionet dhe njësitë e përfshira në mbrojtjen gjyqësore nga marrëdhënia e punës si dhe procedurën dhe afatet e ankimit administrativ. Do të trajtohet edhe inicimi i konfliktit administrativ ndaj vendimit të KPMK-së, mbrojtja gjyqësore e të drejtave të punës për nëpunësit-shërbyesit civil, kompetenca, afatet dhe mjetet juridike etj. Gjithashtu synimi i këtij trajnimi është ndikimi në vlersimin efektiv të kërkesave, si në procedurën administrative ashtu edhe në procedurën gjyqësore. Po ashtu intencë është edhe zbatimi i parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme në këto raste. Sfiduese në zgjidhjen e disa prej këtyre rasteve është edhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese me të cilin ajo ka ndaluar për një afatë të caktuar aplikimin e dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, andaj ka nevojë për një trajtim të gjithanshëm.

Në këtë trajnim do të shqyrtohen gjithanshëm dispozitat e ligjit për zyrtarët publik lidhur me zbatimin e drejtë të tyre për nëpunësit-shërbyesit civil. Pastaj do të trajtohet procedura ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij dhe përmbarimi i vendimeve të tij. Gjithashtu në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje dhe që kërkojnë përgjigje si: Cilat janë të drejtat e nëpunësve civil? Cilët janë kategoritë e nëpunësve që gjykohen në procedurën e konfliktit administrativ e cilatë kategori në procedurën kontestimore? Cila është rëndësia e dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik për procedurën e gjykimit lidhur me këto kategori dhe cila është pesha e vendimeve dhe procedura e nxjerrjes së tyre? Në këtë trajnim, trajnuesitë përmes shpjegimeve do të interpretojnë dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik lidhur me temat e lartpërmendura. Çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përqendrimisht duke interpretuar zgjidhjet ligjore si dhe duke elaboruar shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit të përmendur dhe legjislacionit tjetër në fuqi, dhe diskutimeve interaktive me pjesëmarrës.


#### Objektivat

- 🎯 Të njihen me të drejtat e nëpunësve sipas Ligjit për Zyrtarët Publik;
- 🎯 Të dallojnë kategoritë e nëpunësve që gjykohen në procedurën e konfliktit administrativ dhe ato kategori që gjykohen në procedurën kontestimore?
- 🎯 Të zërthejnë procedurën ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij;
- 🎯 Të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore për nëpunësit-shërbyesit civil.


## Përmbajtja

-  Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore për nëpunësit-shërbyesit civil;
-  Dallimi në mes kategoritve të nëpunësve që gjykohen në procedurën e konfliktit administrativ dhe atyre kategorive që gjykohen në procedurën kontestimore.
-  Procedura ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij;
-  Raste nga praktika gjyqësore lidhur me procedurën në çështjet që lidhen me nëpunësit civil.


## Metodologjia

-  Metodot kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi janë: ligjërime të përgjithshme, diskutime interaktive dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Trajnimi do të jetë i strukturuar në mënyrë që koha më e madhe t'iu lihet debateve dhe diskutimeve me pjesëmarrësit. Në trajnim do të elaborohen parimet dhe rregullat kryesore të së drejtës-marrëdhënies së punës për nëpunësit civil sipas Ligjit për Zyrarët Publik dhe mënyratë për të sjell vendime të bazuara në merita.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional në këto gjykata dhe zyrarët e KPMK-së.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Trajnuesi i përhershme i AD-së
- UNHCR dhe Programi për të Drejtat Civile në Kosovë /CRPK

## **5. Praktika gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatëve**

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve në lënmin e shqyrtimit të rasteve për mbrojtje ndërkombëtare në mënyrë objektive e të paanshme dhe në zbatimin e kritereve të njëjta ligjore e standarde të përbashkëta ndërkombëtare në momentin e përcaktimit se kush plotëson kushtet për mbrojtje ndërkombëtare. Gjithashtu synim tjetër është avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit për Azilin i Kosovës, raportin e këtij ligji me Konventën ndërkombëtare për azilin dhe zbatimin e efikas të tyre me rastin e vendosjes për azilin. Nga ky trajnim njohuritë që do të marrin pjesëmarrësit, do të ndikojnë pozitivisht në vlerësimin e kërkesave të azilkërkuesve si në procedurën administrative ashtu edhe në procedurën gjyqësore, dhe do të mundësojnë gjykimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme lidhur me këto raste si dhe njohuri efektive lidhur me mbledhjen e informacioneve nga raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe vendi i origjinës gjatë procedimit të rasteve.





Ky trajnim do të fokusohet në ofrimin e përgjigjeve lidhur me legjislacionit ndërkombëtar dhe dispozitat e Ligjit për Azilin i Kosovës duke u fokusuar në çështjet dhe dilemat që ndërlihen me statusin dhe qëndrimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, në procedurën ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit nacional si dhe zbatimin e drejtë të tyre nga organet kompetente të Republikës së Kosovës. Poashtu do të bëhet edhe shqyrtimi i praktikës gjyqësore të deritanishme lidhur me vendimet gjyqësore mbi paditë për njohjen e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare si dhe krahasimi me rastet e Gjykatës së Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në bazë të disa statistikave deri në fund të vitit 2023, miliona individë u zhvendosën me forcë në mbarë botën si rezultat i persekutimit, konflikteve të armatosura, dhunes apo shkeljeve të të drejtave të njeriut. Për çdo vit numri i të zhvendosurve është në rritje për shkaqet e lartpërmendura.

Në këtë trajnim dilemat dhe pyetjet do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, pastaj trajtimit të rasteve dhe shembujve konkret. Do të përdoren edhe diskutime dhe shembuj praktik të bazuar në legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtarë nga fusha e Azilit/Mbrojtjes Ndërkombëtare. Në këtë trajnim të gjitha dilemat dhe çështjet tematike do të shpjegohen edhe përmes shembujve nga praktika administrative dhe gjyqësore vendore, e rajonit dhe ajo e ndërkombëtare.






Gjithashtu krahas angazhimit të pjesëmarrësve do të trajtohen edhe rastet praktike që janë vendosur në gjykatë. Po ashtu përmes bashkëbisedimit pjesëmarrësit do të këmbëjnë përvoja në mes vete lidhur me çështjet e ndryshme aktuale nga praktika gjyqësore e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit.




## Objektivat

-  Të njohin dhe promovojnë parimet dhe politikat në lidhje me mbrojtjen e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare;
-  Të avancojnë njohuritë e tyre në zbatimin parimeve të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve gjegjësisht me parimet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Refugjatëve e vitit 1951 dhe Protokollit të Saj të vitit 1967;
-  Të njohin rolin e legjislacionit vendor dhe identifikojnë karakteristikat e Ligjit për Azilin të Kosovës
-  Të zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Azilin të Kosovës dhe legjislacionit sekondar me rastin e vendosjes në çështjet për azilin.


## Përmbajtja

-  Roli dhe rëndësia e parimeve dhe politikave në lidhje me mbrojtjen e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare;
-  Zbatimi i parimeve të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve gjegjësisht - parimet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Refugjatëve e vitit 1951 dhe Protokollit të Saj të vitit 1967;
-  Roli i legjislacionit vendor dhe karakteristikat e Ligjit për Azilin të Kosovës;
-  Zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Azilin të Kosovës dhe legjislacionit sekondar me rastin e vendosjes në çështjet për azilin;
-  Raste nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë.


## Metodologjia

-  Metodologjia do të përfshijë shpjegime teorike dhe diskutime të hapura ashtu që konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra do të ndahen me të gjithë pjesëmarrësit për dhe në dobi të punës së tyre praktike. Dilemat dhe çështjet e ngritura do të adresohen edhe përmes diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtarë nga fusha e mbrojtjes ndërkombëtare për refugjatë, puna në grupe dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit dhe zyrtarë të Komisionit Kombëtar për Refugjatë dhe Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim – MPB dhe institucioneve tjera.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- UNHCR dhe Programi për të Drejtat Civile në Kosovë /CRPK






## **6. Praktika gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e shtetësisë dhe rreziku nga pashtetësia**

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve mbi çështjet aktuale të pashtetësisë në vend dhe zhvillimet aktuale në doktrinën ligjore ndërkombëtare si dhe shembuj të praktikave të mira dhe zgjidhjet e mundshme. Në këtë trajnim, përveç krahasimit të praktikave të vendit, me ato në rajon dhe Evropë do të shqyrtohen edhe sfidat objektive dhe subjektive në shqyrtimin e padive në procedurën e konfliktit administrativ, roli i punës cilësore të organeve administrative në dy instanca si dhe organeve gjyqësore në parandalimin e pashtetësisë. Çdo vit, dhjetëra mijëra fëmijë lindin pa shtetësi sepse prindërit e tyre janë pa shtetësi. Pashtetësia mund të ndodhë si rezultat i diskriminimit dhe privimit arbitrar të shtetësisë, situatat e ecurisë anormale të shtetit, praktikat e papërshtatëshme të regjistrimit civil, probleme në marrjen e dokumenteve që vërtetojnë shtetësinë dhe mangësi të tjera në ligjet e shtetësisë. Në Gjykatën Themelore në Prishtinë - në departamentin për çështje administrative janë identifikuar dilema dhe paqartësi ligjore rreth mënyrës së fitimit, humbjes dhe rifitimit e shtetësisë. Gjithashtu trajnimi do të fokusohet në praktikat krahasuese lidhur me të drejtën e shtetësisë duke nxjerrë në pah praktikat pozitive dhe negative në disa shtete në regjion dhe Evropë si dhe duke i krahasuar ato me praktikat në vend. Njohja me këto praktika do të ju mundësoj gjyqtarëve njohuri të reja dhe bashkëpjesmarrje në kauzën globale në parandalimin dhe zvogëlimin e pashtetësisë. Gjithashtu ky trajnim do të ndikoj pozitivisht tek pjesëmarrësit në vlerësimin e kërkesave të personave me shtetësi dhe të atyre pa shtetësi, si në procedurën administrative ashtu edhe në procedurën gjyqësore dhe do të mundësoj gjykimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme lidhur me këto raste si dhe njohuri efektive lidhur me vendosjen meritore nga gjykatat.






Disa prej çështjeve që do të shtrohen e që kërkojnë përgjigje në këtë trajnim janë: cilat janë dilemat që po shfaqen lidhur me shtetësinë dhe mënyrat e fitimit dhe humbjes së saj në Kosovë? Cilat janë problemet kryesore në zbatimin e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës? Gjithashtu me rëndësi është kuptimi dhe respektimi i sakt i afateve ligjore, fitimit dhe humbjes së shtetësisë. Po ashtu në praktikë në Republikën e Kosovës ka probleme dhe paqartësi ligjore dhe çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e që kanë nevojë dhe do të trajtohen në detale. Për këto probleme dhe procedura ka nevojë që të trajtohen në mënyrë të gjithanshme përmes shpjegimit të dispozitave ligjore, mënyrave të fitimit të shtetësisë, zbatimit të drejtë të procedurave për humbjen e shtetësisë dhe afatet për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave.

Në këtë trajnim të gjitha çështjet tematike do të trajtohen përmes shpjegimeve teorike, shembujve nga praktika gjyqësore, gjithashtu edhe me angazhimin e pjesëmarrësve përmes rasteve praktike që janë vendosur në gjykatë dhe atyre hipotetike. Gjithashtu përmes bashkëbisedimit pjesëmarrësit do të këmbëjnë përvoja në mes vete lidhur me çështjet e ndryshme aktuale nga praktika gjyqësore e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit. Po ashtu do të trajtohen edhe raste nga procedurat administrative dhe procedurat gjyqësore të aplikueshme në vendet e rajonit dhe ato evropiane e që do të u ndihmojnë gjyqtarëve në shqyrtimin efikas dhe praktik të kërkesave që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekt me të drejtat e shtetësisë.


## Objektivat

-  Të njihen me parimet dhe politikat në lidhje me mbrojtjen e personave të pa shtetësi;
-  Të avancojnë njohuritë e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave pa shtetësi.
-  Të njihen me çështjet aktuale të pashtetësisë në Kosovë;
-  Të zbërthejnë mënyrat fitimit të shtetësisë sipas LSHK;
-  Të interpretojnë dhe zbatojnë drejtë dispozitat e LSHK me rastin e vendosjes në çështjet për shtetësinë.


## Përmbajtja

-  Çështjet aktuale të pashtetësisë dhe zhvillimet në doktrinën ligjore ndërkombëtare;
-  Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi për shtetësinë në Republikën e Kosovës;
-  Mënyrat e fitimit të shtetësisë;
-  Mënyrat e humbjes së shtetësisë;
-  Raste nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë.


## Metodologjia

-  Në këtë trajnim pyetjet e ngritura dhe dilemat gjatë tryezës do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik dhe shembujve praktik duke pas në fokus ato çështje që janë paraqitur në praktikë. Trajnimi do të jetë i koncipuar në atë mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit përmes diskutimeve të tyre të mund të kontribuojnë në suksesin e tij.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit dhe bashkpunëtorët profesiona/zyrtarët ligjor në këto gjykata, zyrtarë të Komisionit Kombëtar për Refugjatë dhe Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim - MPB dhe institucioneve tjera.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- UNHCR dhe Programi për të Drejtat Civile në Kosovë /CRPK

## **7. Tryezë mbi sfidat në vendosjen meritorë të aplikuesve për mbrotje ndërkombëtare dhe shtetësi**








Në këtë tryezë do të diskutohet hapur për sfidat në vendosje në nivelet administrative, përfshirë instancën e parë dhe të dytë nga komisionet përkatëse kombëtare si dhe në nivelet gjyqësore. Pastaj do të diskutohet për mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike përgjatë gjithë procedurës, vështirësitë dhe tejkalimi i tyre. Po ashtu fokusi i tryezës do të jetë në identifikimin e mënyrës për tejkalimin e sfidave si dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të institucioneve relevante përgjatë gjithë procedurës në të gjitha nivelet. Pastaj për nevojat specifike për mbështetje në ngritjen e cilësisë së vendimmarrjes, dhe nxjerrjes së rekomandimeve përfundimtare. Trajnimet janë zhvilluar dhe organizuar kryesisht për të përfituar gjyqtarët, të cilët si vendimmarrës në Kosovë e që për momentin kanë pak raste, dhe mungon përvoja, por duke parë trendët botërore të numrit të të zhvendosurve nga shtetëpitë e tyre, shumë shpejt edhe Kosova mund të përballë me numër më të madh të refugjatëve se sa ka sot aktualisht. Andaj është e nevojshme që në vazhdimësi të organizohen trajnime të fokusuar në lëmin e të drejtave të refugjateve, në mënyre që kapacitetet vendore të të gjithë vendimmarrësve të jenë në nivelin e duhur për t'u përballur me sfidat e mundshme në këtë lëmi.

Në këtë tryezë dilemat dhe pyetjet do të adresohen përmes shpjegimit të pjesëshëm teorik dhe përgjigjeve të panelistëve, duke u bazuar në dispozita ligjore nacionale dhe konventore - ndërkombëtare si dhe në raste dhe shembuj konkret nga fusha e Azilit/Mbrojtjes Ndërkombëtare. Njohuritë që do të marrin pjesëmarrësitë, do të ndikojnë pozitivisht në vlerësimin e kërkesave të personave në nevojë të mbrojtjes ndërkombëtare dhe të atyre pashtetësi, si në procedurën administrative ashtu edhe në procedurën gjyqësore dhe do të u mundësojnë gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme të rasteve si dhe njohuri efektive lidhur me vendosjen meritorë nga gjykata. Gjithashtu përforcimi i bashkëpunimit në mes akterëve që vendosin lidhur me këto lëndë pritet të ndikojë pozitivisht në fuqizimin e cilësisë së vendimmarrjes në të gjitha instancat.


### **Objektivat**

- 🎯 Të kuptojnë dhe promovojnë parimet dhe politikën në lidhje me mbrojtjen e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare;
- 🎯 Të thellojnë aftësitë e tyre në zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve;
- 🎯 Të promovojnë parimet dhe politikën në lidhje me mbrojtjen e personave të pa shtetësi për mbrojtje ndërkombëtare gjegjësisht me parimet e Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventës së vitit 1961 mbi Zvogëlimin e pa-shtetësisë;
- 🎯 Të avancojnë aftësitë e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave pa-shtetësi.


## Përmbajtja

-  Parimet dhe politikat në lidhje me mbrojtjen e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare;
-  Zbatimi i legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve gjegjësisht me parimet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Refugjatëve e vitit 1951 dhe Protokollit të Saj të vitit 1967;
-  Promovimi i parimeve dhe politikave në lidhje me mbrojtjen e personave të pa shtetësi për mbrojtje ndërkombëtare gjegjësisht me parimet e Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventës së vitit 1961 mbi zvogëlimin e pa-shtetësisë;
-  Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave pa shtetësi.
-  C'farë rëndësie paraqet kompletimi i dosjeve të rasteve, përfshirë këtu edhe informatat mbi vendin e origjinës (IVO) të cilat janë përdorur si prova materiale në vendimmarje në instancat administrative;
-  Pësja dhe rëndësia e referimit, për raste të ngjashme, nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në fushën e azilit.
-  Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndër-institucional gjatë procesit të vendimmarjes së rasteve në përfundimin e rasteve në nivel gjyqësor.


## Metodologjia

-  Në këtë tryezë çështjet e ngritura do të adresohen përmes shpjegimeve të pjesshme të panelistëve të përzgjedhur, duke ofruar një platforme të hapur për diskutime për të gjithë pjesëmarrësit mbi gjendjen aktuale rreth vendosjes meritorë ndaj aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe shtetësi në të gjitha instancat. Gjithashtu teamatika e tryezës do të trajtohet përmes bashkëbisedimit, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtarë nga fusha e mbrojtjes ndërkombëtare.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit, bashkpunëtorë profesional/zyrtarë ligjor, zyrtarë të Komisionit Kombëtar për Refugjatë, zyrtarë të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim-MPB, zyrtarë të Agjencionit për Ndihmë Juridike Falas, zyrtarë të Odës së Avokatëve.

## Kohëzgjatja

-  Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA  
KUSHTETUESE***

Temë e identifikuar nga:







- Trajnuesi i përhershëm i AD-së

## **1. Cështje aktuale në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave nga lëmia penale**






Ky trajnim ka për qëllim kryesor njohjen me praktikën aktuale të kësaj gjykate sipas kërkesave në lëmin penale. Gjithashtu synim tjetër është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me vendimet kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me standaret që zbaton në praktikë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Në këtë trajnim do të trajtohet edhe raporti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese dhe roli i kontrollit incidental të kushtetutshmërisë. Gjithashtu do të analizohet kjo praktikë në kontekst të zhvillimeve aktuale legjislative dhe praktikës gjyqësore si dhe do të elaborohen kërkesat e dispozitësë nenit 6 të KEDNJ dhe kriteret që ka vënë GJEDNJ lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë në aspektin penal (kuadri i të drejtës në gjykim të drejtë dhe parimet konventore). Gjithashtu pjesëmarrësitë do të njihen me parimet e barazisë së palëve në procedurë, kohëzgjatja e procedurës penale, e drejta në mbrojtje, prezumimi i pafajësisë si dhe do të mësojnë të përdorin drejtë praktikën e GJEDNJ vecmas në rastet penale kur ajo ka konstatu shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Në këtë trajnim do të shtrohen cështje dhe pyetje që kërkojnë përgjigje si: Cilat janë synimet e dispozitave kushtetuese lidhur me raportin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese. Cilat janë cështjet kryesore juridike të ngritur para kësaj gjykate sipas kërkesave në lëmin penale; Cilat janë qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me aspektet përmbajtësore dhe procedurale të të drejtave dhe lirive individuale të njeriut në kontekst me praktikën e GJEDNJ. Cilat janë arsytet që Gjykata Kushtetuese e Kosovës, mbështetet në jurisprudencën e GJEDNJ, dhe cilat janë dobitë që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të interpretohen në harmoni me vendimet e GJEDNJ. Gjithashtu do të trajtohet edhe instituti i kontrollit incidental të kushtetutshmërisë. Në këtë trajnim trajnuesitë përmes shpjegimeve do të interpretojnë dispozitat e Kushtetutës së Kosovës lidhur me tematikën e lartpërmendur. Cështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes rasteve kryesore që ka patur Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe GJEDNJ. Pastaj do të ofrohen udhëzime dhe rekomandime për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me dispozita kushtetuese, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe atë të GJEDNJ, pastaj do të analizohet mbrojtja gjyqësore e të drejtave kushtetuese në Republikën e Kosovës, duke u krahasuar me mbrojtjeve që ofron GJEDNJ duke veequar standartet e interpretimit që përdorë ajo kur vendos për këto të drejta themelore. Gjithashtu trajnuesit do të kenë në fokus shpjegimin e raportit midis Gjykatës Kushtetuese dhe atyre të rregullta, veçmas marrëdhënies midis gjykatave kushtetuese dhe atyre të larta. Vëmendje do t'i kushtohet edhe kontrollit incidental të kushtetutshmërisë në kontekst të zhvillimeve të praktikës aktuale gjyqësore. Po ashtu përmes bashkëbisedimit pjesëmarrësit do të këmbëjnë përvoja në mes vete lidhur me cështjet e ndryshme aktuale nga praktika gjyqësore.


## Objektivat

-  Të kuptojnë raportin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese.
-  Të njihen me praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëmin penale, duke veqar çështjet kryesore juridike të ngritur para kësaj gjykate;
-  Të kuptojnë esencën e dispozitave të nenit 6 të KEDNJ dhe të zbatojnë drejtë këto si dhe kriteret që ka vënë GJEDNJ lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë në aspektin penal;
-  Të përdorin drejtë praktiken e GJEDNJ në rastet penale në të cilat kjo gjykatë ka konstatua shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.
-  Gjithashtu të kuptojnë arsyet se pse Gjykata Kushtetuese e Kosovës, mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe cilat janë dobitë.
-  Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e Kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

## Përmbajtja

-  Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese;
-  Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëmin penale, duke veqar çështjet kryesore juridike të ngritur para kësaj gjykate;
-  Qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me aspektet përmbajtësore dhe procedurale të të drejtave dhe lirive individuale, në lidhmëri me praktikën e GJEDNJ dhe veçoritë e praktikave të këtyre dy gjykatave lidhur me mbrojtjen gjyqësorë të të drejtave të njeriut;
-  Arsyet se pse Gjykata Kushtetuese e Kosovës, mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pse të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të interpretohen në harmoni me vendimet e GJEDNJ;
-  Roli dhe rëndësia e institutit të kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.


## Metodologjia

-  Në trajnim pjesëmarrësit do të kenë mundësin që përmes bashkëbisedimit interaktiv dhe shpjegimeve të trajnuesve të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me çështjet kryesore nga praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëmin penale, Gjithashtu pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri të reja mbi vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në raport me praktikën e GJEDNJ lëmin penale.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.



## ***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR KEDNJ***

Temë e identifikuar nga:

- Raporti i BE-së për Kosovën
- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit
- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Trajnuesi i përhershëm i AD-së

## 1. Liria e Shprehjes

Liria e shprehjes është një e drejtë themelore që mbështet shkëmbimin e lirë të ideve dhe nxit shoqëritë demokratike, por gjithashtu kërkon mbrojtje nga ndërhyrjet e pajustificuara. Qëllimi i këtij aktiviteti është të mbledhë një numër të konsiderueshëm profesionistësh ligjorë në fushën e lirisë së shprehjes, duke përfshirë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë, për të krijuar një platformë të qëndrueshme për shkëmbimin e ideve dhe perspektivave të ndryshme. Trajnimi synon të zhvillojë një platformë për shkëmbimin e informacionit dhe njohurive ndërmjet profesionistëve ligjorë mbi kornizën ligjore ekzistuese dhe jurisprudencën në Kosovë, në raport me standardet evropiane dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në fushën e lirisë së shprehjes dhe mediave.

Diskutimi do të përqendrohet në sfidat që paraqesin paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) për profesionistët ligjorë, duke theksuar nevojën për qasje të reja dhe strategji ligjore. Ky shkëmbim do të kontribuojë në materializimin e idesë për krijimin e kësaj platforme përmes diskutimit dhe rrjetëzimit ndërmjet palëve të interesuara.




SLAPP (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike) paraqesin një sfidë të re për profesionistët ligjorë, duke kërkuar një fokus të ri në kuptimin dhe strategjinë ligjore. Paditë SLAPP janë padi që prima facie vërehen se nuk janë të bazuara në fakte dhe se do të jenë të pasuksesshme në gjykatë. Përmes tyre, paditësi nuk synon të fitojë rastin, por ka për qëllim që të frikësojë dhe dekurajojë gazetarët nga raportimi i mëtejshëm i çështjeve me interes publik duke i detyruar ata të kalojnë nëpër procese të gjata dhe të kushtueshme gjyqësore.

Për gjyqtarët dhe prokurorët, rritja e SLAPP-ve kërkon një ndërgjegjësim të shtuar dhe një qasje aktive në trajtimin e tyre. Është thelbësore që këto padi të identifikohen herët, të kuptohen natyra e tyre shpeshherë kërcënuese dhe të zbatohen parimet ligjore që balancojnë të drejtën e procesit gjyqësor me mbrojtjen e pjesëmarrjes publike dhe shprehjes së lirë.


### Objektivat

- 🎯 Të rritet ndërgjegjësimi ndërmjet profesionistëve ligjorë për sfidat që paraqesin çështjet e lirisë së shprehjes në zbatimin praktik, me theks të veçantë në paditë SLAPP dhe ndikimin e tyre në lirinë e shprehjes dhe pjesëmarrjen publike.
- 🎯 Avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në implementimin efikas të standardeve vendore dhe ndërkombëtare, me theks të veçantë në jurisprudencën e GJEDNJ-së.
- 🎯 Të nxitet një platformë diskutimi për shkëmbimin e ideve dhe përvojave ndërmjet profesionistëve ligjorë gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe bashkëpunëtorëve profesional.


## **Përmbajtja**

-  Analizë e Kornizës Ligjore lidhur me lirinë e shprehjes në përgjithësi: Diskutimi mbi kornizën ligjore ekzistuese në Kosovë dhe krahasimi me standardet evropiane.
-  Ndikimi i instrumenteve ndërkombëtare, përfshirë Rekomandimet e Këshillit të Evropës për paditë SLAPP dhe Direktiva e BE-së për luftimin e padive SLAPP dhe mundësitë e përdorimit të tyre në praktikë.
-  SLAPP dhe Liria e Shprehjes: Diskutimi lidhur mbi identifikimin natyrën dhe qëllimin e SLAPP padive, dhe rreziqet që ato paraqesin për lirinë e shprehjes.


## **Metodologjia**

-  Prezantime nga ekspertë ligjorë mbi temën e SLAPP-ve dhe jurisprudencën përkatëse. Sesione diskutimi interaktive ku pjesëmarrësit do të ndajnë përvoja dhe ide për trajtimin e SLAPP-ve. Analizë e rasteve konkrete të SLAPP-ve në Kosovë dhe në nivel evropian.

## **Përfituesit**

-  Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Trajnuesi i përhershëm i AD-se

## **2. Procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas Nenit 6 të KEDNJ: Zgjatja e paarsyeshme e procedurave civile dhe penale në jurisprudencën e GJEDNJ**





Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duke përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) janë drejtpërdrejt të zbatueshme në sistemin juridik dhe kanë përparësi në interpretim ndaj legjislacionit kombëtar. Më tej, neni 53 i Kushtetutës thotë se të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. E drejta për gjykim të drejtë mbrohet sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Në këtë aspekt, Akademia e Drejtësisë e konsideron të rëndësishme zhvillimin e trajnimeve për profesionistët ligjor (gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional) mbi standardet e përcaktuara të KEDNJ dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), referuar Nenit 6 për të Drejtën për një proces të rregullt. Trajnimi do të ofrojë një platformë për të zhvilluar njohuritë rreth praktikës gjyqësore mbi nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe diskutimit për mënyrat e zbatimit të saj në praktikën gjyqësore. Trajnimi do të fokusohet në veçanti në ofrimin e shembujve nga jurisprudenca e GJEDNJ-së për çështjet e eliminimit të zgjatjes së procedurave dhe anulimit të paarsyeshëm të vendimeve, si komponentë kyçe e Nenit 6 të KEDNJ. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që të ketë trajtim më të detajuar në zbatimin e rasteve të GJEDNJ dhe standardeve të KE, duke ofruar pikëpamje të avancuara për eliminimin e defekteve procedurale në praktikën gjyqësore në Kosovë si: tej zgjatja e procedurave gjyqësore dhe anulimi i paarsyeshëm i çështjeve. Praktika e zhvilluar nga GJEDNJ dhe qasja në referencat e jurisprudencës në rastet që i referohen Nenit 6 të KEDNJ do të shërbejë si burim i vlefshëm për praktikuesit në gjyqësorin e Kosovës në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtat procedurale dhe procesin e rregullt ligjor, deri në arsyetimin cilësor të vendimeve.

Trajnimi synon që profesionistët ligjor (gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorët profesional) të jenë në gjendje të përdorin në praktikë rastet e GJEDNJ në interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore që i referohen të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor. Në veçanti, trajnimi ka për qëllim që të ofrojë horizonte për akterët e gjykatave dhe prokurorive në eliminimin e aspekteve që ndikojnë në zgjatjen e procedurave gjyqësore, duke aplikuar drejtë standardet dhe praktikën e GJEDNJ, si dhe të ofrojë njohuri praktike në unifikimin e praktikës gjyqësore që do të ndikonte në reduktimin e anulimit të paarsyeshëm të vendimeve.


### **Objektivat**

- 🎯 Zbatimi i standardeve dhe praktikës përkatëse të GJEDNJ-së me rastin e zbatimit të gjykimit në afat të arsyeshëm kohor duke zbatuar drejtë jurisprudencën e GJEDNJ-së në Nenin 6.
- 🎯 Avancimi i kapaciteteve të profesionistëve ligjorë në zbatimin e standardeve dhe praktikës së GJEDNJ sa i përket tej zgjatjes së procedurave dhe anulimit të panevojshëm të vendimeve të shkallës më të ulët.
- 🎯 Avancimi i njohurive lidhur me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në zbatimin e Nenit 6 të KEDNJ


## Përmbajtja

-  Analizë e standardeve dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së sa i përket Nenit 6 të KEDNJ-së, me theks në çështjet praktike të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm kohor dhe anulimit të panevojshëm të vendimeve;
-  Qasja në rastet konkrete të GJEDNJ-së dhe zbatimi më i mirë i tyre në praktikën gjyqësore në Kosovë në çështjet civile dhe penale;
-  Shkeljet e nenit 6 në lidhje me aspektet e gjykimit në afat të arsyeshëm dhe anulimit të panevojshëm të vendimeve;
-  Rastet studimore të bazuara në jurisprudencën e GJEDNJ (Konsiderata të përgjithshme të nenit 6 në aspektin e çështjeve civile dhe penale Garancitë e përgjithshme: kërkesat institucionale, kërkesat procedurale, Garancitë specifike, Efekti ekstraterritorial i nenit 6)


## Metodologjia

-  Trajnimi do të zhvillohet duke kombinuar prezantime dhe diskutime ndërvepruese me pjesëmarrësit, me studime të rasteve duke përfshirë analizat e Konventës dhe rasteve të GJEDNJ dhe duke punuar në skenarë hipotetikë. Fokusi do të jetë në analizën e jurisprudencës përkatëse të GJEDNJ-së, referuar zbatimit praktik të Nenit 6 dhe impaktit që ka në nivel kombëtar

## Përfituesit

-  Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)

### 3. Mjetet Efektive Juridike sipas Nenit 13 të KEDNJ-së: Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në çështjet civile dhe penale

Neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përcakton të drejtën për një mjet efektiv juridik. Neni 13 i KEDNJ-së përcakton se *“kushdo të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, do të ketë një mjet juridik efektiv përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në cilësinë zyrtare”*. Qëllimi i trajnimit është rritja e njohurive të pjesëmarrësve për të drejtën për mjetet efektive juridike, e cila është një komponentë thelbësore e të drejtave të njeriut sipas (KEDNJ) dhe instrumenteve të tjera të të drejtave të njeriut. Qasja në mjete juridike efektive duhet të sigurohet në sistemet ligjore kombëtare në të gjitha nivelet e procedurave gjyqësore. Në praktikë, këto mjete juridike duhet të shteren në nivelet e rregullta të përpara, brenda sistemit gjyqësor, përpara aplikimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Me vendosjen e mekanizmave të brendshëm, së pari parashihet të shterohen këto mekanizma, përpara se individët të mund t'i drejtohen GJEDNJ. E drejta për një mjet efektiv juridik i jep efekt parimit të subsidiaritetit, i përforcuar edhe nga kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 35 të KEDNJ. Kështu, ky parim pasqyron rolin themelor të sistemeve gjyqësore kombëtare në garantimin e respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut, si pjesë integrale e sistemit të Konventës. Pjesëmarrësit pritet të analizojnë një numër të konsiderueshëm në praktikën e GJEDNJ-së që i referohen shkeljes së nenit 13, përfshirë aspektet për shkeljet brenda shteteve anëtare për të zbatuar mjetet juridike. Për më tepër, pjesëmarrësit do të mësojnë se si shkelja e nenit 13 ndodh gjithmonë në lidhje me një të drejtë tjetër të përcaktuar në KEDNJ dhe Protokollet e saj. Për më tepër, ky trajnim synon analizimin praktik të aspekteve nga jurisprudenca e GJEDNJ-së në lidhje me nenin 35 të KEDNJ-së, që përfshijnë mjete efektive juridike që nuk janë ezauruar përpara aplikimit në GJEDNJ.


#### Objektivat

- 🎯 Zbatojnë standardet dhe praktikën përkatëse të GJEDNJ-së për të drejtën për një mjet efektiv në punën e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë;
- 🎯 Avancimi i njohurive për mjetet juridike të brendshme për të qenë efektive në ndreqjen e shkeljeve të të drejtave të Konventës;
- 🎯 Zbatimi drejte i parimeve themelore të referuara në mjetet juridike efektive dhe të njihen me karakteristikat e kërkuara të mjeteve juridike në situata të caktuara specifike që i referohen çështjeve civile, penale dhe administrative.


#### Përmbajtja

- 📖 Qasja në mjetet juridike efektive - Standardet dhe parimet e aplikuara nga GJEDNJ (referenca në KEDNJ, dhe zbatimi i parimeve të Nenit 13 të KEDNJ në praktikë);
- 📖 Parimi i subsidiaritetit – aspekti procedural i zbatimit praktik të këtij parimi me rastin e paraqitjes së rasteve;
- 📖 Shkelje e nenit 13 në lidhje me nenet e tjera të KEDNJ;
- 📖 Aspektet procedurale të papranueshmërisë së kërkesave nga GJEDNJ – praktika gjyqësore përkatëse e sipas nenit 35 të KEDNJ;
- 📖 Rastet studimore të bazuara në jurisprudencën e GJEDNJ.


## **Metodologjia**

 Trajnimi do të përfshijë prezantime dhe diskutime ndërvepruese dhe shkëmbime me pjesëmarrësit në një mjedis “peer-to-peer”. Fokusi do të jetë në analizën e jurisprudencës përkatëse të GJEDNJ-së, referuar zbatimit praktik të Nenit 13 dhe impaktit që ka në nivel kombëtar.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurore)
- Trajnuesi i përhershëm i AD-së

#### **4. Përdorimi dhe referimi i jurisprudencës së GJEDNJ me rastin e shkrimit të vendimeve gjyqësore**

Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duke përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) janë drejtpërdrejt të zbatueshme në sistemin juridik dhe kanë përparësi në interpretim ndaj legjislacionit kombëtar. Më tej, neni 53 i Kushtetutës thotë se të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë aspekt, Akademia e Drejtësisë e konsideron të rëndësishme zhvillimin e trajnimeve për profesionistët ligjor (gjyqtarë, prokurore dhe bashkëpunëtor profesional) mbi standardet e përcaktuara në KEDNJ dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Akademia e Drejtësisë e ka vlerësuar të nevojshëm ofrimin e një trajnimi në përdorimin e platformave dhe resurseve të GJEDNJ-së (i.e. HUDOC) si dhe përdorimin dhe referimin në rastet e GJEDNJ-së me qëllim të shkrimit dhe arsytimit ligjor. Duke qenë se interpretimi i të drejtave dhe lirive themelore bëhet në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, është e nevojshme që profesionistët ligjorë të gjykatave dhe prokurorëve të kenë njohuri për databazat e GJEDNJ-së, platformat e Këshillit të Evropës, si dhe resurseve të tjera, siç janë udhëzuesit e GJEDNJ për Nenet përkatëse të KEDNJ. Ky trajnim do të ofrojë njohuri për mënyrën e përdorimit dhe qasjes në këto platforma, si dhe të kuptuarit për mënyrën e referimit të saktë në çështjet konkrete.




Trajnimi do të ketë në fokus, aspektet e citimit dhe referimit korrekt të rasteve dhe standardeve të përcaktuara nga GJEDNJ, aplikimin e jurisprudencës së GJEDNJ-në në rastet konkrete në gjykata dhe prokurori, zbatimin e jurisprudencës së GJEDNJ me rastin e shkrimit dhe arsytimit ligjor. Njohuritë e fituara në këtë trajnim do të mundësojnë zhvillimin e shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke siguruar që shkrimi dhe arsytimi ligjor të zhvillohet duke iu referuar parimeve dhe rasteve konkrete të GJEDNJ-së.

Trajnimi synon që profesionistët ligjor (gjyqtarë, prokurore dhe bashkëpunëtorët profesional) të jenë në gjendje të përdorin me lehtësi platformat dhe resurset e GJEDNJ-së (i.e. HUDOC, Udhëzuesit e rasteve të GJEDNJ), duke qenë në gjendje të hulumtojnë rastet adekuate të GJEDNJ-së dhe jurisprudencën e ndërtuar, të cilat do t'i ndihmojnë në punën e tyre. Po ashtu, ky trajnim do të shërben si mundësi që profesionistët ligjorë të shkruajnë dhe arsyetojnë aktet përkatëse duke interpretuar saktë të drejtat e njeriut me jurisprudencën e GJEDNJ-së.




#### **Objektivat**

- 🎯 Aftësimi në përdorimin e resurseve dhe platformave të Këshillit të Evropës dhe GJEDNJ-së (i.e. HUDOC, Udhëzuesit e GJEDNJ për Nenet e KEDNJ, etj);
- 🎯 Zhvillimi i shkathtësive praktike në hulumtimin dhe identifikimin e rasteve konkrete apo dokumenteve në platformat e KE dhe GJEDNJ;
- 🎯 Përdorimi i platformave sipas nevojave dhe mënyrave të ndryshme për identifikimin e çështjeve, neneve përkatëse apo rasteve;




-  Aftësimi praktik i përdorimit të jurisprudencës së GJEDNJ me rastin e shkrimit ligjor, përfshirë citimin e rasteve adekuate, mënyrës së referimit në rastet e GJEDNJ-së, përdorimin e rasteve të GJEDNJ-së në situatat konkrete praktike;
-  Zhvillimi i shkathtësive të profesionistëve ligjor në shkrimin ligjor në përputhje me standardet e GJEDNJ-së me rastin e zbatimit të jurisprudencës së GJEDNJ;
-  Zhvillimi i shkathtësive praktike në aplikimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së me rastin e dhënies së vendimeve kur ato i referohen jurisprudencës së GJEDNJ.


## **Përmbajtja**

-  Qasja dhe hulumtimi në platformat e KE dhe GJEDNJ, përfshirë shkathtësitë në gjetjen dhe hulumtimin e rasteve dhe dokumenteve në HUDOC dhe përdorimi i udhëzuesve të GJEDNJ.
-  Hulumtimi dhe qasja në rastet e GJEDNJ-së dhe zbatimi më i mirë i tyre në praktikën gjyqësore në Kosovë në çështjet civile dhe penale.
-  Shkrimi ligjor dhe rritja e kapaciteteve me rastin e arsytimit të vendimeve në harmoni me jurisprudencën e GJEDNJ.


## **Metodologjia**

-  Trajnimi do të zhvillohet duke kombinuar prezantime dhe diskutime ndërvepruese me pjesëmarrësit, me qasje në mjetet e kërkimit (search engines) të platformave si HUDOC dhe përdorimi praktik i Udhëzuesve të GJEDNJ. Ushtrime praktike të gjetjes, referimit dhe citimit të rasteve të GJEDNJ në harmoni me standardet e shkrimit ligjor.

## **Përfituesit**

-  Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurore)
- Trajnuesi i përhershëm i AD-së

## 5. Neni 5 i KEDNJ

Instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duke përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) janë drejtpërdrejt të zbatueshme në sistemin juridik dhe kanë përparësi në interpretim ndaj legjislacionit kombëtar. Neni 53 i Kushtetutës thotë se të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke marr parasysh këtë, Akademia e Drejtësisë ka dizajnuar një program të rëndësishëm i cili u ofron gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë, mundësinë e trajnimit mbi standardet më të mira të përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Në vlerësimin e nevojave për trajnim të kryer së fundmi nga Akademia e Drejtësisë, u shfaq kërkesa specifike për jurisprudencën e GJEDNJ-së sipas nenit 5 të KEDNJ, që i referohet: E drejta për Liri dhe Siguri. E drejta për liri dhe siguri e përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së korrespondon me nenin 29 të Kushtetutës së Kosovës dhe paraqet një nga të drejtat fundamentale në një shoqëri demokratike sepse bënë pjesë në kategorinë e të drejtave themelore e njeriut. Kjo e drejtë garanton që të gjithë individët duhet të jenë të lirë nga privimet arbitrare ose të pajustificuara të liria. Korniza ligjore që afekton këtë të drejtë përfshinë: Kushtetutën, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur.







Trajnimit synon ti shqyrtojë zbatimin e tyre duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ duke ofruar mjete konkrete për praktikuesit se si të avancojnë vendimmarrjen, procesin dhe cilësinë e vendimeve dhe arsyetimi i tyre. Në këtë aspekt, kohëzgjatjen e tepërt të paraburgimit dhe arsyetimin joadekuat të caktimit të paraburgimit do të trajtohen në kontekstin e nenit 5 të konventës.

Punëtorja do të ofrojë platformë për të eksploruar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në përputhje me Udhëzuesit e GJEDNJ-së mbi nenin 6 të KEDNJ-së, i cili ofron referenca për rastet historike si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale. Praktika e zhvilluar nga GJEDNJ dhe qasja kur vendoset për raste të veçanta do të shërbejë si burim i vlefshëm për praktikuesit në gjyqësorin e Kosovës në lidhje me të drejtën për gjykatë, të drejtat procedurale dhe procesin e rregullt ligjor, deri në arsyetimin cilësor të gjykimeve.


### Objektivat

- 🎯 Të avancohen njohuritë lidhur me standardet dhe praktikën e GJEDNJ-së përkitazi me të Drejtën për Liri dhe Siguri
- 🎯 Të përdoren gjithnjë e më shumë masat alternative për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë në raport me masën e paraburgimit;
- 🎯 Të zvogëlohet kohëzgjatja e paraburgimit;
- 🎯 Të ofrojë arsyetim cilësor me rastin e caktimit dhe vazhdimin të masës së paraburgimit


## Përmbajtja

-  Fushat e mëposhtme tematike do të mbulohen në programin e trajnimit përmes analizave të Jurisprudencës së GJEDNJ:
-  E drejta për liri dhe siguri, neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
-  Natyra joabsolute e së drejtës për liri dhe siguri
-  Heqja ligjore e së drejtës së lirisë;
-  Paraburgimi;
-  Garanci për personat e privuar nga liria.


## Metodologjia

-  Trajnimi do të zbatohet përmes metodave të ligjërimit teorik, praktik dhe të kombinuar. Pjesëmarrësve do u jepen ushtrime praktike nga rastet e trajtuara në prokurori dhe do të kërkohet që të analizojnë dhe prezantojnë çështjet e evidentuara. Sesionet do të organizohen në punëtori individuale dhe grupe. Përmes kësaj metode synohet që pjesëmarrësi të përfshihet aktivisht në çdo çështje dhe në këtë mënyrë edhe do t'i forcojë njohuritë që posedon por edhe do të marr njohuri të reja në fusha të caktuara.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët, Prokurorët e Shtetit, Avokatët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët Ligjor, Policët hetues.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA E DREJTA  
EVROPIANE***

Temë e identifikuar nga:

- Qendra Evropiane për Gjyqtarë dhe Avokatë (Qendra e Luksemburgut të Institutit Evropian për Administratë Publike/EIPA)

## 1. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale

Gjatë 15 viteve të fundit, një zhvillim i rëndësishëm ka ndodhur në fushën e së drejtës evropiane, i cili, megjithatë, mbetet kryesisht i pavërejtur nga praktikuesit ligjorë (gjyqtarët kombëtarë, avokatët, etj.). E drejta ndërkombëtare private ose - siç quhet në Traktat - 'bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile' është zhvilluar në një fushë të pavarur dhe të veçantë të së drejtës evropiane. Meqenëse Traktati i Amsterdimit i dha kompetencën Bashkimit Evropian për të nxjerrë ligje në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, një numër i rëndësishëm aktesh legjislativ evropiane në këtë fushë janë miratuar. Ashtu si me fushat e tjera të së drejtës së Bashkimit Evropian, instrumentet e miratuara në këtë fushë kanë përparësi ndaj ligjeve të brendshme të Shteteve Anëtare dhe ndërliqhen me ligjin kombëtar kur bëhet fjalë për vendosjen në nivel të Bashkimit të standardeve minimale procedurale të përbashkëta në fusha të veçanta ligjore. Si rezultat, gjyqtarët kombëtarë e gjejnë veten gjithnjë e më shumë të përballur me situata që kanë implikime ndërkufitare dhe me probleme dhe çështje ligjore të rregulluara nga ligjet e BE-së. Situata të tilla mund të përfshijnë, për shembull, përmbushjen e kontratave që përfshijnë dërgimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve përtej kufijve, çështjet ligjore në lidhje me lëvizjen e turistëve dhe aksidentet e trafikut jashtë vendit, çështjet në lidhje me blerjen dhe asgjësimin e pronës, të luajtshme dhe të paluajtshme, nga individë dhe biznese në një ose më shumë Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian, të ndryshëm nga ai në të cilin ata janë të vendosur, dhe trashëgim të pronave të individëve që kanë pronë dhe lidhje me disa Shtete Anëtare. Në fushën e së drejtës familjare gjithashtu, marrëdhëniet personale shumëkombëshe janë gjithnjë e më të shpeshta dhe pyetjet ligjore lindin rregullisht në rastet e marrëdhënieve ndërkufitare të familjes dhe përgjegjësisë prindërore. Njëlloj, në ditët e sotme, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) të cilat janë një komponentë e madhe e tregut të brendshëm evropian po kryejnë transaksione përtej kufijve pothuajse në baza ditore dhe shpesh online.

### Objektivat

- 🎯 Avancimi i njohurive rreth evolucionit të kornizës institucionale dhe vendimmarrëse të sektorit të drejtësisë civile në BE;
- 🎯 të kuptojnë instrumentet ligjore aktualisht në fuqi dhe të fitojnë një pasqyrë në përafrimin dhe harmonizimin e ligjeve civile të BE-së.

### Përmbajtja

- 📄 Qarkullimi i lirë i vendimeve në çështje Civile dhe Komerciale;
- 📄 E drejta e zbatueshme në çështje Civile dhe Tregtare;
- 📄 Qarkullimi i lirë i gjykimit në çështje Familjare;
- 📄 Aspektet procedurale të bashkëpunimit gjyqësor në çështje Civile;
- 📄 Rregullimi jasht Gjykatës, metodat alternative për zgjidhjen e mosmarrveshjeve Civile dhe Trgtare në Bashkim Evropian.

## **Metodologjia**



Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive dhe analizë të rasteve gjyqësore.

## **Përfituesit**



Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Kohëzgjatja**



Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Qendra Evropiane për Gjyqtarë dhe Avokatë (Qendra e Luksemburgut të Institutit Evropian për Administratë Publike/EIPA)

## 2. Bashkëpunimi gjyqësor dhe i zbatuesve të ligjit në çështje penale

Ky modul prezanton konceptet bazë, objektivat dhe format e bashkëpunimit dhe institucionet e së drejtës penale të BE-së. Ai gjithashtu përshkruan se si kuadri institucional dhe vendimmarrës për bashkëpunimin në çështjet penale ka evoluar brenda Bashkimit Evropian dhe fokusohet në procedurën legjislative dhe instrumentet ligjore në fuqi aktualisht në këtë kuadër. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shpjegimit të ndryshimit midis ndihmës së ndërsjellë juridike dhe njohjes reciproke. Instrumentet kryesore, të tilla si Urdhër Arrestimi Evropian, do të analizohen në detaje. Për më tepër, arritjet kryesore të së drejtës penale materiale dhe procedurale do të shpjegohen së bashku me drejtimit në të cilat duket se evoluon zhvillimet juridike në këtë fushë.

Më tej, moduli do të fokusohet në rolin e gjyqtarëve dhe prokurorëve kombëtarë në zbatimin e ligjit penal të BE-së dhe ndikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së BE-së në interpretimin dhe formësimin e kësaj fushe ligjore.

### Objektivat

- 🎯 Avancimi i njohurive rreth përdorimit në mënyrë efektive parimet ligjore, instrumentet e ndryshme ligjore dhe procedurat e zbatimit të së drejtës penale të BE-së
- 🎯 Aftësia për të trajtuar vendimet e rolit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e së drejtës penale të BE-së dhe aftësinë për të punuar me të me anë të procedurës së vendimit preliminar.
- 🎯 Kuptimi i ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet sistemeve kombëtare të drejtësisë penale të Shteteve Anëtare dhe shpërndarjes së kompetencave ndërmjet funksioneve të hetimit dhe ndjekjes penale.
- 🎯 Avancimi i njohurive për të përdorur në praktikë asistencën e ndërsjellë juridike dhe instrumentet e njohjes reciproke në fushën e së drejtës penale të BE-së, të tilla si Urdhër arresti Evropian dhe Urdhri Evropian i Hetimit, dhe aftësi praktike për të trajtuar në mënyrë efikase shumëllojshmërinë e e-Instrumenteve të drejtësisë.

### Përmbajtja

- 📄 Drejtësia Penale dhe Legjislacioni i BE-së;
- 📄 Ndihma juridike dhe njohja reciproke;
- 📄 Mbrojtja e të drejtave themelore, të drejtave procedurale dhe mbrojtje në procedurën penale;
- 📄 Fushat specifike të Krimit, e drejta Penale materiale.

## **Metodologjia**



Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive dhe analizë të rasteve gjyqësore.

## **Përfituesit**



Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Kohëzgjatja**



Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.



***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA E  
KUNDËRVAJTJES***

Temë e identifikuar nga:



- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjqqtarë/prokurorë)

## **1. Tërheqja e parashtruesit të kërkesës pas parashtrimit të kërkesës në lëmin e inspektoriatit**




Përmes këtij trajnimi synohet që të ofrohen sqarime në raport me procedurën kundërvajtëse në përgjithësi me theks të veçantë në raport me subjektet inicuese të procedurës kundërvajtëse, rastet kur procedurën kundërvajtëse e zhvillon organi dhe rastet kur procedurën e zhvillon gjykata, pastaj në rast konflikti në mes të organit dhe gjykatë, pezullimi i procedurës kundërvajtëse, lëndët e inspektoriatit, e sidomos kur inspektorati si palë inicuese në procedurën kundërvajtëse e tërheq kërkesën. Vendimet e Gjykatës në raste të tilla dhe procedimi i mëtutjeshëm. Përmes diskutimeve të problemeve të identifikuara synohet që të ofrohen pasqyrë e qartë rreth inicimit, subjekteve inicuese, pezullimit, tërheqjes së kërkesës, përmbajtjes së kërkesës kundërvajtëse dhe subjektet ndaj të cilave inicohet procedura kundërvajtëse.

Si të vepohet në rastet kur organi që e ka iniciuar kërkesën për kundërvajtje e tërheq të njëjtën? Kjo është evidentuar si problematikë nga ana e gjyqtarëve. Kërkesa e tërhequra a kanë efekt si do të zhvillohet procedura tuje si mbulohet kjo fushë me ligj.


### **Objektivat**

-  Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore në rastet e tërheqjes së kërkesës;
-  Avancojnë njohuritë se në cilat raste procedurën kundërvajtëse e zhvillon vet organi dhe cilat raste gjykata.


### **Përmbajtja**

-  Inicimi i procedurës kundërvajtëse dhe subjektet inicuese;
-  Procedura kundërvajtëse tek organi dhe tek gjykatat;
-  Pezullimi i procedurës kundërvajtëse;


### **Metodologjia**

-  Trajnimi do të realizohet përmes sqarimeve të çështjeve teorike duke ofruar edhe interpretim të dispozitave ligjore ku është fokusi i trajnimeve si dhe diskutime praktike ndërtuar mbi raste të identifikuara sfiduese dhe praktike jo unike me qëllim unifikimit e praktikës.

### **Përfituesit**

-  Gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni kundërvajtës, inspektorët në kuadër të drejtorive të inspektoriatit

### **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë 1 (një) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR  
NDËRMJETËSIM***

## Ndërmjetësimi-Penale

Temë e identifikuar nga:

- Shërbimi Federal i Ndërmjetëimit dhe Pajtitimit/FMCS dhe INL

### 1. Ndërmjetësimi për Gjyqtarë dhe Prokurorë (në rastet penale)

Ndërmjetësimi në rastet penale paraqet një mundësi për zgjidhjen e konflikteve dhe për uljen e ngarkesës në sistemin gjyqësor. Ndërmjetësimi ofron qasje më fleksibile dhe të shpejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke krijuar hapësirën për të biseduar dhe arritur një marrëveshje që është e pranueshme për të dyja palët. Megjithatë, përdorimi i ndërmjetëimit në rastet penale në Kosovë përballet me disa sfida, si mungesa e referimit të mjaftueshëm të rasteve në ndërmjetësim, mungesa e koordinimit dhe komunikimit efektiv ndërinstitucional, mungesa e komunikimit efektiv me palë, apo sfidat në identifikimin e rasteve të përshtatshme për ndërmjetësim.

Qëllimi i këtij trajnimi është përmirësimi i kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve për procesin e ndërmjetëimit në rastet penale, përmes ndarjes së praktikave të mira ndërkombëtare, në mënyrë që të rritet përdorimi i ndërmjetëimit në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë.


#### Objektivat

- 🎯 Rritja e ndërgjegjësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi rolin dhe vlerën e ndërmjetëimit;
- 🎯 Diskutim mbi rastet penale që janë të përshtatshme për ndërmjetësim dhe ato që nuk janë;
- 🎯 Ndarja e praktikave të mira dhe historive të suksesit nga kontekste lokale dhe ndërkombëtare për të ilustruar rezultatet pozitive të ndërmjetëimit;
- 🎯 Avancimi i njohurive mbi përfitimet shoqërore të ndërmjetëimit, përfshirë zgjidhjen më të shpejtë të mosmarrëveshjeve, uljen e ngarkesës së gjykatave dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve;
- 🎯 Ndarja e praktikave të mira për bashkëpunimin efektiv me zyrtarët për ndërmjetësim për të siguruar referim më të lehtë të rasteve dhe rezultate më të qëndrueshme.

#### Përmbajtja

- 📄 Përfitimet shoqërore të ndërmjetëimit;
- 📄 Identifikimi i rasteve të përshtatshme për ndërmjetësim;
- 📄 Praktikave të mira lokale dhe ndërkombëtare;
- 📄 Strategjitë për bashkëpunim midis gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve për ndërmjetësim.


## Metodologjia

 Trajnimi do të përfshijë pjesën teorike që do të realizohet nga ekspertët e FMCS, diskutime grupore për të ndarë përvoja dhe praktika, duke inkurajuar një shkëmbim të hapur mendimesh dhe ideve, analizimin e rasteve studimore që ilustrojnë situata konkrete dhe diskutime interaktive.

## Përfituesit

 Prokurorët e Prokurorive Themelore dhe Gjyqtarët e Gjykatave Themelore (Departamentet Penale).

## Kohëzgjatja

 Katër trajnime nga një (1) ditë:

- Prishtinë;
- Gjilan dhe Ferizaj;
- Gjakovë dhe Prizren;
- Pejë dhe Mitrovicë.

## Ndërmjetësimi-Civile

Temë e identifikuar nga:

- USAID-it - Drejtësia Komerciale

### **1. Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, zhvillimi i saj në ndërmjetësim të detyrueshëm veçanërisht në raste familjare dhe aprovimi ose anulimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit - raste praktike**

Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, zhvillimi i saj në ndërmjetësim të detyrueshëm dhe aprovimi ose anulimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit - raste praktike, ka për qëllim të ofrojë sqarime të detajuara për procedurën e ndërmjetësimit, duke filluar nga momenti i referimit të lëndës, sqarimin e zhvillimit të saj në ndërmjetësim të detyrueshëm, veçanërisht në rastet familjare, si dhe të përshkruajë procedurën e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit dhe efektin e tyre në praktikë. Trajnimi synon që për temën e propozuar, të u sqaroj dhe të ju ndihmojë gjyqtarëve të kuptojnë apo interpretojnë drejtë dispozitat ligjore të cilat lënë hapësirë për dykuptimësi dhe të shtjelloj zbatimin e pa unifikuar këtyre dispozitave nga ana e gjyqtarëve që trajtojnë lëndët e tilla.

Nevoja për organizimin e një cikli të tillë të trajnimeve, me temën e propozuar, rrjedhë nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nga sfidat praktike të adresuara nga gjyqtarët. Trajnimi synon të arrijë ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve që kanë përfunduar trajnimin fillestar dhe atyre që nuk kanë marrë pjesë në ciklet e mëparshme të këtyre trajnimeve. Qëllimi është që ata të trajtojnë me efikasitet rastet civile dhe të ofrojnë zgjidhje për sfidat që hasen gjatë procedimit të rasteve në ndërmjetësim, si dhe në ushtrimin e kompetencës së tyre lidhur me vlefshmërinë e marrëveshjeve të ndërmjetësimit. Kjo përfshinë harmonizimin e praktikave gjyqësore dhe zbatimin e qëndrueshëm të dispozitave ligjore.






Cilat janë sfidat më të mëdha për gjyqtarët gjatë referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, gjatë procedurës së aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit? Cilat janë sfidat e procedurës së referimit të lëndëve për të cilat parashihet Ndërmjetësimi i detyrueshëm? Cilat janë dilemat e gjyqtarëve në ushtrimin e kompetencës së tyre gjatë vlerësimit të vlefshmërisë së marrëveshjeve të ndërmjetësimit? Cilat janë të metat eventuale që gjyqtarët shohin në aspektin e përpilimit të marrëveshjeve nga ana e ndërmjetësuesve?

Mënyra më efektive e kuptimit të koncepteve sipas këtij trajnimi, është biseda interaktive me gjyqtarët nëpërmjet shtrimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve ashtu që, mes shembujve praktik mund të zgjidhen dilemat që mund të dalin.


### **Objektivat**

- 🎯 Kuptojnë saktë rolin e gjyqtarëve në procesin e referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit;
- 🎯 Zbatojnë drejtë bazën ligjore të ndërmjetësimit;
- 🎯 Unifikojnë praktikën e referimit, aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të arritura përmes ndërmjetësimit;
- 🎯 Qartësojnë procedurën e referimit të rasteve familjare në procedurën e ndërmjetësimit;
- 🎯 Unifikojnë referimin e kontesteve për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm;
- 🎯 Unifikojnë zbatimin e Protokollit për Ndërmjetësim.


## Përmbajtja

-  Referimi i lëndëve të përshtatshme në procedurën e ndërmjetësimit-raste praktike;
-  Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit;
-  Ndërmjetësimi i detyrueshëm, me fokus të veçantë tek rastet familjare;
-  Sfidat në implementimin e Ligjit për Ndërmjetësim;
-  Sfidat në implementimin e Protokollit për Ndërmjetësim.


## Metodologjia

-  Trajnimi do zhvillohet përmes diskutimit interaktiv, aplikimit të shembujve më të mirë në praktik që japin sqarime adekuate të procesit të referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të arritura në ndërmjetësim, ndërmjetësimin e detyrueshëm. Gjatë trajnimit do të paraqiten raste praktike në të cilët gjyqtarët duhen dhënë përgjigje apo opinione të tyre, ashtu që kuptimi i procedurës së ndërmjetësimit të jetë sa më lehtë i kapshëm.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe degëve, si dhe ndërmjetësuesit e regjioneve të atyre gjykatave.

## Kohëzgjatja

-  Dy trajnime nga një (1) ditë:

- Prishtinë, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë;
- Prizren, Pejë dhe Gjakovë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA KOMPETENCA  
INTERDICIPLINARE***



Temë e identifikuar nga:

- Formulari për Vlerësim pas përfundimit të trajnimit;
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Dokumenti i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 - KPK

## 1. Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore është njëri ndër komponentët kryesor përmes së cilës pasqyrohet vendimmarrja e drejtë e gjykatave dhe pasqyron profesionalizmin dhe njohuritë konkrete të gjyqtarit në raport me lëndën dhe standardet ndërkombëtare. Ky Trajnim synon që të përmirësoj nivelin e shkrimit dhe arsyetimin dhe paraqitet si ndihmës për gjyqtarët, bashkëpunëtorët dhe zyrtarët ligjor në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale lidhur me hulumtimin ligjor, shqyrtimin gjyqësor dhe hartimin e vendimeve gjyqësore.

Trajnimi si i tillë për shkak të tematikës do të jetë një reflektim i të gjeturave praktike ku përmes këtyre të gjeturave do të përfitonë të trajnuarit në aspektet e shkrimit dhe arsyetimit me fokus në zhvillimin e aftësive analitike tek pjesëmarrësit duke trajtuar mënyrën së si duhet t'i qasemi një çështjeje juridike, si duhet të realizohet hulumtimi i resurseve për çështjen objekt shqyrtimi, si duhet të realizohet analiza ligjore dhe sipas cilave standarde duhet të bëhet shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Përveç udhëzimeve teorike lidhur me parimet dhe metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, pjesë e këtij trajnimi do të jenë edhe rastet dhe udhëzimet praktike në mënyrë që pjesëmarrësit njohurit e fituara të mund t'i aplikojnë në praktikë.








Përmes udhëzimeve dhe rasteve konkrete nga fusha civile dhe penale pjesëmarrësit do të kenë mundësi që duke zbatuar kërkesat e ligjeve nga procedura penale dhe civile të japin konkluzionet e tyre për vendosjen e çështjeve që trajtojnë. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor paraqet standard vlerësimi të punës së gjykatave. Në këtë kuptim shkrimi dhe arsyetimi ligjori në punë e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe zyrtarëve e përfaqëson një objektiv jo lehet të arritshëm, prandaj përmes këtij trajnimi synohet që përmirësohet cilësia e shkrimit dhe arsyetimit ligjor në punën e tyre.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Praktika aktuale, problemet e identifikuar praktike, cilësia e shkrimit dhe e arsyetimit, niveli i zhvillimit të shkathtësive analitike dhe aplikimi i standardeve ndërkombëtare të shkrimit dhe arsyetimit ligjor.


### Objektivat

- 🎯 Avancojnë cilesin rreth hartimit dhe arsyetimit ligjor;
- 🎯 Avancimi i shkathtësive analitike me rastin e hartimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore;
- 🎯 Modelet e të shkruarit dhe arsyetimit ligjor;
- 🎯 Ngrisin aftësitë rreth interpretimi;
- 🎯 Avancojnë njohuritë për kualifikimin e duhur të veprës në aktakuzë dhe akte tjera prokuroriale.

## Përmbajtja

-  Llojet e arsytimit ligjor;
-  Parimet e shkrimit të mirë ligjor;
-  Kërkesat ligjore për shkrimin dhe arsytimin e vendimeve gjyqësore;
-  Zbatimi i metodës IRAC të vendimet penale;
-  Kualifikimi i duhur i veprës në aktakuzë dhe akte tjera prokuroriale;
-  Shkrimi pa gabime;
-  Numri akteve të kthyer për plotësim nga gjykata.


## Metodologjia

-  Trajtimi teorik i elementeve të shkrimit, mënyrës së formularit të akteve ligjore, interpretimit të akteve, analizës së fakteve, i hartimit të akteve kryesore procedurale. Diskutim teorik lidhur me dispozitat ligjore procedurale që i referohen kërkesave ligjore për shkrimin e akteve ligjor. Demonstrim praktik i mënyrës së arsytimit dhe shkrimit ligjor. Diskutim teorik dhe praktik për metodat e analizës ligjore në rastet konkrete. Prezantim i rasteve civile dhe penale dhe diskutime për mënyrën e vendosjes së supozuar meritore për rastet konkrete. Pjesëmarrësit përveç kontributit të tyre në diskutime sfidojnë edhe idetë e trajnuesit lidhur me shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë çështjeve alternative apo edhe problematike.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor.

## Kohëzgjatja

-  Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti i BE-së për Kosovën
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 - KPK






## 2. Etika Profesionale

Praktikat etike të gjyqtarit dhe prokurorit janë ndër hapat e parë të mëdhenj drejtë krijimit të një mjedisi institucional i cili do të përmirësojë besueshmërinë e qytetarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës. Qasja etike do të shërbejë si gur themel për vetëbesimin e gjyqtarëve apo prokurorëve kur ofrojnë shërbimet e tyre që kanë të bëjnë me drejtësinë. Megjithatë, kodet e etikës dhe të sjelljes janë pjesë e një kuadri më të gjerë. Kodet profesionale nuk duhet, dhe nuk mund të qëndrojnë në vetvete (të pavarura). Kodet profesionale duhet të merren parasysh bashkë me përshkrimet e punës, me betimin për ndershmëri, me vlerësimin e performancës dhe me format e tjera të mbikëqyrjes dhe udhëheqjes. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth zbatimit të parimeve kryesore të etikës, të cilat janë të përcaktuara me Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtarë dhe prokurorë dhe jo vetëm, siç janë pavarësia, paanësia, integriteti, konflikti i interesit, barazia, përdorimi i mediave sociale, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë, konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat etj.









Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Si zbatohet në praktikë parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore nga gjyqtarët dhe prokurorët? Si zbatohet në praktikë parimi i integritetit të gjyqtarit dhe prokurorit, si dhe cilat janë pasojat nëse nuk respektohet një parim i tillë? Çka nënkupton komunikimi ex parte dhe si duhet ti shmangët gjyqtari apo prokurori një komunikimi të tillë? Cilat janë detyrimet etike të gjyqtarit dhe prokurorit në zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të palëve në procedura gjyqësore? Çka nënkupton konflikti i interesit, si dhe si duhet të shmangët nga gjyqtari apo prokurori? Çka përfshin ruajtja e konfidencialitetit të procedurës gjyqësore nga gjyqtari dhe prokurori, si dhe si duhet të sillët i njëjti në raport me mediat dhe publikun? A lejohet përdorimi i rrjeteve sociale nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nëse po në çfarë kushte? A lejohet pranimi i dhuratave nga ana e gjyqtarit apo prokurorit?.

Trajnimi do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës përmes trajtimit të çështjeve dhe parimeve kryesore të etikës profesionale të cekura më lartë, zbatimi me korrektësi i të cilave nga gjyqtarët dhe prokurorët do të forcojë besimin e publikut në gjyqtarin dhe prokurorin në veçanti dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi, si dhe do të ketë ndikim pozitiv tek gjyqtarët dhe prokurorët që gjatë punës së tyre dhe jo vetëm, të jenë të pavarur, të paanshëm, me integritet, duke i trajtuar të gjitha palët në mënyrë të barabartë. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën gjyqësore dhe prokuroriale, e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuar duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë më fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me zbatimin e parimeve të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë dhe prokurorë. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe jo vetëm dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.


## Objektivat

-  Avancojnë njohuritë për rregullat bazë të etikës gjyqësore sipas Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe prokurorë;
-  Zbërthejnë parimet dhe rregullat e Kodit në situata të ndryshme të jetës reale;
-  Identifikojnë dhe zgjidhin problemet etike;
-  Zhvillojnë mendimin kritik në lidhje me etikën;
-  Zbatojnë drejtë rregullat etike dhe Kodin e Etikës Profesionale.

## Përmbajtja

-  Etika profesionale dhe Kodi i Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë;
-  Pavarësia dhe paanësia;
-  Integriteti dhe konflikti i interesit;
-  Barazia, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë;
-  Komunikimi ex parte;
-  Dhuratat;
-  Përdorimi i mediave sociale;
-  Konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat.


## Metodologjia

-  Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

## Përfituesit

-  Gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjat një (1) ditë.



Temë e identifikuar nga:

- Raporti mbi monitorimin e proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor
- KE/CEPEJ








### 3. Menaxhimi i seancave gjyqësore

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e Gjykatës parashikojnë zbatim efektiv të së drejtës në gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme. Gjykata vlerëson kohëzgjatjen e tepërt të procedurave në bazë të rrethanave të rastit, duke pasur parasysh në veçanti kompleksitetin e secilit rast, sjelljen/ veprimet e palës paditëse dhe autoriteteve relevante, dhe rëndësinë e asaj që kërkon pala paditëse në një proces gjyqësor. Kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave para gjykatës duhet të monitorohet dhe matet prej dorëzimit të procedurës në gjykatë deri në zbatimin e vendimit përfundimtar gjyqësor. Qëllimi i këtij trajnimi është që të parandalohet kohëzgjatja e tepërt e procedurave gjyqësore. Ky trajnim është plotësues me modulet CEPEJ që janë të disponueshme në internet në formatin HELP.


#### Objektivat

-  Të menaxhojë në mënyrë aktive procedurat gjyqësore;
-  Të shmangin vonesat dhe abuzimet procedurale.


#### Përmbajtja

-  Menaxhimi aktiv i rasteve;
-  Përfshirja e palëve në një fazë të hershme;
-  Kalendari procedural i rënë dakord;
-  Bashkëpunimi me aktorë të tjerë: ekspertë, dëshmitarë etj.
-  Shuarja e abuzimeve procedurale
-  Të gjitha të dhënat regjistrohen në sistemin e menaxhimit të rasteve dhe përditësohen rregullisht;
-  Përdorimi i shablloneve standarde elektronike.


#### Metodologjia

-  Trajnimi do të realizohet duke përdorë metodologji të ndryshme përfshirë diskutime interaktive, pune në grupe përgatitje dhe trajtimi i rasteve nga praktika.

#### Përfituesit

-  Gjyqtarë, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjorë.

#### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Ministria e Punëve të Brendshme/MBP

#### 4. Trajtimi i informacionit të klasifikuar në proceset gjyqësore

Qëllimi i këtij moduli është që pjesëmarrësve në rend të parë, t'iu ofrohen njohuri teorike dhe praktike sa i përket trajtimit dhe përdorimit të informacioneve të klasifikuara si provë në procese gjyqësore. Gjykata duhet të vendos nëse informacionin e klasifikuar mund ta përdorë si provë. Ligji Nr.08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, i trajton parimet bazë, standardet minimale të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës. Në bazë të këtij ligji është themeluar Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar e cila është përgjegjëse për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Në kuadër të këtij ligji është e rregulluar edhe cilët autoritet kanë të drejtë të bëjnë klasifikimin e informacionit, kategoritë e informacioneve të klasifikuara, nivelet dhe kohëzgjatja e klasifikimit si dhe deklasifikimi i tyre. Informacionet e klasifikuara mund të përdoren si prova në proceset gjyqësore por përdorimi i tyre është subjekt i rregullave dhe kufizimeve strikte për të mbrojtur sigurinë kombëtare ose të dhënat e ndjeshme. Për shkak të natyrës së ndjeshme të informacioneve të klasifikuara gjykata dhe palët e përfshira në proces duhet të ndjekin procedura të veçanta për të balancuar nevojën për drejtësi me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe palët që kërkojnë të përdorin informacion të klasifikuar si provë duhet të ndjekin një proces ligjor për të marr lejen për të shfaqur dokumentet përkatëse dhe gjykata për të shmangur zbulimin e e pjesëve të ndjeshme të informacionit të klasifikuar mund të përdor versione të redaktuara të dokumenteve apo të urdhëroj që pjesë të gjykimit të zhvillohen me dyer të mbyllura për të parandaluar që ai informacion të bëhet publik.

Për të mbrojtur informacionin e klasifikuar gjykata shpesh kufizojnë pjesëmarrjen e publikut dhe mediave në këto seanca duke siguruar që informacioni të ruhet brenda një rrethi të ngushtë njerëzish me autorizim të posaçëm. Në disa raste palët mund të kërkojnë që një pjesë e informacionit të klasifikuar të deklasifikohet për të lejuar përdorimin e tij në proces gjyqësor. Gjykata duhet të kujdeset edhe sa i përket ruajtjes së informacionit të klasifikuar transmetimit të saj dhe qasjes në dosjet gjyqësore.












Andaj gjykata duhet të balancojë nevojën për drejtësi me mbrojtjen e interesave për siguri kombëtare duke përdor masa të tilla si seanca të mbyllura, redaktim të dokumenteve dhe rregulla të autorizimit për qasje.

- Qka nënkuptojnë informacion i klasifikuar në procese gjyqësore
- Kush e bën klasifikimin e informacioneve të klasifikuar në procese gjyqësore ,
- Cilat janë nivelet e klasifikimit të këtyre informacioneve
- Qka nënkuptojmë me de klasifikim të dokumenteve
- Kush ka të drejtë qasje në dokumenteve klasifikuara
- Procedura për de klasifikimin e dokumenteve të klasifikuara në procese gjyqësore
- Si trajtohen dokumentet e klasifikuara në procedura gjyqësore
- A kërkohet leje e posaçme për përdorim të këtyre dokumenteve si prova


#### Objektivat

- 🎯 Kuptojnë saktë se çka nënkuptojmë me informacion të klasifikuar;
- 🎯 Standardet minimale të sigurisë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuar;
- 🎯 Të identifikojnë autoritet klasifikuese dhe nivelet e klasifikimit;
- 🎯 Kur mund të përdoren si prova informacionet e klasifikuara në procese gjyqësore;
- 🎯 Të kuptojnë saktë procedurën e de klasifikimit.


## **Përmbajtja**

-  Përkufizimi i dokumentit të klasifikuar;
-  Autoritet e klasifikuese;
-  Nivelet e klasifikimit;
-  Certifikata ta e sigurisë së personelit;
-  Mbrojtja e informacionit të klasifikuar;
-  De klasifikimi i dokumenteve të klasifikuara;
-  Përdorimi i dokumenteve të klasifikuara;
-  Kufizimi i qasjes në dokumentet e klasifikuara;
-  Qasja në informacion të klasifikuar;
-  Roli i gjyqtarëve dhe palëve;
-  Përrjashtimi/Kufizimi i dokumenteve të klasifikuara.


## **Metodologjia**

-  Trajnim, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

## **Përfituesit**

-  Gjyqtarët, Prokurorët, bashkëpunëtor profesionalë, zyrtar ligjor, zyrtarët e Agjencionit për mbrojtën e informacionit të klasifikuar.

## **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.




Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 - KPK








## 5. Menaxhimi i rasteve dhe i zyrës

Zbatimi i teknikave të menaxhimit të rasteve nga prokurorët në krahasim me menaxhimin e fluksit të rasteve me të cilat merren prokuroritë, paraqesin sfida të cilat janë mjaft problematike në punën e përditshme. Ndikim në këtë problem kanë edhe ndryshimet në strukturën organizative që janë bërë në prokurori e të cilat do të kenë një efekt pozitiv në përmirësimin e menaxhimit të rasteve.


### Objektivat

-  Zbatojnë drejtë parimet e menaxhimit të rasteve;
-  avancojnë njohuritë në menaxhimin e rasteve;
-  Aplikojnë drejtë teknikat e menaxhimit të rasteve.


### Përmbajtja

-  Menaxhimi i rasteve;
-  Parimet themelore të menaxhimit të rasteve;
-  Teknikat kryesore të menaxhimit të rasteve;
-  Përdorimi efektiv i SMIL në menaxhim të rasteve.
-  Të qenit i hapur për përdorimin e metodave dhe teknikave të reja të punës;
-  Zgjidh rastet në mënyrën e duhur;
-  Veprimi në pajtim me të gjitha procedurat dhe protokolet e zyrës.


### Metodologjia

-  Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, prezantim në PowerPoint.

### Përfituesit

-  Prokurorët e të gjitha niveleve.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.



***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR DHUNËN NDAJ  
GRAVE, DHUNËN NË FAMILJE DHE DHUNËN  
NË BAZË GJINORE***


Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ngaj grave
- Programi kombëtarë për të drejtat e njeriut 2021-2025


## 1. Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore

Me përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutë në 2020 dhe CEDAË në 2008, të gjithë zyrtarët e drejtësisë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të kenë njohuri për standardet ndërkombëtare dhe mënyrën se si t'i zbatojnë ato në mënyrë efektive në punën e tyre, andaj ky trajnim synon ta arrij edhe këtë objektivë. Qëllimi i trajnimit është ngritja e kapacitetet e kuadrit ligjor mbi konceptet kryesore, kornizat normative vendore dhe ligjet që lidhen me Dhunën ndaj Grave (DhNG), Dhunën në Familje (DhF) dhe Dhunën me Bazë Gjinore (DhBGj).


### Objektivat

-  Ngritja e kapacitetet dhe njohurive të zyrtarëve ligjor mbi konceptet bazë të Dhunës ndaj Grave, Dhunën në Familje dhe Dhunën me Bazë Gjinore.


### Përmbajtja

-  Familiarizimin me natyrën gjinore, manifestimet dhe dinamikën e DhNG dhe DhF si dhe pjesëmarrësit do të pajisen me një pasqyrë të parimeve udhëzuese në trajtimin e këtyre rasteve. Kjo përfshin përdorimin e një qasjeje të përqendruar te viktima, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe të mbajturit përgjegjës kryerësin e dhunës, shpjegim të traumës dhe ndikimit të traumës tek viktima, dhe marrjen e vendimeve për raste të tilla pa stereotipe gjinore.


### Metodologjia

-  Metodologjia e trajnimit është e përzier, rekomandohet që të kombinohet ndjekja e kursit online në platformën kryesore të Këshillit të Evropës për Profesionistët ligjor “HELP”, kursi “Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, i cili mbulon Konventën e Stambollit dhe ligjet dhe politikat përkatëse vendore për DhNG, DhF dhe DhBGj. Gjithashtu, propozhet që pjesa tjetër e trajnimit të jetë me prezencë fizike për të ofruar tek pjesëmarrësit mundësi për të reflektuar se si t'i zbatojnë këto parime në praktikë në punën e tyre.

### Përfituesit

-  Gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistëve të tjerë të çdo niveli dhe funksioni dhe mund të sugjerohet si parakusht për ndjekjen e moduleve të tjera të specializuara, nëse pjesëmarrësi/ja nuk ka ndjekur trajnim të mëparshëm në këtë fushë.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë 1 (një) ditë.



Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ngaj grave
- Programi kombëtarë për të drejtat e njeriut 2021-2025







## 2. Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale

Qëllimi i Programit të Trajnimit është të përgatisë gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistë të tjerë për të trajtuar në mënyrë efektive rastet që përfshijnë DhNG, DhF dhe DhBGJ në përputhje me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare, me fokus në sigurimin e një qasjeje të përqendruar tek viktimat, të mirë-informuar mbi traumën, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe qasje ku kryerësi i dhunës mbahet përgjegjës, ashtu që të kontribuohet në ndalimin e ciklit të mosndëshkueshmërisë.


### Objektivat

-  Ngritjen e kapaciteteve për t'i dhënë një përgjigje efektive rasteve të dhunës në familje, duke marrë për bazë koncepte dhe rrethana të ndërlidhura me rastin siç janë: dinamikën e dhunës në familje, ciklin e fuqisë dhe kontrollit, luftimin e stereotipeve e zakonshme për viktimat dhe kryerësit e dhunës, teknikat e intervistimit.
-  Njohin programet për kryerësit e dhunës, si pjesë e dënimit.


### Përmbajtja

-  Përmbledhje të dispozitave përkatëse të Kodit Penal dhe Udhëzimeve dhe Politikave përkatëse të Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë, si dhe përkufizimet e reja në Ligjin për DhF, DhNG dhe DhBGJ.
-  Dinamikën e dhunës në familje, kontrolli shtrëngues, cikli i fuqisë dhe kontrollit si dhe cikli i dhunës, stereotipet për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje;
-  Traum, dhunën në familje dhe faktorët e rrezikut, duke përfshirë dhunën pas ndarjes;
-  identifikimi i veprave penale të dhunës në familje, teknikave të intervistimit- çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet bërë, mbledhja dhe vlerësimi i provave, m ushtrimi i gjykimit të prokurorisë dhe përzgjedhja e akuzave,
-  Luftimi i përdorimit diskriminues të rregullave të provave, sigurimi i marrjes së vendimit të duhur për dënimin e kryerësve të dhunës,
-  Përfshirja e programeve të trajtimit të kryerësit të dhunës si pjesë e dënimit, dhe trajtimin e shkeljeve të urdhrit të mbrojtjes.


### Metodologjia

-  Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

## **Përfituesit**

 Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorët profesional, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë relevantë të cilët vijnë në kontakt të rregullt me rastet e dhunës në familje në sistemin e drejtësisë penale.

## **Kohëzgjatja**

 Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.



Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ngaj grave
- Programi kombëtarë për të drejtat e njeriut 2021-2025





### **3. Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare**

Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është ngritja e njohurive të kuadrit ligjor mbi kuptimin e dhunës në familje në të Drejtën Civile, me fokus në urdhrat mbrojtës dhe konsiderimet e të drejtës familiare.


#### **Objektivat**

-  Ngritjen e kapaciteteve të kuadrit ligjor në kuptimin e drejtë të dhunës në familje në të drejtën civile;
-  Ngritja e njohurive në zbatimin efektiv të urdhrave mbrojtës.


#### **Përmbajtja**

-  Dispozitat përkatëse në Ligjin për DhF, DhNG dhe DhBGJ lidhur me procedurën gjyqësore për vendosjen e kërkesave për urdhër mbrojtje;
-  Dispozitat përkatëse në Ligjin për Familjen lidhur me kujdestarinë dhe qasjen, mbrojtjen e fëmijëve, mbështetjen e fëmijëve dhe bashkëshortëve dhe ndarjen e pasurisë;
-  Dinamika dhe llojet e dhunës në familje;
-  Trauma.


#### **Metodologjia**

-  Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

#### **Përfituesit**

-  Gjyqtarë të gjykatave civile, dhe përfshinë aplikimin e urdhërit mbrojtës dhe/ose çështje të së drejtës familiare (p.sh. çështjet e kujdestarisë).

#### **Kohëzgjatja**

-  Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.


Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ngaj grave
- Programi kombëtarë për të drejtat e njeriut 2021-2025







#### **4. Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën**

Qëllimi i përgjithshëm i këtij trajnimi është ngritja e kapaciteteve të kuadrit ligjor mbi ndjekjen penale efektive dhe nxjerrjen e vendimeve të informuara mbi traumën e viktimës, në përputhje me ligjet vendore, standardet ndërkombëtare dhe Strategjinë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026. Pjesëmarrësit do të angazhohen në praktikimin e teknikave për marrjen në pyetje të duhur të dëshmitarëve dhe viktimave të traumatizuara dhe pjesëmarrësit do të kenë mundësinë t'i praktikojnë ato nëpërmjet ushtrimeve të simuluar në një mjedis të kontrolluar.


#### **Objektivat**

-  Avancimi i njohurive të faktorëve të rëndësishëm që luajnë rol në ndjekjen penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën, duke u thelluar tek mitet e zakonshme rreth dhunimit, çështjen e pëlqimit, dhe praktikave të marrjes në pyetje të rasteve të tilla.


#### **Përmbajtja**

-  Mitet e zakonshme të dhunimit rreth çështjeve të besueshmërisë dhe pëlqimit;
-  Neurobiologjia e traumës dhe se si trauma ndikon në sjelljen dhe kujtesën e viktimës, dhe implikimet për hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet;
-  Qasjet e përgjithshme të intervistimit;
-  Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave;
-  Teknikat e ekzaminimit (të drejtpërdrejta, të kryqëzuara, të ridrejtuara);
-  Strategjitë e pyetjeve për dëshmitarë të ndryshëm, trajtimin e dëshmitarëve të traumatizuar qasjen e mbështetjes së dëshmitarëve dhe trajtimin e traumatizimit dytësor.

#### **Metodologjia**

-  Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

#### **Përfituesit**

-  Prokurorë, Gjyqtarët, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë (p.sh. ekzaminerët mjeko-ligjorë), që merren me veprat që mbulojnë forma të ndryshme të dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunimin dhe sulmin seksual, ndjekjen, martesën e detyruar, dhe ngacmimin seksual.

#### **Kohëzgjatja**

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE KUNDËR  
DISKRIMINIMIT***

Temë e identifikuar nga:

- Raporti i OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut
- Programi kombëtarë për të drejtat e njeriut 2021-2025

## **1. Mbrojtja gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit**

Trajnimi për mbrojtjen gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e legjislacionit në fuqi kundër diskriminimit. Në aspektin procedural Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMND), shpreh qëllimin e qartë të ligjvënësit për të siguruar mjete juridike efektive për çështjet e diskriminimit përmes të gjitha rrugëve të mundshme ligjore, përfshirë organet administrative, gjykatat, hetimet penale, prokuroritë, si dhe mekanizmat e ndërmjetësimit.





Pretendimin e bazuar në bazat e diskriminimit të parapara me LMND-në dhe sipas legjislacionit në fuqi, mund të paraqesë çdo person ose grup personash (kushtëzuar) të cilët pretendojnë se janë diskriminuar. LMND shpreh qartazi tiparet e veçanta procedurale në rastet që trajtojnë diskriminimin si: afatin për paraqitjen e kërkesës nga pala që pretendon se është diskriminuar, urgjenca në trajtim të rasteve të diskriminimit, llogaridhënia, provat dhe metodat e ligjshme (përfshirë, por pa u kufizuar në të dhëna statistikore) që mund të dëshmojnë sjellje diskriminuese, barrën e provës e cila bie mbi të paditurin, llojet e masave, sanksioneve, dhe dëmshpërblimit, kjo edhe kur LMND zbatohet në ndërthurje me ligjet përkatëse procedurale.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Çfarë nënkuptojmë me diskriminim? Cilat janë llojet dhe format e diskriminimit dhe si shprehen më së shpeshti në praktikë? Cili është fushëveprimi i dispozitave të Ligjit kundër Diskriminimit, përkatësisht në cilat raste dhe rrethana zbatohen të njëjtat? Cili është roli dhe përgjegjësia e Avokatit të Popullit sipas LMND?, Kush mund të parashtrij padi në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet për diskriminim? Cili është afati ligjor për parashtrimin e padisë kundër diskriminimit në gjykatën kompetente? Kush e mban barrën e provës në kontestet kundër diskriminimit? Cilat janë llojet e vendimeve gjyqësore të cilat i merr gjykata kompetente sipas LMND? Cilat janë mjetet juridike që mund të paraqiten në këto konteste? Cilat janë rastet e diskriminimit të cilat përbëjnë vepër penale? etj.






Trajnimi do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore. Trajnimi do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës kundër diskriminimit, me theks të veçantë për mbrojtjen gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.




## Objektivat

-  Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin;
-  Njohin kompleksitetet praktike në situatat ku ndër veprojnë ligjet në rastet e diskriminimit;
-  Analizojnë trajtimin e rasteve të diskriminimit në procedurën kontestimore, përfshirë këtu në trajtimin e kontesteve të punës me elemente diskriminimi si dhe
-  Përafrojnë qëndrimet në zbatimin unik të dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin.


## Përmbajtja

-  Bazat dhe format e manifestimit të diskriminimit sipas LMnD;
-  Mënyrat e zbatimit të aspekteve procedurale të LMnD, në ndërthurje me ligjet përkatëse procedurale;
-  Llojet e masave, dëmshpërblimi dhe sanksionet që mund të shqiptohen ndaj atyre që diskriminojnë;
-  Zbatimi i LMnD në ndërthurje me ligjet tjera;
-  Praktika e GJEDNJ-së lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi.


## Metodologjia

-  Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

## Përfituesit

-  Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, prokurorët.

## Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR  
MENAXHMENTIN E GJYKATAVE DHE  
PROKURORIVE***

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026




## 1. Menaxhimi i Gjykatës

Menaxhimi nënkupton organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim. Prandaj, njohuritë e përgjithshme mbi menaxhimin e gjykatave, duke filluar nga menaxhmenti, udhëheqësit tjerë që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore, financave, zyrës qendrore të menaxhimit të lëndëve, zyrës për mbështetje juridike, zyrës për logjistike dhe zyrën për informim, duhet të zhvillohen edhe më tutje nëpërmjet trajnimeve praktike.




Si menaxhohet suksesshëm një gjykatë? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të gjykatës?

Ky trajnim është hartuar për të ju përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e gjykatave përmes kombinimit të prezantimeve ku do të trajtohen strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të gjykatave. Gjatë tërë procesit do të behet një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.


### Objektivat

-  Zbatojnë parimet standarde të menaxhimit të mirë;
-  Identifikojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
-  Zbatojnë parimet dhe metodologjinë e planifikimit.


### Përmbajtja

-  Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i gjykatës;
-  Përgjegjësitë menaxheriale;
-  Burimet njerëzore dhe financat.


### Metodologjia

-  Gjatë trajnimit do të përdorën metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, gjithashtu duke shfrytëzuar edhe PowerPoint prezantime.

### Përfituesit

-  Kryetarët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026




## 2. Menaxhimi i Prokurorisë

Menaxhimi nënkupton organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim. Prandaj, njohuritë e përgjithshme mbi menaxhimin e prokurorisë, duke filluar nga menaxhmenti, udhëheqësit tjerë që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore, financave, zyrës qendrore të menaxhimit të lëndëve, zyrës për mbështetje juridike, zyrës për logjistike dhe zyrën për informim, duhet të zhvillohen edhe më tutje nëpërmjet trajnimeve praktike.




Si menaxhohet suksesshëm një prokurori? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të prokurorisë?

Ky trajnim është hartuar për të ju përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e prokurorisë përmes kombinimit të prezantimeve ku do të trajtohen strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të prokurorisë. Gjatë tërë procesit do të bëhet një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.


### Objektivat

-  Zbatojnë parimet standarde të menaxhimit të mirë;
-  Identifikojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
-  Zbatojnë parimet dhe metodologjinë e planifikimit.


### Përmbajtja

-  Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i prokurorisë;
-  Përgjegjësitë menaxheriale;
-  Burimet njerëzore dhe financat.


### Metodologjia

-  Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, gjithashtu duke shfrytëzuar edhe PowerPoint prezantime.

### Përfituesit

-  Kryeprokurorët, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve, Udhëheqësit rajonal të zyrës për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR  
BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL DHE ZYRTAR  
LIGJOR***

## MODULET E TRAJNIMIT BAZIK PËR BASHKËPUNËTORT PROFESIONAL

### PENALE

#### *Materiale*

1. Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përjashtimit të Kundërligjshmërisë, pjesa e Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat Penale kundër integritetit Seksual
2. Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit, Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli: XXVI, XXIII, XXIX dhe XXX të KPK-së.

#### *Proceduarale*

3. Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi
4. Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta

### DREJTËSI PËR FËMIJË

5. Parimet e procedurës ndaj të miturve dhe Masat dhe dënimet ndaj të miturve

### CIVILE

#### *Materiale*

1. E drejta e trashëgimisë dhe e Drejta pronësore
2. E drejta e punës dhe E drejta e detyrimeve

#### *Proceduarale*

3. Proceduara kontestimore
4. Proceduar përmbartimore dhe Ndërmjetësimi
5. E Drejta Familjare dhe Dhuna në familje

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR STAFIN  
ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE  
PROKURORIAL***





Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK






## 1. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është që nëpërmjet prezantimit të koncepteve dhe parimeve të menaxhimit të rrjedhës së rasteve, pjesëmarrësit të njoftohen dhe të përgatiten me shkathtësi për identifikimin, fillimisht të problemeve të menaxhimit të rasteve dhe më pas për të zhvilluar dhe zbatuar një planë për menaxhimin e rrjedhjes së lëndës.


### Objektivat

-  Avancojnë njohuritë për menaxhimin e rasteve;
-  Respektojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
-  Demonstrjnë teknikat e menaxhimit të rasteve;
-  Avancojnë njohuritë lidhur me parimet dhe metodologjinë e CEPEJ.


### Përmbajtja

-  Regjistrat e gjykatave dhe prokurorive;
-  Organizimi i rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës;
-  Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi;
-  Menaxhimi efikas i lendeve bazuar në metodologjinë CEPEJ;
-  Digjitalizimi i procesit të punës në gjykata dhe prokurori.


### Metodologjia

-  Realizimit të trajnimit do ti kontribuojnë metodat e prezantimit përmes PowerPoint, punës në grupe dhe përdorimi i rasteve praktike.

### Përfituesit

-  Administratorët, ndihmës administrator, shefi i ZML-së, referentët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët ligjor, sekretarët juridike, zyrtarët e informimit, njësi për vlerësimin e performances së prokurorëve.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.




Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK








## 2. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë të përfshirë vazhdimisht në forma të ndryshme të komunikimit. Natyrisht, shkathtësitë e komunikimit janë të rëndësishme në të gjitha mjediset e punës. Megjithatë, nuk ka dyshim se komunikimi efektiv është absolutisht jetik për funksionimin e suksesshëm të prokurorive. Konteksti i komunikimit ndryshon, por duket se hyn në dy kategori themelore, komunikimi i brendshëm dhe komunikimi i jashtëm.

### Objektivat

-  Avancimi i komunikimit brenda administratës dhe fokusimi në aspekte e rregulla të ndryshme, dhe në praktikën e mira për komunikim më të mirë të jashtëm (me mediat, qytetarët, dhe institucionet tjera) dhe të brendshëm.


### Përmbajtja

-  Komunikimi i jashtëm dhe politikat e standardet e aplikueshme;
-  Komunikimi i brendshëm: rrjedha e informacionit, hierarkia, puna e ekipore dhe shkëmbimi i informacionit, konfidencialiteti i të dhënave dhe informatave, dhe sjellja dhe etika profesionale;
-  Delegimi i detyrave, monitorimit dhe mbikëqyrjes;
-  Planifikimi, vendosja e prioritetëve dhe caktimi i detyrave;
-  Raportimi;
-  Përdorimi i TI-së në komunikim;
-  Praktikën, format dhe procedurat standarde uniforme.


### Metodologjia

-  Prezantime, raste studimore, simulime, ushtrime praktike.

### Përfituesit

-  Administratorët e prokurorive dhe zëvendësit e tyre, zyrtarët për marrëdhënie me publikun, stafi i zyrës së pranimit dhe të gjitha kategoritë e tjera të stafit administrativ që ka ndërveprim me qytetarë, palë dhe institucione të ndryshme.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:




- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

### 3. Integriteti dhe sjelljet etike në administratën gjyqësore dhe prokuroriale




Qëllimi i administratës prokuroriale në Kosovë, për të gjithë stafin që i përket sistemit prokurorial, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve dhe standardeve etike në përputhje me Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paanësia, pavarësia, konfidencialiteti, shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia.

Moduli është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar bazën ligjore dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.


#### Objektivat

-  Dallojnë sjelljet e etike brenda dhe jashtë zyrës;
-  Zbatojnë në mënyrë të drejtë Kodin e Etikës dhe parimet e tij;
-  Identifikojnë rastet kur kemi të bëjmë me shkelje etike.

#### Përmbajtja

-  Parimet dhe normat e sjelljes etike;
-  Sjellja brenda dhe jashtë zyrës dhe
-  Ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia.


#### Metodologjia

-  Gjatë këtij trajnimi do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime teorike, përmes PowerPoint dhe diskutime interaktive.

#### Përfituesit

-  Stafi administrativ prokurorial.

#### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:




- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

#### 4. Menaxhimi i kohës dhe stresit






Ky trajnim është i konceptuar si projekt i nevojshëm i zhvillimit të shkathtësive të menaxhimit të kohës dhe stresit për zyrtarët e administratës së prokurorive si një predispozitë e përmirësimit të performancës së tyre në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës së prokurorive gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre të përcaktuara me ligj. Stresi sot është një dukuri negative përcjellëse në të gjitha aktivitetet, zhvillimet, veprimet e sjelljet e individit dhe dukuri e pashmangshme në përgjithësi në socium. Zyrtarët e administratës së prokurorive gjatë punës së tyre të përditshme përballen me situata të shumta stresuese dhe u ekspozohen gjatë punës stresorëve të shumtë të cilët interferojnë negativisht në shërbimet e këtyre zyrtarëve në raport me prokurorët por edhe në raport me palët e subjektet tjerë.

Menaxhimi i kohës dhe stresit është nevojë imediate si parandalim i atakimit të personaliteteve të zyrtarëve në administratë në rastin konkret, nga ana e stresorëve të ndryshëm, në mënyrë që puna e tyre të jetë cilësorë dhe efikase.


#### Objektivat

-  Dinë të menaxhojnë mirë kohën;
-  Bëjnë prioritetizimin e aktiviteteve të tyre ditore, javore dhe mujore;
-  Njohin dhe aplikojnë teknikat dhe mënyrat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës.

#### Përmbajtja

-  Stresi dhe përkufizimi teorik;
-  Menaxhimi i kohës;
-  Prioritizimi i aktiviteteve;
-  Teknikat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës;
-  Ruajtja nga “djegia” e profesionit.


#### Metodologjia

-  Gjatë këtij trajnimi do të aplikohen metoda dhe teknika bashkëkohore, prezantim në PowerPoint, pune në grupe dhe studim i rasteve nga praktika.

#### Përfituesit

-  Staf i administrativ prokurorial.

#### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:





- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

## 5. Trajnimi për protokollin dhe Etiketa








Mikpritja është një element i veçantë që kërkon rregulla të mirësjelljes që duhet respektuar në shoqëri por edhe me rastin e ceremonive gjatë funksioneve zyrtare. Në funksion të kësaj është zhvilluar edhe protokollin i cili përcakton një sërë rregullash që duhet respektuar nga institucionet e shtetit me rastin e vizitave të delegacioneve të huaja në vendin tonë ose edhe në institucionet tona.

Qëllimi i këtij trajnimi është ngritja e aftësive të stafit të gjykatave dhe prokurorive në organizimin e pritjeve të delegacioneve duke u bazuar në rregullat që përcakton Protokollin i Shtetit.


### Objektivat

-  Kuptojnë saktë çka është Etiketa dhe Protokollin;
-  Njohin shembuj të veshjes zyrtare (kodit të veshjes), gratë në jetën publike dhe zyrtare;
-  Krahasojnë protokollin në vendet e ndryshme dhe praktikën e mira si dhe
-  Zgjerojnë njohuritë rreth praktikave diplomatike në formë të pavarur.


### Përmbajtja

-  Protokollin dhe Etika;
-  Protokollin me rastin e pritjes së delegacioneve;
-  Korrespondenca diplomatike;
-  Natyra e ndryshimit të diplomacisë;
-  Metoda diplomatike;
-  Zhvillimi i praktikave diplomatike;
-  Udhëzim për komunikim dhe traditat ndërkombëtare.


### Metodologjia

-  Trajnimi do të zhvillohet përmes ligjëratisë interaktive ku pjesëmarrësit do të kenë mundësinë përmes rasteve të veçanta të analizojnë aspektin ceremonial të procedurave të protokollit, përmes pyetjeve dhe bashkëbisedimeve.

### Përfituesit

-  Përfituesit e trajnimit janë stafi administrativ.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.



Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK



## 6. Mbrojtja e sinjalizuesve

Qëllimi i trajnimit është trajtimi i çështjeve të ndërlidhura me mbrojtjen e sinjalizuesve, përforcimi i njohurive në raport me të drejtat e sinjalizuesve si dhe krijimi i njohurive të reja në raport me zhvillimet e fundit në fushën e sinjalizimit në Kosovë, rajon dhe në Evropë. Përmes trajnimit mëtohet të trajnohen stafi administrativ si dhe zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin në gjithë regjionet e vendit.


### Objektivat

-  Njohin standardet ndërkombëtare e vendore për të drejtat e njeriut që lidhen me punën e gjyqësorit;
-  Zbatojnë praktikat më të mira në fushën e lirisë së shprehjes dhe fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve.


### Përmbajtja

-  Standardet ndërkombëtare e vendore për të drejtat e njeriut që lidhen me punën e gjyqësorit;
-  Parimet, institucionet, proceset dhe praktikat në fushën e lirisë së shprehjes në përgjithësi, dhe në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve në veçanti.


### Metodologjia

-  Metoda specifike të trajnimeve për profesionistë ligjorë do të aplikohen për këtë trajnim. Do të përdoren ushtrime për shkrirjen e akullit, prezantime në PPT, raste studimore, ushtrime në grup, sondazhe të opinionit publik, debate të nxitura nga trajnuesit e specializuar në fushën e lirisë së shprehjes, provime vlerësimi. Trajnimi do të bazohet në tërësi në manualin e trajnimit të zhvilluar nga projekti JUFREX.

### Përfituesit

-  Zyrtarët administrativ të prokurorive dhe zyrtarët për sinjalizimin në prokurori.

### Kohëzgjatja

-  Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- USAID/Drejtësia Komerçiale

## 7. Ndërmjetësim - trajnimi për Nëpunësit e Gjykatave

Nëpunësit për ndërmjetësim në Prokuroritë dhe Gjykatat Themelore, veçanërisht në departamentet penale, luajnë një rol kyç në administrimin dhe koordinimin e proceseve të ndërmjetësimit për çështjet penale. Ata mbikëqyrin procedurat dhe dokumentacionin, duke siguruar që ndërmjetësimi të zhvillohet sipas ligjit dhe standardeve profesionale. Përmes aftësive të tyre, ata kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve dhe uljen e ngarkesës së sistemit gjyqësor. Qëllimi i këtij trajnimi është të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve për ndërmjetësim, veçanërisht në komunikimin me palët. Pjesëmarrësit do të trajnohen për bazat e procesit të ndërmjetësimit, përfitimet e tij, si dhe çfarë duhet të presin dhe si të përgatiten palët për ndërmjetësim.

### Objektivat

- 🎯 Avancimi i njohurive dhe praktikave të mira ndërkombëtare për nëpunësit gjyqësorë mbi procesin e ndërmjetësimit dhe përfitimet e tij;
- 🎯 Rritja e kapaciteteve të nëpunësve për të përshkruar qartë procesin e ndërmjetësimit tek palët;
- 🎯 Avancimi i aftësisë së nëpunësve për të komunikuar në mënyrë efektive, tek palët, përfitimet e ndërmjetësimit dhe rolin e ndërmjetësuesve.

### Përmbajtja

- 📄 Përmbledhje e njohurive themelore mbi procesin e ndërmjetësimit;
- 📄 Roli i ndërmjetësuesve dhe përfitimet e ndërmjetësimit;
- 📄 Objektivat e ndërmjetësimit;
- 📄 Komunikimi me palët;
- 📄 Çfarë duhet të presin palët kur marrin pjesë në proceset e ndërmjetësimit;
- 📄 Si duhet të përgatiten palët për ndërmjetësim;
- 📄 Praktikrat e mira të programeve të ndërmjetësimit në gjykata dhe prokurori.

### Metodologjia

- 📖 Trajnimi do të përfshijë pjesën teorike që do të realizohet nga ekspertët e FMCS; diskutime grupore për të ndarë përvoja dhe praktika, analizimin e rasteve studimore që ilustrjnë situata konkrete; role-play; dhe diskutime interaktive.

### Përfituesit

- 👥 Nëpunësit për ndërmjetësim në Gjykatat Themelore dhe Prokuroritë Themelore (Departamentet Penale).

### Kohëzgjatja

- 🕒 Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

## 8. Shkathësitë ligjore dhe gjyqësore

Trajnimi shkathësitë ligjore dhe gjyqësore ka për qëllim të ndihmoj stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale. Ky trajnim është i fokusuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale lidhur me zhvillimin e shkathësitëve profesionale për të dhën vlerësimet e duhura më rastin e pranimit të kërkesave për fillimin e procedurave të ndryshëm ligjore, për të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale lidhur me përgatitjen e fazave pasuese të procedurës dhe për të hartuara aktet/vendimet e ndryshme varësisht nga përfundimi që është arritur si rezultat procedurës përkatëse. Me fokus të veçantë në kuadër të këtij trajnimi do të shtjellohen teknikat e hulumtimit ligjor, shkrim dhe arsyetimi ligjor si parakushte për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit në zbatimin e kompetencave gjyqësore dhe prokuroriale për trajtuar me kohë dhe në mënyrë profesionale çështjet e ngritura. Ky trajnim është hartuar për të dhënë udhëzimet teorike dhe praktike lidhur me shkathësitë e hulumtimit ligjor, shkathësitë e trajtimit të rasteve dhe shkathësitë për shkrimin dhe arsyetimin ligjor, sipas metodave dhe standardeve që garantojnë objektivitet, siguri, cilësi dhe efikasitet.

### Objektivat

- 🎯 Të njohin teknikat e hulumtimit ligjor;
- 🎯 Të zbatojnë kompetencat për shqyrtimin e rasteve dhe përgatitjen e fazave pasuese të procedurës;
- 🎯 Të njohin procesin dhe parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- 🎯 Të zbatojnë në mënyrë efektive metodën IRAC;
- 🎯 Të hartojnë në mënyrë të pavarur vendimet gjyqësore dhe aktet akuzuese.

### Përmbajtja

- 📄 Teknikat e hulumtimit ligjor;
- 📄 Shqyrtimi paraprak i rasteve dhe ndërmarrja e veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë;
- 📄 Procesi dhe parimet e të shkruarit mirë ligjor;
- 📄 Shkrimi dhe arsyetimi ligjor përmes metodës IRAC;
- 📄 Struktura dhe përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit.

### Metodologjia

- 📖 Trajnimi do të zhvillohet në një ambient interaktiv bashkëbisedimi dhe diskutimi me qëllim që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre.

### Përfituesit

- 👥 Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretarët juridike.

### Kohëzgjatja

- 🕒 Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

## 9. Trajnimi hyrës për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës së prokurorive

Trajnimet hyrëse kanë për qëllim që t'i ofrojë mundësi çdo punonjësi të marrë pjesë në të gjitha trajnimet relevante për kryerjen e detyrave administrative në prokuroritë. Qëllimi kryesor i trajnimit hyrës është të sigurojë trajnimin për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës, duke u fokusuar në fushat më të rëndësishme për ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të tyre profesionale si anëtarë të administratës prokuroriale.

### Objektivat

- 🎯 Avancojnë njohuritë lidhur me strukturën dhe administrimin e sistemit gjyqësor;
- 🎯 Njohin parimet dhe detyrat kryesore në kryerjen e detyrave administrative në kuadër të sistemit;
- 🎯 Nxitja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga pjesëtarët e administratës.

### Përmbajtja

#### Moduli 1:


- 📄 Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale dhe Qasja në informacion, konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit të klasifikuar, si dhe mbrojtja e të dhënave (aktet përkatëse ligjore, aspektet praktike);
- 📄 Hyrje në planifikim, menaxhim, menaxhimin e kohës dhe stresit, Komunikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm, puna në ekip, Koncepti i "Shërbimeve të Orientuara në Cilësi " dhe në shërbim të qytetarëve;
- 📄 Hyrje në sistemin prokurorial të Kosovës, parimet dhe rregulloret Kushtetuese (Kapitulli 7), legjislacioni dhe institucionet relevante dhe Hyrje në administratën prokuroriale, legjislacioni përkatës, funksionet dhe përgjegjësitë.

#### Moduli 2:


- 📄 Hyrje në punën e prokurorive; struktura, organogramet; kategoritë e stafit administrativ dhe të drejtat e detyrimit të tyre, Specifikat e punës në çështjet civile, çështjet penale dhe çështjet administrative; llojet e rasteve, aktet gjyqësore dhe seancat gjyqësore;
- 📄 Rregullat dhe rregulloret kryesore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve (lëndëve);
- 📄 Procedurat gjyqësore dhe detyrat përkatëse të personelit administrativ, dërgimi i thirrjeve, afatet dhe Prezantimi i llojeve të regjistrave dhe dokumenteve të mirëmbajtura nga stafi administrativ; rregullat dhe mostrat.





## **Metodologjia**

 Prezantime, diskutime interaktive, ushtrime praktike, duke përfshirë edhe simulime.

## **Përfituesit**

 Pjesëtarët e sapo-emëruar të administratës së prokurorive dhe stafi me më pak se 6 muaj përvojë në pozitën përkatëse.

## **Kohëzgjatja**

-  Modul 1, tri (3) ditë
-  Moduli 2, tri (3) ditë

***PLATFORMA E KURSEVE HELP***

## **Platforma për edukimin e profesionistëve ligjor për liritë dhe të drejtat e njeriut - HELP kurse online**

Platforma HELP e Këshillit të Evropës është një platformë e mësimit në distancë e zhvilluar nga Sekretariati i Këshillit të Evropës me qëllim të lehtësimit dhe ofrimit të trajnimeve sa më profesionale për profesionistët ligjorë. Kurset online HELP janë interaktive dhe vizuale. Ato mbulojnë tema të ndryshme që lidhen me të drejtat e njeriut, duke reflektuar fusha të ndryshme të punës së Këshillit të Evropës.

Objektivi kryesor i Programit të Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionistët Ligjor (HELP) është të rrisë kapacitetin e gjyqtarëve, avokatëve dhe prokurorëve, në të 46 vendet anëtare të Këshillit të Evropës dhe më gjerë, për të zbatuar standardet evropiane të të drejtave të njeriut në punën e tyre të përditshme. Kjo bëhet përmes kurseve online HELP që mbulojnë një sërë temash të të drejtave të njeriut.

<b>Nr.</b>	<b>Kurset e Zhvilluara në gjuhën shqipe në HELP</b>
1.	<b>Qasja në drejtësi për gratë</b>
2.	<b>Kriteret e pranueshmërisë së kërkesave të paraqitura në GJEDNJ</b>
3.	<b>Masat alternative ndaj ndalimit</b>
4.	<b>Alternativë për ndalimin e imigracionit</b>
5.	<b>Antidiskriminimi</b>
6.	<b>Azili dhe të Drejtat e Njeriut</b>
7.	<b>Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut</b>
8.	<b>Drejtësi miqësore për fëmijët</b>
9.	<b>Mbrojtja e të dhënave dhe të drejtat e privatësisë</b>
10.	<b>Etika për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët</b>
11.	<b>Liria e shprehjes</b>
12.	<b>Krimet e urrejtjes</b>
13.	<b>Gjuha e urrejtjes</b>
14.	<b>Hyrje në KEDNJ dhe GJEDNJ</b>
15.	<b>Arsyetimi Gjyqësor dhe të Drejtat e Njeriut</b>
16.	<b>Masat mbrojtëse procedurale në procedurën penale dhe të drejtat e viktimave</b>
17.	<b>Ndalimi i keqtrajtimit</b>
18.	<b>Të drejtat pronësore</b>
19.	<b>Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve</b>
20.	<b>Parandalimi i radikalizimit</b>
21.	<b>Fëmijët Refugjatë dhe Emigrantë</b>
22.	<b>Dhuna ndaj Grave</b>
23.	<b>Efikasiteti dhe kualiteti i punës me CEPEJ</b>

**Akademia e Drejtesise**

<https://ad.rks-gov.net>

[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)

Rr. Murat Mehmeti 1-3, Prishtine

Tel:+383 38 200 18 660